

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN



VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKITË  
LUSHNJË, DIVJAKË, FIER, BERAT, KUCOVË,  
VJORË, GJIROKASTËR DHE DELVINË

ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

PROGRAMI "MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI"




Empowered lives.  
Resilient nations.

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE  
TË JETESËS SË TYRE

I SFONDI I STUDIMIT, METODOLOGJIA,  
KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL ..... 3

II SITUATA E VENDBANIMEVE DHE KUSHTET E STREHIMIT  
TË ROMËVE DHE EGJIPTIANEVE SIPAS BASHKIVE

BASHKIA LUSHNJE ..... 11  
BASHKIA DIVJAKË ..... 22  
BASHKIA FIER ..... 32  
BASHKIA BERAT ..... 42  
BASHKIA KUÇOVË ..... 52  
BASHKIA VLORË ..... 63  
BASHKIA GJIROKASTËR ..... 73  
BASHKIA DELVINE ..... 84



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKITË  
LUSHNJË, DIVJAKË, FIER, BERAT, KUÇOVË,  
VJORË, GJIROKASTËR DHE DELVINË**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Mars 2017



*Missioners of Social Rights*

## Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkitë Lushnjë, Divjakë, Fier, Berat, Kuçovë, Vlorë, Gjirokastrë dhe Delvinë, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Klodioda Sh.p.k. dhe Organizata “Misionarët për të Drejtat Sociale” në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Mars 2017

**Foto e kopertines:** Pikturë nga Rudina Proda



## PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| FALËNDERIME   | 4  |
| HYRJE   | 5  |
| Shërbimet e strehimit pas viteve 90-të në Shqipëri                    |    |
| Romët dhe egjiptianet në Shqipëri, çështje demografike                |    |
| Situata social ekonomike e romëve dhe egjiptianëve                    |    |
| Situata e strehimit të romëve dhe egjiptianëve                        |    |
| 1. METODOLOGJIA E STUDIMIT  | 8  |
| 1.1 Sfondi i studimit   |    |
| 1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit                                 |    |
| 1.3 Aktivitetet dhe detyrat specifike                                 |    |
| 1.4 Qasja metodologjike   |    |
| 1.5 Hartimi i planit të veprimit                                      |    |
| 2. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL                                    | 13 |
| 2.1 Kuadri ligjor që siguron të drejtën e popullsisë rome për strehim |    |
| 2.1.1 Legjislacioni ndërkombëtar                                      |    |
| 2.1.2 Dokumentat politik  |    |
| 2.1.3 Dokumentat ligjor   |    |
| 2.2 Institucionet përgjegjëse për strehimin                           |    |

## FALËNDERIME

Klodioda Sh.p.k. dhe Organizata "Misionarët për të Drejtat Sociale" janë mirënjohës për udhëzimet e kujdesshme dhe mbështetjen e vazhdueshme të ekipit të programit të UNDP-së, "Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri" (UNSSIA), që udhëhoqi dhe koordinoi punën për hartimin e këtij raporti.

Falënderim i veçantë për punonjësit e Bashkive Lushnje, Divjakë, Fier, Berat, Kuçovë, Vlorë, Gjirokastër dhe Delvinë, si dhe për të gjithë bashkëpunëtorët në këtë proces të cilët mundësuan realizimin me sukses të këtij studimi. I shprehim mirënjohje stafit të Ministrisë së Zhvillimit Urban, në veçanti Znj. Aida Seleri, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Urbane dhe Strehimit, për mbështetjen profesionale në kryerjen e studimit.

## HYRJJE

Strehimi është një çështje komplekse, aq më teper ku flasim për strehim social dhe plotësimin e nevojave të grupeve të veçanta të popullatës. Për adresimin e nevojave të familjeve për strehim, duhen ndërhyrje shumëdimensionale dhe përfshirja e shumë aktorëve. Në këtë kuadër, qeveria shqiptare ka punuar në drejtim të përmirësimit të politikave të strehimit si dhe përmirësimin e kuadrit ligjor. Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 dhe Ligji "Për Programet Sociale të Strehimit" i kushtojnë vëmendje të veçante krijimit të mekanizmave ligjorë për mbështetjen e sa më shumë familjeve në nevojë me programe të përshtatshme sipas kushteve social ekonomike të këtyre familjeve. Nga ana tjetër reforma territoriale dhe fuqizimi ekonomik i bashkive ka bërë të mundur krijimin i një mjedisi institucional dhe financiar që mbështet realizimin e vizionit dhe prioritetet strategjike të qeverisë për strehimin social.

### Shërbimet e strehimit pas viteve 90-të në Shqipëri

Ndryshimi i regjimit dhe tranzicioni i shpejtë dhe drastik në ekonomine e tregut që nga 1990-ta ka sjelle tre ndryshime që kanë pasojë direkte në shërbimet e strehimit: (i) heqja e kufizimeve për levizjen e lirë të njerëzve; (ii) privatizimi i banesave; dhe (iii) rikthimin e pronës.

Lëvizja e lirë ka shkaktuar ndryshime të mëdha në fizionominë e qyteteve dhe në shpërndarjen demografike në të gjithë territorin e vendit. Nga një vend predominues rural, brenda dy dekadave, Shqipëria u bë një vend ku numri i njerëzve që jetojnë në qytet e kalon atë të fshatit. Kështu popullsia e qyteteve të zonave bregdetare si Lushnja, Fieri, Vlora etj rriten me rreth 7% në vit. Nga pikëpamja e banimit, kjo tendence migratore për në qytete ka sjellë problematika sidomos për ato shtresa të popullsisë që konsiderohen me të ardhura të pamjaftueshme ose pa të ardhura. Nga ana tjetër kjo situatë ka shkaktuar një shpërthim masiv të ndërtimeve ilegale, që shpesh ngrihen në parcela të lira në rrethinat e qyteteve, dhe paralelisht ka shkaktuar një shpopullarizim të zonave rurale, në të cilat 50% e banesave janë bosh<sup>1</sup>.

Duke filluar që nga 1993, banesat ndërtuar në Shqipëri janë privatizuar, duke ju transferuar apo shitur banorëve. Por ato ekzistuese nuk mjaftuan që të plotësojnë nevojat e popullatës për banim. Në vitin 1990, raporti shtëpi/banorë në Shqipëri ishte 219/1000; aktualisht është 253/1000, nderkohe që mesatarja në Europen Lindore është 304/1000 dhe në vendet e BE është 490/1000.

Përsa i përket kuadrit ligjor dhe institucional, deri në vitin 2008 as shteti dhe as autoritetet lokale nuk janë pajisur me instrumentat e nevojshëm ligjor dhe institucional për të zbatuar nje politike të përgjegjeshme banimi. Kjo gjë ka çuar në vështirësi si për hartimin e politikave lokale të strehimit ashtu edhe për t'ju përgjigjur nevojave të grupeve të veçanta të popullsisë për strehim.

<sup>1</sup> INSTAT Rregjistrimi i popullsisë 2011.

## Romët dhe egjiptianet në Shqipëri, çeshtje demografike

Sipas Censurit të vitit 2011, të realizuar nga INSTAT, numri i përgjithshëm i popullsisë në Republikën e Shqipërisë është 2,800,138 banorë, ndërkohë që minoritetet rezultojnë 52.700 individë, që përbën rreth 1.9 përqind të gjithë popullsisë. Debati mbi numrin e saktë të popullsisë që i përkasin minoritetit rom dhe egjiptian ka qenë i vazhdueshëm. Për këtë arsye në regjistrimin e popullsisë 2011 u bë një perpjekje për evidentimin e tyre në baze të vetedeklarimit. Kështu, sipas të dhënave të Censurit 2011 rezultojnë 8,301 banorë rom, të cilët vetedeklaruan se i përkasin këtij minoriteti. Por rezultatet e marra nuk e sheshuan dot debatin mbi numrin romëve që jetojnë në Shqipëri, përkundrazi shifra shumë e ulët e përfituar nga Censuri 2011 nëpërmjet vetedeklarimit e thelloi atë. Sipas një regjistrimi të bërë nga UNICEF, komuniteti i romëve vlerësohet të jetë rreth 15 mijë banorë të vendosur kryesisht në 108 vendbanime të ndryshme në zonat urbane dhe rurale të vëndit. Me gjithë shifrat e deklaruara, burime të pavarura thonë se numri i tyre është shumë më i lartë se ato të publikuara nga këto dy regjistrime dhe se grupet e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri përfaqësojnë rreth 5% të popullsisë<sup>2</sup>.

Përsa i përket popullsisë egjiptiane, qeveria shqiptare nuk e ka konsideruar atë një grupim etnik. Por edhe studiuesit mendojnë se popullsia egjiptiane nuk ndan shumë karakteristika etnike (si gjuha, kultura etj) nga popullsia mazhoritare<sup>3</sup>. Megjithatë për efekt të këtij studimi dhe karakteristikat e përbashketa në mënyrën e jetesës dhe kushteve social ekonomike në të cilat jetojnë, këto dy komunitete do të studiohen bazuar në të njëjtën metodologji.

## Situata social ekonomike e romëve dhe egjiptianëve

Situata social ekonomike e romëve dhe egjiptianëve, ndryshon dukshëm nga situata e popullsisë jo-rome. Kështu piramida e arsimimit të komunitetit rom krahasuar me atë të popullatës së përgjithshme, sipas rezultateve të Censurit 2011, paraqitet e ndryshme. Sipas Censurit 2011, rreth 33% e romëve të moshës 10 vjeç e sipër kanë përfunduar 4 klasë shkollë, në krahasim me vetëm 15% të së njëjtës gruposhë në popullatën e përgjithshme.

Aktualisht, romët dhe egjiptianet janë grupet etnike më të varfëra dhe të marginalizuara në Shqipëri<sup>4</sup>. Varfëria dhe përjashtimi kanë krijuar një rreth vicioz që prodhon analfabetizëm dhe arsimim të ulët, i cili thëllon edhe më shumë hendekun social dhe ekonomik ndërmjet tyre dhe pjesës tjetër të popullsisë. Edhe pse krahasuar me disa vende të tjera në Evropën Qendrore dhe atë Lindore romët përfaqësojnë një përqindje më të ulët të popullsisë, varfëria e tyre ekstreme ndikon negativisht kohezionin dhe stabilitetin social.

Studimet kanë treguar se problemet më shqetësuese të komunitetit Rom dhe egjiptian kanë një natyrë ekonomike dhe lidhen me krijimin e mundësisë për përballimin e një jetese të pranueshme. Niveli i varfërisë së tyre është pothuajse dy herë më i lartë se tek shqiptarët. Të dhënat tregojnë se një nga problemet më të vështira me të cilat përballen romët në jetën e tyre të përditshme është papunësia, kështu sipas studimeve rreth 42% e romëve (sidomos gratë

dhe të rinjtë) janë të papunë<sup>5</sup>. Sipas të njëjtit studim një pjesë e madhe e komunitetit Rom, tradicionalisht jeton në informalitet si për sa i takon punësimin, vendbanimin, regjistrimin në zyrat e gjendjes civile, etj.

## Situata e strehimit të romëve dhe egjiptianëve

Gjendja e strehimit të romëve dhe egjiptianëve është një nga problemet më të mprehta e cila ka kaluar brez pas brezi duke krijuar traditën e jetesës në struktura të përkohshme dhe të papërshtatshme. Kështu, shpesh për të zgjidhur çështjen e strehimit ata drejtohen te zgjidhjet alternative duke u "vetë-sistemuar", e cila herë duket si stil jete dhe herë si pamundësi financiare për zgjidhje afatgjata.

Lidhur me strehimin të dhënat e të njëjtit studim<sup>6</sup> tregojnë se vetëm 4% e familjeve rome pranojnë të përdorin një prej formave të programeve të strehimit social, 35% e familjeve rome jetojnë në banesa deri në 40 m<sup>2</sup> dhe 31% e banesave shfrytëzohen nga dy apo më shumë kurora. 18% e familjeve rome jetojnë në barraka dhe kasolle në kushte jetese mjaft të vështira dhe pa asnjë mundësi për t'u legalizuar, ndërkohë që 50% e familjeve rome deklarojnë se banojnë në shtepi të vjetra. Rreth 45% e familjeve rome, të cilat deklarojnë të ardhura mujore familjare më pak se 15,000 lekë në muaj, nuk mund të përmbushin kriteret e aftësisë për të paguar me qëllim kualifikimin për të përftuar nga programet sociale të strehimit.

Problemeve të strehimit të papërshtatshëm i shtohen edhe situata të tilla kur për shkak të ndërtimit të veprave publike, apo zhvillimit të pronës nga pronari që është i ndryshëm nga poseduesi i banesës, kërkohet largimi (dëbimi) i kësaj kategorie nga vendbanimet e tyre.

***"Patëm komunikime joformale me punonjësit e bashkisë këtu në kamp si dhe komunikim zyrtar me bashkinë Tiranë së cilës i kemi dërguar një rekomandim për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme dhe gjetjen e një zgjidhje afatgjatë dhe dinjitoze për strehimin e këtyre banorëve. Nuk kemi ende asnjë përgjigje zyrtare nga bashkia".***

*Avokati i Popullit<sup>7</sup>*

<sup>2</sup> 2001-Berxoli, A- "Minorities in Albania"

<sup>3</sup> Comments of the Albanian Government on the Opinion of the Advisory Committee on the Implementation of the Framework Convention for the Protection of National Minorities in Albania, 2003, page 7; GVT/Com/INF/OP/I(2003)004

<sup>4</sup> De Soto,H; Beddies,S; Gedeshi,I-"Romet dhe Egjiptianet ne Shqiperi-Nga perjashtimi shoqeror tek perfshija shoqerore".The Eorld Bank, Eashington D.C., 2005.

<sup>5</sup> 2013- Fondacioni Shoqeria e hapur per Shqiperine- "Dekada e romeve dhe situata e romeve ne Shqiperi 2012", Grup ekspertesh

<sup>6</sup> idem

<sup>7</sup> Avokati i popullit - Konferencë për shtyp "Rekomandimet e AP për zhvendosjen e familjeve rome dhe egjiptiane" 14/10/2015

# 1. METODOLOGJIA E STUDIMIT

## 1.1 Sfondi i studimit

Bazuar në të dhëna siguruar nga pushteti vendor por edhe studime të mëparshme, ky raport do të prezantojë problematika dhe do të ofrojë zgjidhje përcështjen e strehimit të popullsisë rome dhe egjiptiane në bashki të vendit: Lushnjë, Divjakë, Fier, Berat, Kucovë, Vlorë, Gjirokastër dhe Delvinë. Qëllimi kryesor i këtij studimi është vlerësimi i nevojave për strehim ose përmirësim të kushteve të banimit të kësaj pjese të popullatës. Këto rezultate do të përdoren nga politikë-bërësit në nivel qendror dhe vendor për hartimin e politikave kombëtare dhe lokale të strehimit social për këto grupime të popullsisë.

Studimi është realizuar nga një "joint venture" e përbërë nga: "Klodioda" - një kompani e specializuar në fushën e planifikimit urban dhe "Misionarët për të Drejtat Sociale" - OJF që punon në fushën e të drejtave të njeriut dhe studimeve sociale. Për koordinimin e punës dhe dizajnimin e modeleve të strehimit janë angazhuar ekspertet e kompanise Klodioda. Organizata "Misionarët për të Drejtat Sociale" mblodhi dhe përpunoi të dhënat social ekonomike, i analizoi ato dhe në bazë të gjetjeve dha edhe rekomandimet specifike për çdo bashki.

Nëpërmjet këtij studimi ekspertët janë munduar të japin një pamje të qartë të problemeve dhe sfidave që kanë romët dhe egjiptianet të lidhura me strehimin. Gjetjet janë bazuar kryesisht në informacionin primar të siguruar nëpërmjet realizimit të intervistave të strukturuar me familjet rome dhe egjiptiane, organizimit të diskutimeve me grupet e fokusuara (FGD) si dhe nëpërmjet intervistave të drejtpërdrejta me aktorët ndryshëm të vendimarrjes në nivel vendor. Gjithashtu gjetjet e studimit janë rezultat i informacionit dytësor siguruar nga të dhënat administrative që ka cdo bashki lidhur me infrastrukturën e qytetit dhe situatën e strehimit. Nga ana tjetër informacioni dhe të dhënat janë verifikuar nëpërmjet vizitave në terren që ekspertët (urbanistët) kanë bërë në lagjet/vendbanimet (formale dhe informale) të komunitetit rom.

Megjithëse nuk ishin planifikuar në kornizën metodologjike, gjatë vizitave në terren, ekspertet kanë zhvilluar disa dhjetra takime me anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian të cilët kanë ofruar informacion, kanë dhënë opinione dhe zgjidhje duke i dhënë këtij studimi një dimension tjetër, atë të pjesmarjes dhe gjithëpërfshirjes. Një nga konkluzionet e rëndësishme të këtyre takimeve është edhe ndryshimi i sjelljes së këtij komuniteti mbi menyren e jetesës:

**Konkluzion i përgjithshëm:** Gjetjet e studimit tregojnë që ka një ndryshim pozitiv në sjelljen e romëve dhe egjiptianëve përsa i përket mënyrës së jetesës, duke kaluar nga ajo "sot për nesër" në jetesën "nga brezi në brez", nga mënyra e të jetuarit si nomadë, në atë me shtëpi ose baraka fikse. Romët dhe egjiptianët sot duan të jetojnë në shtëpi decente me kushte të përshtatshme, në një mjedis të shëndetshëm, duan të arsimojnë fëmijet dhe të mos diskriminohen nga pjesa tjetër e popullsisë. Ata janë të ndërgjegjshëm që të drejtat e tyre garantojnë nga kushtetuta dhe legjislacioni shqiptar.

Studimi i vendbanimeve rome dhe egjiptiane në bashkitë Lushnjë, Divjakë, Fier, Berat, Kuçovë, Vlorë, Gjirokastër dhe Delvinë me qëllim vlerësimin e nevojave për përmirësimin e strehimit dhe kushteve të banimit këtyre komuniteteve, u krye nga tetori 2016 deri në shkurt 2017. Ky raport paraqet metodologjinë dhe instrumentet e përdorura, gjetjet kryesore dhe rezultatet si dhe zgjidhjet optimale (të mundshme dhe të realizueshme) për strehimin e romeve dhe egjiptianëve të klasifikuar si të pastrehë ose që jetojnë në kushte të këqija, në secilen prej bashkive, subjekt i këtij studimi.

Raporti synon të jetë një instrument orjentues që propozon disa nga opsionet optimale për zgjidhjen e problemeve të strehimit të komunitetit rom dhe egjiptian, por ky raport nuk mund të zëvendësojë atë që në thelb duhet të jetë një proces teknik negocimi, pjesmarjeje dhe vendimarrjeje për strehimin social në nivel vendor, i bazuar kryesisht në strategjinë kombëtare të strehimit social si dhe në dokumenta të tjerë politikash kombëtare dhe lokale.

Ndërkohë, autorët e raportit besojnë që nëse përdoren siç duhet nga vendimmarrësit (administrata lokale dhe keshillat vendore), rezultatet e këtij studimi mund të jenë një kontribut dhe dokument i rëndësishëm për hartimin e planeve urbane ose planeve të strehimit të sejcilës prej bashkive. Gjithashtu, në gjithë raportin dhe shtojcat shprehet qartësisht që ka disa zgjidhje të mundshme për përmirësimin e strehimit dhe kushtet e banimit të popullsisërome dhe egjiptiane. Hartat e bashkëngjitura si dhe planet e veprimit përfaqësojnë alternativat e mundshme që bashkitë mund të ndjekin për realizimin e funksionit të tyre për strehimin.

Në studim ka edhe rekomandime të cilat ndihmojnë autoritetet në nivel qendror dhe vendor që të përmbushin detyrimet e tyre për respektimin e të drejtës së strehimit të përshtatshëm, dhe për të eliminuar diskriminimin në këtë kontekst, me theks të veçantë tek respektimi i të drejtave të njeriut.

## 1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Studimi zhvillohet në kuadër të Programit të Kombeve të Bashkuara "Suport për Integrimin Social në Shqipëri" dheka për qëllim vlerësimin e nevojave për investime për përmirësimin e strehimit dhe kushteve të banimit të komunitetit rom dhe egjiptian në Bashkitë Lushnjë, Divjakë, Fier, Berat, Kuçovë, Vlorë, Gjirokastër dhe Delvinë.

Në mbështetje të qëllimit kryesor studimi do të arrijë këto objektiva:

- ▶ Evidentim të plotë të kushteve të jetesës (p.sh. kushtet e banimit, furnizim me ujë, energji elektrike, dhe kanalizime) të komuniteteve rome dhe egjiptiane në tetë bashkitë.
- ▶ Një vlerësim të investimeve që duhet të bëhen në Bashkitë: Lushnjë, Divjakë, Fier, Berat, Kuçovë, Vlorë, Gjirokastër dhe Delvinë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të strehimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane.
- ▶ Zhvillimin e Planit të veprimit që do të drejtojë punën e MZHUT-it si dhe bashkëpunimin me institucionet publike në nivel qendror dhe lokal për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe strehimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane në bashkitë Lushnjë, Divjakë, Fier, Berat, Kuçovë, Vlorë, Gjirokastër dhe Delvinë.

### 1.3 Aktivitetet dhe detyrat specifike

Në përmbushje të objektivave të projektit, në zbatim të kontratës dhe të detyrimeve që rrjedhin prej saj, ekipi i eksperteve realizoi aktivitetet si me poshte:

- A.** Nje “desk review”, që përmban një analizëmbështetur në studime dhe vlerësime më të fundit që përshkruajnë situatën social ekonomike të komunitetit rom dhe egjiptian. Gjithashtu në “desk review” është përfshirë edhe analiza e legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar si dhe dokumentat politikë që lidhen me strehimin social dhe përfshirjen sociale, vecanërisht për popullsinë rome dhe egjiptiane.
- B.** Analiza e studimeve të bëra nga sejcila bashki për situatën e strehimit të komuniteteve respektive dhe vecanërisht (në ato raste që ekzistojnë) i komuniteteve rom dhe egjiptian.
- C.** Analiza e projekteve dhe planeve për ndërhyrje në infrastrukturë, vecanërisht në infrastrukturën e vendbanimeve të popullsisërome dhe egjiptiane, me qëllim përmirësimin e kushteve të banimit të tyre.

Në funksion të kësaj analize, grupi i eksperteve i është referuar dokumentave si më poshtë:

- Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- MZHU “Strategjia e Strehimit Social 2016-2015
- Strategjia kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom”
- Ligji Nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale”, i përditësuar me: Ligjin Nr. 9719, datë 23.04.2007 dhe Ligjin Nr. 54/2012, datë 10.05.2012.
- Plani Kombëtar i Veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2010 – 2015
- Plani Kombëtar i Veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri, 2016-2020;
- Politikat e Strehimit dhe praktika për romët në Shqipëri, Studim, UNDP, shtator 2013
- Planet e zhvillimit social ekonomik të bashkive; Strategjinë kombëtare për strehimin social (edhe ato lokale nëse ekzistojnë)
- Profilet sociale të bashkive
- Planet urbane të miratuara/ harturara të bashkive
- Statistika kombëtare dhe lokale mbi seritë kohore të përfituesve të programeve të strehimit social
- Buxhetet lokale të viteve 2014, 2015, 2016, dhe projekt buxheti i 2017 për strehimin social
- Projekte të rehabilitimit të zonave/lagjeve ku jetojnë komuniteti rom dhe egjiptian në mënyrë të përqëndruar
- Marveshje të bashkisë me bankat, ose kompanitë e biznesit në kuadrin e realizimit të programeve të strehimit social të bashkive
- Organograma me strukturën e strehimit social si dhe trajnimet e bëra për ngritjen e kapaciteteve të stafit
- Vlerësime për banesat ku jetojnë familjet rome dhe egjiptiane

- D.** Në bashkëpunim me INSTAT dhe pushtetin vendor të tetë Bashkive, ekipi i projektit ka përditësuar hartat<sup>8</sup> me vendodhjen e komunitetit rom. Theksojmë këtu se komuniteti egjiptian nuk ka vendodhje të përcaktuara. Në raste të rralla ata janë vendosur si një komunitet në lagje të caktuara, në përgjithësi familjet egjiptiane jetojnë në të gjithë territorin e Bashkisë. Gjithashtu është klasifikuar i gjithë informacioni statistikor për popullsinë rome dhe egjiptiane. Duhet theksuar se ky informacion nuk është i plotë, pasi në programin Statistikor Zyrtar asnjë nga indikatorët nuk dis-agregohet për fasha të vecanta të popullsisë. I vetmi informacion statistikor isiguruar është i gjeneruar nga të dhënat e Censurit 2011. Pjesa tjetër e informacionit është siguruar nga të dhënat administrative nga bashkitë. Duhet theksuar se informacioni i siguruar nga burime administrative (departamentet e mbështetjes sociale ose të strehimit, varësisht nga struktura e sejciles prej bashkive) nuk është i unifikuar. Për të siguruar këtë informacion ekipi i studimit ka zhvilluar instrumentat përkatës:

- një pyetsor, i cili do të sigurojë të dhënat të cilat nuk gjenden si informacion administrativ apo statistikor, kryesisht për të dhënat që lidhen me nevojat bazike të papërmbushura (UBN) të strehimit.
- një program të thjeshtë statistikor për përpunimin dhe analizën e të dhënave për tregues sasiore që përshkruajnë situatën socio ekonomike të popullsisë rome dhe egjiptiane në tetë bashkitë e projektit.
- një pyetsor për vlerësimin e kapaciteteve (material, financiare dhe njerzore) të sejcilës bashki për të hartuar planet lokale për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane që banojnë në tetë bashkitë. Në këtë kuadër një detyrë specifike është vlerësimi i buxhetit (aktual dhe në perspektivë) të sejcilës bashki për të përballuar nevojat për strehim të familjeve në nevojë.
- “check liste” i cështjeve për diskutime me grupe të fokusuar me përfaqësues të komuniteteve si dhe përfaqësues të vendimarrjes, për të identifikuar sfidat, përcaktuar prioritetet dhe për të dhënë zgjidhjet për situatën e strehimit në të cilën ndodhen familjet rome dhe egjiptiane.
- ka organizuar seanca diskutimi ndërmjet arkitekteve dhe urbanistëve të bashkive për zgjidhjet optimale të propozuara.

- E.** Organizimi dhe realizimi i Punës në terren.

- Takime me vendimarrësit (kryetarin e Bashkise, zv kryetarin që mbulon cështjet sociale, kryetarin e komisionit të strehimit të këshillit bashkiak)
- Vizita në komunitetet rome (zonat, lagjet e banuara në mazhorancë nga familjet rome dhe egjiptiane) për vlerësimin e infrastrukturës
- Vizita në familjet rome dhe Intervista me anëtare madhorë të familjeve rome. Duke qenë se këto kanë qenë vendndodhje me popullsi relativisht homogjene rome, anketuesit kanë realizuar intervistat e tyre bazuar në standartin 1 në 3 dyer deri në plotësimin e numrit minimal 50 dhe maksimal 100 për cdo bashki.
- Vizita në zonat ku ndërtohen banesat sociale

- F.** Marrja e informacionit nëpërmjet pyetsorëve

- G.** Hartimi i raporteve përfundimtare për cdo bashki( Lushnjë, Divjakë, Fier, Berat, Kucovë, Vlorë, Gjirokastër dhe Delvinë)

<sup>8</sup> Hartat janë siguruar nga INSTAT realizuar gjate rregjistrimit te popullsisë 2011.




## 1.4 Qasja metodologjike

Ashtu si edhe në tentativa të tjera, vlerësimi i situatës social ekonomike të romëve dhe egjiptianëve hasi në vështirësi dhe sfida praktike dhe metodologjike të cilat u reflektuan kryesisht në mungesën e informacionit për tregues social, ekonomik e demografik. Për këtë arsye objektivi kryesor metodologjik i këtij studimi ishte të sigurohej një qasje multi-sektoriale e mbledhjes, përpunimit dhe analizës së informacionit mbi të cilin qeveria qendrore (MZHU) dhe qeverisja lokale (bashkitë përkatëse) tëmbështeten në hartimin e planeve urbane si dhe në hartimin e planeve për strehimin social.

Po kështu gjatë studimit në zbërthim të Ligjit për strehimin social, ekipi i ekspertëve përcaktoi edhe drejtimit kryesorë në të cilat do të zhvillohen programet e strehimit social, prioritetet dhe mundësitë specifike për secilën Bashki

Skema e mëposhteme jep në mënyrë të përmbledhur drejtimit kryesorë në të cilat mund të zhvillohen programet e strehimit social referuar ligjit ekzistues.



## 1.5 Hartimi i planit të veprimit

- ▶ Plani i veprimit për cdo bashki është hartuar në bazë të ndryshimeve të bëra në legjislacion, gjatë kohëve të fundit si dhe të gjitha vendimet e marra nga Këshillat e Bashkisë lidhur me strehimin social apo përmirësim të kushteve të banimit të komunitetit rom dhe egjiptian.
- ▶ Në planin e veprimit, grupi i ekspertëve është mbështetur në praktikën më të mirë të Shqipërisë por edhe të vendeve të rajonit.
- ▶ Plani i veprimit ka siguruar që të reflektohen të gjitha kriteret e vendosura në dokumentat ligjor.
- ▶ Plani është hartuar në partneritet me të gjithë aktorët sic janë biznesi përfaqësuar nga shoqatat e kompanive të ndërtimit, donoret dhe përfaqësues të grupeve të interesit.

## 2.

## KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

### 2.1 Kuadri ligjor që siguron të drejtën e popullsisërome për strehim

#### 2.1.1 Legjislacioni ndërkombëtar

E drejta për strehim përfshihet në një numër instrumentash të së drejtës ndërkombëtare që prej vitit 1948, datë në të cilën kjo e drejtë u përmend në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut<sup>9</sup>. Në këtë kuadër, Konventa e të Drejtave Ekonomike Sociale dhe Kulturore<sup>10</sup> (CESCR) kërkon që, e drejta për strehim të mos barazohet me pasjen e një çatie mbi kokë, por ajo duhet parë si e drejtë për të jetuar diku në siguri, paqe dhe dinjitet. CESCR thekson gjithashtu se e drejta për strehim u duhet garantuar të gjithë personave, pavarësisht të ardhurave të tyre, dhe duhet zbatuar në një mënyrë të tillë që të përputhet me mundësitë e tyre. Po sipas CESCR, e drejta për strehim është një e drejtë e shumëanëshme, e cila përbëhet nga shtatë aspekte të cilat duhen përmbushur në mënyrë që të zbatohet plotësisht kjo e drejtë, si psh; siguria ligjore e posedimit/zotërimit, mundësia (shërbimeve, materialeve, dhe infrastrukturës), përballueshmëria, jetueshmëria aksesshmëria, vendodhja, (e cila duhet të lejojë akses në tregun e punës, shëndetësi, arsim, kujdes për fëmijët, dhe lehtësira të tjera sociale) si dhe përshtatshmëri kulturore. Në këtë këndvështrim është orjentuar edhe ky studim i fokusuar në popullsinë romë dhe egjiptiane si një pjesë e popullsisë e cila përballet me vështirësi financiare si dhe me kufizime në aspekte të tjera sociale dhe kulturore.

#### 2.1.2 Dokumentacioni politik

##### Strategjia e Strehimit social 2016-2025 (miratuar me VKM nr.405, date 01/06/2016)

Në themel të politikave të strehimit social qëndron Strategjia e Strehimit Social 2016-25, i cili është dokumenti më i rëndësishëm i hartimit të politikave të strehimit në mbështetje të grupeve në nevojë. Ky dokument është shoqëruar me një plan veprimi 10 vjeçar masash konkrete dhe tëbuxhetuara, të cilat do të ofrojnë strehim të përballueshëm dhe të përshtatshëm për të gjitha shtresat në nevojë.

Kjo strategji parashikon ofrimin e alternativave përnjë strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm. Strategjia përcakton 4 prioritetet strategjike të cilat do të çojnë në ofrimin e alternativave të strehimit.

1. Forcimi i kapaciteteve vendore në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave rreth strehimit social
2. Përmirësimi i qasjes në strehim të grupeve të pafavorizuara përmes rishikimit të kuadrit ligjor dhe institucional
3. Rritja e numrit të përfituesve në pozita të pafavorizuara përmes zgjerimit të instrumenteve financiare
4. Sigurimi i strehimit të përballueshëm nëpërmjet zgjerimit dhe riorientimit të programe të strehimit social

<sup>9</sup> Neni 25.1, "çdokush ka të drejtën e një standardi jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin..." Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1948), shih në: <http://www.un.org/en/documents/udhr/>

<sup>10</sup> Asambleja e Përgjithshme KB (1966), neni 11(1), shih në <http://www.2.ohchr.org/english/law/cescr.htm>

## Strategjia Kombëtare për përmiresimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom (VKM 633 date 18/09/2003)

Në këtë dokument është shprehur në mënyrë eksplicite se shteti duhet të:

### ► “Sigurojë përmbushjen e nevojave minimale për strehim”.

Për këtë është e domosdoshme: (i) evidentimi i nevojave për strehim duke u nisur nga numri i familjeve që kanë nevojë për strehim, numri i pjesëtarëve të familjes, kushtet aktuale të banimit; (ii) evidentimi i banesave që kanë nevojë për t`u riparuar dhe hartimi i projekteve për rikonstruksionin tyre; (iii) identifikimin e pronësisë mbi truallin në të cilën është vendosur komuniteti rom; (iv) llogaritjen e nevojave për truall dhe materiale ndërtimi duke stimuluar ndërtimin e banesave ngavetë komuniteti; si dhe (v) ndërtimi i banesave të thjeshta për të pastrehët dhe për ata që banojnë kushte jo të mira.

### ► Mbulimi në rrjetin ujësjellës-kanalizime dhe energji elektrike në gjithë komunitetin

Në vendbanimet e komunitetit rom pushteti vendor dhe MZHU, në bashkëpunim me komunitetin rom: (i) do të llogarisin nevojat për ujësjellës-kanalizime; (ii) dukëdhënë komuniteti kontributin e vet njerëzor në ndërtimin e infrastrukturës; (iii) për të realizuar lidhjeve rrjetit të brendshëm; (iv) gjithashtu duke përmirësuar kushtet e brendshme higjieno-sanitare; dhe (v) përmirësime të sistemit elektrik, duke vendosur kabina elektrike në ato zona të komunitetit kumungojnë.

### ► Sigurimi i lidhjeve të vendbanimeve me rrugën nacionale

Për të siguruar levizje të lirë të pjesëtarëve të komunitetit rom në ato zona ku ata jetojnë të veçuara nga pjesa maxhoritare e popullsisë është e nevojshme (i) kryerja e studimeve dhe hartimi i projekteve për rrjetin e brëndshëm rrugor në rastet kur mungon ose nuk plotëson kërkesat teknike për lëvizje të lirë; si dhe (ii) ndërtimin dhe rikonstruksionin e këtyre rrugëve të brëndshme; (iii) dukemobilizuar vetë komunitetin rom.

## Plani Kombëtar i Veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2010 – 2015

Plani Kombëtar i Veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve është një shprehje e vullnetit të Qeverisë në adresimin e nevojave komplekse të minoritetit Rom dhe është përgatitur në bashkëpunim me MMSR dhe Kombet e Bashkuara në Shqipëri.

Ky është një okument i Qeverisë Shqiptare i cili synon integrimin e minoritetit Rom në Shqipëri në jetën social-ekonomike të vendit. Ky dokument thekson katër prioritetet globale: Arsimi; Punësimi; Shëndetësia; dhe Strehimi si dhe dy fusha prioritare kombëtare: Përfshirja sociale si dhe Mundësitë e barabarta; dhe Trashëgimia kulturore.

Objektivat e këtij plani janë:

### ► Ofrimi i mundësive për akses në strehim dhe infrastrukturë në përputhje me standardet shtetërore.

Edhe në këtë dokument, kërkohet (i) përditësimi i nevojave për strehim (ndërtim banesë; rikonstruksion banesë; rregullime të infrastrukturës bazë) në të gjitha njësitet vendore ku banon komuniteti Rom; (ii) ndërtimi i banesave të reja dhe rikonstruksionin e banesave të pabanueshme për familjet rom në nevojë; (iii) financimi me prioritet i ujësjellës-kanalizimeve në zonat e banuara nga romët; (iv) financimi me prioritet i infrastrukturës rrugore dytësore në zonat e banuara nga romët; (v) trajtimi me prioritet i kërkesave të romëve për zgjidhjen e çështjeve të pronësisë së tokës, ndërtimeve të paligjshme dhe legalizimin përmes zbatimit të legjislacionit përkatës; (vi) miratimi dhe zbatimi i programeve lokale të strehimit social për familjet rom në nevojë

(banesa sociale me qera, banesa me kosto të ulët, shitja e truallit të pajisur me infrastrukturë dhe leje për ndërtim shtëpie).

## Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020

Ky dokument specifikon se procesi i Strehimit Social është i pandarë nga strategjia e strehimit. NJQV-të do të nxiten për të krijuar bashkëpunime me sektorin privat dhe/ose jofitimprurës për të siguruar një strehim të përbalueshëm për shtresat në nevojë, duke ofruar lehtësi fiskale dhe troje publike për strehim social. Cdo bashki e re do të ketë planet 10 vjeçare të strehimit social dhe do të planifikojë fondet specifike për këtë funksion. Qeveria qendrore do të vijojë politikën e investimeve nëpërmjet Entit Kombëtar të Banësive duke plotësuar kërkesat në rritje të bashkive.

### 2.1.3 Dokumentat ligjorë

Strategjia e strehimit social ka parashikuar që deri në vitin 2017, të jetë plotësuar kuadri ligjor me “ndryshime të ligjit të strehimit”. Aktualisht kemi në fuqi dokumentat e mëposhtëm ligjorë:

**Ligji Nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale”, i përditesuar me:**

**Ligjin Nr. 9719, datë 23.04.2007 dhe Ligjin Nr. 54/2012, datë 10.05.2012.**


Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit.

## 2.2 Institucionet përgjegjëse për strehimin

Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU), në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ka për mision të hartojë dhe të zbatojë politika që synojnë modernizimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e zhvillimit urban. Në këtë kuadër MZHU është autoriteti kryesor për hartimin e politikave kombëtare të strehimit.

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, objektivat kryesorë të MZHU për strehimin social janë: 1. Hartimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor, strategjive dhe politikave në fushat e përgjegjësisë shtetërore. 2. Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare të “Strehimit Social”. 3. Hartimi dhe implementimi i programeve reformuese për rigjenerimin urban dhe zhvillimin cilësor të tokës, nëpërmjet projekteve pilot për qendrat urbane, dhe mbështetjes së projekteve të zhvillimit mbi baza konkurruese.

Autoritetet vendore janë përgjegjëse për vlerësimin e nevojave për strehim; krijimin e programeve dhe projekteve afatmesme dhe afatgjata; ofrimin e truallit të lirë për ndërtim; paraqitjen e kërkesave për financime, investime dhe subvencione të qeveria qendrore; zhvillimin dhe administrimin e një inventari të dhënash; përcaktimin e kostos maksimale të ndërtimit të banesave; ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira; si dhe informimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban në lidhje me ecurinë e programeve të strehimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË LUSHNJE**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Mars 2017



## Raport


*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Lushnje me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Klodioda Sh.p.k. dhe Organizata “Misionarët për të Drejtat Sociale” në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Mars 2017




## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME  | 4  |
| 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian           |    |
| 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI   | 5  |
| 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit                              |    |
| 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË LUSHNJE             | 6  |
| 3.1 Arsimimi   |    |
| 3.2 Punësimi dhe të ardhurat   |    |
| 3.3 Formimi profesional  |    |
| 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM  | 9  |
| 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT | 11 |
| 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN              | 12 |
| 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE  | 19 |
| ANEKSI   | 20 |
| Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Lushnje                          |    |

# 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Bashkia e re Lushnjë përbëhet nga 11 njësi administrative, Lushnja, Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Golem, Dushk, Karbunarë, Ballagat, Fier Shegan, Kolonjë dhe Krutje. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 85 fshatra. Kryeqendra e bashkisë së re është qyteti i Lushnjes, e kufizuar në veri me bashkitë Rrogozhinë dhe Peqin, në lindje me bashkinë Divjakë, në jug me bashkitë Fier dhe Roskovec, ndërsa në perëndim me bashkinë Belsh.



Sipas të dhënave të Censit 2011, kjo bashki ka një popullsi prej 83,659 banorë ndërsa në Regjistrin Civil rezultoi të regjistruar një popullsi prej 129,055 banorë. Sipërfaqja e bashkisë është 372.72 km<sup>2</sup>. Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 244.7 banorë për km<sup>2</sup> ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti është 342 banorë për km<sup>2</sup>. Bashkia ka nën administrimin e saj një zonë përgjithësisht rurale, ku rreth 65 për qind e popullsisë jeton në 85 fshatra që janë pjesë e saj, edhe për këtë arsye Lushnja është edhe zona bujqësore më e rëndësishme e Shqipërisë. Në totalin e popullsisë banuese në Lushnje Romët dhe egjiptianët përbëjnë 2.8% të popullsisë së saj.

## 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian

Bashkia e Lushnjes ka hartuar Planin Vendor të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2013-2015, që ishte një përpjekje e përbashkët e institucioneve publike dhe jo-publike në nivel vendor të lidhura drejtëpërdrejtë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të Romëve dhe Egjiptianëve në qytetin e Lushnjes. Gjithashtu Lushnja ka qenë pjesë e grupit të bashkive që u mbështetën nga fondi i zhvillimit të rajoneve për hartimin e Planit Operacional të Zhvillimit Vendor.

# 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI

## 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit

Në Bashkinë Lushnjë jetojnë rreth 1538 individë romë dhe egjiptian<sup>1</sup> (260 anëtarë nga komuniteti Rom dhe 1278 nga ai Egjiptian) në 445 familje rome dhe egjiptiane (65 familje rome dhe 380 familje egjiptiane), të cilët janë vendosur në 5 rajonet e qytetit të Lushnjes. Anëtarët e komunitetit Rom janë të vendosur në zonën e Savrës, ndërsa familjet egjiptiane janë të shpërndara në rajonet 1, 2, 3 dhe 4 të qytetit.

Egjiptianët në Lushnjë kanë ardhur rreth shekullit të XVI. Ata jetojnë në kushte të vështira social ekonomike dhe përjetojnë probleme social ekonomike të cilat po adresohen nëpërmjet politikave dhe programeve për këtë komunitet. Falë këtyre politikave dhe një kuadri ligjor të përshtatshëm, sot Egjiptianët i gjen në vende pune si në administratën vendore apo qendrore, në ndërmarrjet e shërbimeve publike, në përputhje me formimin e tyre profesional. Në Lushnje sot kemi disa të rinj nga komuniteti egjiptian dhe rom që kanë tejkaluar stigmën dhe opinionin e shoqërisë dhe janë kthyer në model për komunitetin, disa kanë mbaruar arsimin e lartë dhe disa të tjerë që janë në proces të përfundimit të studimeve universitare.

Përsa i përket familjeve rome, ato janë të vendosura në qytetin e Lushnjes që në vitin 1820, ndërkohë që ka edhe një ardhje tjetër të këtij komuniteti në vitin 1928. Lidhur me familjet rome që jetojnë aktualisht në Lushnje, 76% e tyre janë familje të vjetra, pjesa tjetër janë familje të ardhura nga qytete e fshatra të tjera pas viteve 90-të.

Familjet rome dhe egjiptiane kanë 3-6 anëtarë. Raste të familjeve me mbi 7 anëtarë hasen vetëm tek komuniteti Rom dhe janë të regjistruara rreth 20 familje me një numër mbi 7 anëtarësh

**Tabela 1: Numri i familjeve romedhe egjiptiane sipas vendbanimeve**

| Nr. | Bashkia (Ish komuna)  | Popullsia banuese sipas censurit | Popullsia banuese sipas regjistrit civil | Popullsia Rome dhe Egjiptiane | Nr. i familjeve Rome dhe Egjiptiane |
|-----|-----------------------|----------------------------------|--|-------------------------------|-------------------------------------|
| 1.  | Allkaj                | 4,319                            | 6651                                     |                               |                                     |
| 2.  | Ballagat              | 2,461                            | 3790                                     |                               |                                     |
| 3.  | Bubullime             | 5,548                            | 8543                                     |                               |                                     |
| 4.  | Dushk (Zhame, Gramsh) | 7,872                            | 12122                                    | 285                           | 79                                  |
| 5.  | Fier Shegan           | 7,023                            | 10815                                    |                               |                                     |
| 6.  | Golem (Plug)          | 5,243                            | 8075                                     | 311                           | 86                                  |
| 7.  | Hysgjokaj             | 2,603                            | 4000                                     |                               |                                     |
| 8.  | Karbunare             | 4,194                            | 6450                                     |                               |                                     |
| 9.  | Kolonje               | 5,728                            | 8820                                     |                               |                                     |
| 10. | Krutje                | 7,564                            | 11650                                    |                               |                                     |
| 11. | Lushnje (Saver)       | 31,104                           | 47900                                    | 988                           | 287                                 |
|     | <b>Total</b>          | <b>83,660</b>                    | <b>129,055</b>                           | <b>1,584</b>                  | <b>452</b>                          |

Burimi i të dhënave: INSTAT, Census 2011; RGJC 2016 dhe Llogaritjet e autorëve nga studimi

<sup>1</sup> Te dhena nga studimi 2017.

### 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË LUSHNJE

Bashkimi i njësive administrative (komunave dhe bashkise) në një bashki te vetme mund të ketë efekte pozitive edhe për treguesit socialë dhe arsimorë të zonës. Në veçanti, niveli arsimor mesatar përgjithësisht është në përpjesëtim të drejtë me largësinë gjeografike nga qendrat funksionale, të cilat janë dhe qendra të vjetra urbane me një traditë arsimore dhe zhvillim elitash. Po ashtu, mund të bëhet një shpërndarje më e mirë e institucioneve arsimore (kopshte, shkolla) në raport të drejtë me dendësinë e popullsisë.

Sektori mbizotërues në ekonominë e rajonit të Lushnjës është bujqësia. Ndonëse të dhëna më të detajuara në nivel njësie vendore nuk janë të disponueshme, konfigurimi i zonës funksionale të re sugjeron se me përjashtim të bashkisë Lushnjë pjesa dërrmuese e njësive të reja të përfshira kanë karakter bujqësor. Kjo hipotezë mbështetet edhe nga të dhënat mbi shpërndarjen e bizneseve në këto zona. Bashkia Lushnjë ka 2825 biznese, nga të cilët 60% janë të vendosur në qytetin e Lushnjës. Mesatarisht 70% e të punësuarve në zonë me përjashtim të qytetit të Lushnjës veprojnë në sektorin e bujqësisë. Punësimi në qytetin e Lushnjës mbizotërohet nga shërbimet (45%), i ndjekur nga tregtia (21%) dhe industria (11%).

Romet dhe egjiptianet në Lushnje vuajnë nga varfëria, niveli i ulët arsimor, kushtet shumë të vështira dhe aspak të shëndetshme të banimit, mungesa e aksesit në të drejta dhe shërbime sociale, si dhe nga forma të ndryshme të diskriminimit. Shumica e Romëve dhe Egjiptianëve janë totalisht të varur nga puna informale dhe fëmijët e tyre janë veçanërisht vulnerablë ndaj dukurisë së trafikimit si dhe shfrytëzimit për punë, duke përfshirë lypjen, mbledhjen e hekurishteve etj. Megjithatë në Bashkinë e Lushnjës ka mbizotërim të aktivitetit bujqësor, familjet rome dhe egjiptiane nuk janë të përfshira në këto aktivitete ekonomike. Ko gjë e ben edhe me te veshtire perfshirjen e tyre tregun e punes.

Shpesh mundësia e kufizuar e punësimit vjen për shkak të mungesës së kualifikimit profesional dhe diskriminimit. Shumica e tyre jetojnë me të ardhurat e fituara nga puna informale. Situata tepër e vështirë ekonomike e shumë familjeve dhe diskriminimi i vazhdueshëm ndikojnë në mënyrë direkte në kushtet e banimit të tyre. Shtëpitë e këtyre komuniteteve dhe veçanërisht të Romëve nuk kanë lidhje me infrastrukturën bazë, si ujë, energji elektrike dhe shërbime të tjera publike.

#### 3.1 Arsimimi

Në Bashkinë e Lushnjës, ajo çka vihet re fare qartë është se një përqindje e madhe e anëtarëve të komunitetit Rom (80.7%) kanë kryer vetëm ciklin fillor të arsimimit, 17.3% ose janë të paarsimuar ose nuk e kanë përfunduar ciklin fillor të arsimimit. Ndërkohë që, për komunitetin Egjiptian përqindja e personave të arsimuar është më e lartë krahasuar me atë të komunitetit Rom. Niveli i arsimimit i popullsisë Rome është shumë më i ulët sesa mesatarja në shkallë vendore. Ky nivel është më i ulët krahasuar edhe me vetë nivelin e arsimimit të komunitetit Egjiptian. Përqindja mesatare lidhur me aftësinë e shkrimit dhe leximit të gjuhës shqipe tek Romët e kontaktuar në qytetin e Lushnjës është vetëm 62%, krahasuar me 97% që është përqindja e shkrimit dhe leximit tek popullsia jo Rome.

Nga të dhënat e identifikuar, rezulton se nuk ka asnjë fëmijë Rom që nuk frekuenton sistemin parashkollor. Të gjithë fëmijët romë të grupmoshës 5-6 vjeç e ndjekin në 100% nivelin parashkollor të arsimimit. Ndërkohë, përsa i përket fëmijëve që i përkasin familjeve Egjiptiane janë identifikuar 10 fëmijë, të cilët nuk janë të regjistruar në sistemin parashkollor.

Shkaqet e braktisjes së shkollës së mesme janë të ndryshme për femrat dhe meshkujt. Faktorë të tillë si: martesat në moshë të hershme, pamundësia ekonomike, trysnia nga komuniteti i tyre, perceptimi negativ mbi shkollën e mesme renditen ndër shkaqet kryesore që i shtojnë femrat Rome për të braktisur shkollën e mesme, ndërsa për meshkujt dedikimi i tyre me kohë të plotë për sigurimin e të ardhurave është një ndër faktorët kryesorë që i shtyn ata për të braktisur shkollën.

Për fëmijët që u përkasin grupeve vulnerabël dhe që nuk kanë pasur mundësi të ndjekin shkollën në Bashkinë e Lushnjës po zbatohet programi i shansit të dytë dhe përkatësisht në shkollat "Kongresi i Lushnjës" dhe "Skënder Libohova", ku 20 nxënës të cilët u përkasin familjeve egjiptiane e frekuentojnë këtë program. Është e rëndësishme të theksojmë që në këtë program nuk ka asnjë fëmijë rom, edhe pse janë identifikuar 2 fëmijë romë, të cilët kanë braktisur shkollën. Bashkia Lushnjë ka mundësuar transportin për në shkollë për fëmijët romë që ndjekin arsimin e mesëm, por aktualisht ky është një shërbim i cili paguhet individualisht. Pavarësisht nga kjo është e rëndësishme të theksojmë që ky shërbim ka ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e numrit të fëmijëve romë të cilët ndjekin sistemin arsimor, veçanërisht, ata që ndjekin arsimin e detyrueshëm 9- vjeçar. Përsa i përket arsimimit të lartë, numri total i studentëve që i përkasin komunitetit Rom dhe Egjiptian është 15, nga këta 2 student i përket komunitetit Rom dhe 13 studentë i përkasin komunitetit Egjiptian.

#### 3.2 Punësimi dhe të ardhurat

Sipas studimeve të ndryshme, të ardhurat e familjeve Rome sigurohen në pjesën më të madhe nga tregu informal, i cili nga ana tjetër krijon një paqëndrueshmëri të lartë.

Numri total i personave të komunitetit Rom e Egjiptian që janë identifikuar si të papunë është 680 persona, ku 80 nga këta i përkasin komunitetit Rom dhe 600 atij Egjiptian.

Numri i personave nga komuniteti Rom dhe Egjiptian të regjistruar si punëkërkues në zyrën e Punës në qytetin e Lushnjës është 470 persona, nga të cilët 48 persona i përkasin komunitetit Rom dhe 422 atij Egjiptian.

Numri i personave të punësuar dhe që përfitojnë nga skemat e sigurimeve është 39 persona, nga të cilët 1 person i përket komunitetit Rom dhe 38 atij Egjiptian.

Numri i personave të papunë që mbështeten në ndihmën ekonomike është gjithsej 251 familje. Nga këta 8 janë nga familjet Rome dhe 243 nga familjet Egjiptiane. Bazuar në ligjin nr.9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në Bashkinë e Lushnjës, me anë të administratorëve socialë në rajone ka filluar t'u japin informacion dhe ndihmë romëve për plotësimin e dokumenteve për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe aktualisht në këtë skemë është mundësuar përfshirja e 8 familjeve Rome. Numri i personave që janë të vetpunësuar gjithsej janë 94 persona, nga këta 20 persona nga komuniteti Rom dhe 74 persona nga komuniteti Egjiptian. Profesione më të zakonshme janë mbledhja e hekurishteve, punësezonale në sektorin e bujqësisë, ose shitja në rrugë e rrobave të përdorura etj. Duke parë edhe gjendjen e paraqitur më lart në lidhje me punësimin e

personave të këtyre komuniteteve, të ardhurat e shumicës së familjeve janë minimale dhe nuk mund t'i kënaqin nevojat elementare për ekzistencë, çka tregohet edhe nga të dhënat në vijim:

**Tabela 2: Familjet rome dhe egjiptiane përfituese të ndihmës ekonomike në Lushnjë**

| Nr. | Bashkia (Ish komuna) | Familje | Familje në NE | PAK |
|-----|----------------------|---------|---------------|-----|
| 1.  | Lushnje              | 827     | 103           | 64  |

**Burimi:** Te dhëna administrative Bashkia Lushnjë -2016

### 3.3 Formimi profesional

Megjithëse pjesëmarrja e të rriturve romë në kurset profesionale ka qenë në rritje, rezultatet tregojnë që nuk janë ndërmarrë veprime efikase për të integruar këtë komunitet në tregun e punës. Përpjekjet e qeverisë për të favorizuar përfshirjen e Romëve në programet për promovimin e punësimit për personat në nevojë nëpërmjet skemës së subvencionimit të pagesave dhe mbulimit të taksave për punonjësit nuk janë efektive. Në total janë vetëm 4 persona (femra) që kanë përfituar nga kurset e formimit profesional (1 person nga komuniteti Rom dhe 3 nga ai Egjiptian). Numri i ulët i personave të përfshirë në kurset profesionale të organizuara nga Qendra Rajonale e Formimit Profesional lidhet me vetë vendndodhjen e kësaj qendre në qytetin e Fierit.

Niveli tepër i ulët i të ardhurave për familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian e bën të pamundur përballimin e kostos së transportit për në Qendrën e Formimit Profesional. Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë, në zbatim të VKM-së Nr.48, datë 16.01.2008, Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë në vështirësi i ndryshuar, nuk ka filluar së zbatuari në qytetin e Lushnjës.

## 4.

## POLITIKAT LOKALE PËR STREHM

Në qytetin e Lushnjës, janë identifikuar 37 familje Rome, kryesisht të vendosura në zonën e Savrës, të cilat janë klasifikuar si familje të pastreha. Megjithatë vendosja e kriterëve të shumta për të marrë statusin e të pastrehit bëhet pengesë që familjet rome të aplikojnë për këtë status. Një tjetër situatë paraqitet për familjet egjiptiane, nga 100 familje Egjiptiane të identifikuar si familje të pastreha, 80 prej tyre janë aktualisht të regjistruar në regjistrat e të pastrehëve, ndërkohë që 34 familje kanë marrë tashmë statusin e familjeve të pastreha në Bashkinë e Lushnjës.

Ndërkohë, 25 familje Rome dhe Egjiptiane (5 familje Rome dhe 20 Egjiptiane) kanë nevojë për rikonstruktiv të menjëhershëm të banesës së tyre. Zonat në të cilat janë vendosur Romët dhe Egjiptianët janë zona formale, kështu që familjet që u përkasin këtyre komuniteteve nuk kanë probleme me pronësinë e tokës apo me ndërtimet e paligjshme dhe si të tilla ato në përgjithësi kanë akses në lehtësira elementare të tilla si: sistemet e kanalizimeve, shërbimin e largimit të mbeturinave, furnizimin me ujë të pijshëm etj. Megjithatë, ekzistojnë probleme në lagjen Vangjo Nova, ku mungon lidhja ndërmjet rrjetit kryesor të ujit të pijshëm dhe shtëpive të familjeve Rome dhe si pasojë 7 familje Rome dhe 3 familje që i përkasin shumicës, që jetojnë në këtë lagje kanë mungesë furnizimi me ujë të pijshëm. E njëjta problematikë haset edhe për familjet Egjiptiane banuese të lagjes "18 Tetori", të cilat kanë një mungesë të plotë të furnizimit me ujë të pijshëm. Në të njëjtën kohë është identifikuar që komuniteti Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lushnjës ka gjithashtu probleme me infrastrukturën e rrugëve dytësore, përkatësisht në rrugën "Vagjo Nova", e cila ka gjatësinë 100 m si dhe rruga në lagjen "18 Tetori", të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme për përmirësimin e kushteve infrastrukturore. Familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian, ashtu si dhe një pjesë e konsiderueshme e familjeve që i përkasin shumicës së popullsisë janë në procesin e legalizimit. Aktualisht vazhdojnë të jenë në proces legalizimi 40 familje Egjiptiane, ndërkohë që janë identifikuar 2 familje Rome, të cilat nuk janë të përfshirë në procesin e legalizimit, edhe pse plotësojnë të gjitha kriteret për të qenë pjesë e këtij procesi.

Përsa i përket furnizimit me energji elektrike nuk mungon rrjeti i shpërndarjes, por ka vështirësi në pagimin e faturave të energjisë elektrike për shkak të pamundësive ekonomike. Si rezultat, disa prej familjeve Rome në zonën e Savrës të intervistuar nga grupi i eksperteve deklaruan se ju është ndërprerë furnizimi me energji elektrike pasi janë debitore në mos shlyerjen e faturave. Mungesa e ndriçimit të rrugëve është një tjetër problem i cili ka nevojë që të zgjidhet. Kështu, mungon plotësisht ndriçimi i rrugës në lagjen "Vesil Ahmeti", një rrugë me një gjatësi 600 m si dhe ndriçimi i rrugës në lagjen "Muharrem Bejtje" me një gjatësi rruge 400m, zona këto në të cilën banojnë familjet egjiptiane.

Komunitetet rome dhe egjiptiane në Lushnje, që prej vitit 2014 kanë përfituar ndërtimin e banesave të reja. Rreth 60 familje, banojnë në këto shtëpi private. Familjarët tregojnë se më parë jetonin në çadra plasmasi të përshtatura si banesa, ndërsa disa familje të tjera nuk kanë pasur shtëpi pasi u është djegur. Megjithëse përfituan nga ndërtimi i banesave sociale nga programi i investimeve të ministrisë së zhvillimit urban, komunitetet rome dhe egjiptiane kanë ende nevojë për ndihmë.

18 banesa u ndërtuan në fshatin Zhamë, pjesë e bashkisë Lushnje, ndërsa 27 të tjera në qytet do të ndërtohen gjatë vitit 2017. Në ditën ndërkombëtare të romëve, për të parë nga afër këto investime ka qënë ministrja e zhvillimit urban Eglantina Gjermeni.

Komuniteti rom shtrihet në zonat e Savrës, Dushkut dhe në dy lagje të mëdha të qytetit të Lushnjes. Nevojat e tyre urgjente kanë qënë rindërtimi i banesave dhe punësimi. Ndërsa për 60 familje investimet e pjesshme në ndërtimin e shtëpive kanë përfunduar, problem për këtë komunitet mbetet punësimi.

Me fondet e Entit kemi ndërtuar gjithsej 38 apartamente në bashkinë Lushnjë. “Që prej vitit 2015 Shqipëria si shtet anëtar i Komisionit Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara ka marrë përsipër zbatimin e Kartës së Gjenevës mbi Strehimin e Qëndrueshëm, e cila u miratua në sesionin e 75-të të Komitetit të Strehimit dhe Menaxhimit të Tokës. Kjo kartë shërben si mjet për të mbështetur politikat e strehimit të vendeve anëtare për të rritur aksesin në strehim të përbalueshëm dhe të përshtatshëm.

**Tabela 3: Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që janë klasifikuar për të qenë përfituese të programeve të strehimit**

| Programi  | Përshkrimi  | Nr. i familjeve përfituese | Nga keto Rom/Egjiptian | Zona |
|---|---|----------------------------|------------------------|------|
| Banesat me kosto të ulët  | Ndërtim i ri  | 80                         | 60                     | na   |
| Subveçionimi i interesit të kredisë së lehtësuar                      | Kredia është dhënë nga banka private për blerjen e shtëpive në treg; interesi subveçionohet pjesërisht nga buxheti i shtetit.         | 0                          | 0                      | na   |
| Strehimi social   | Ndërtim i ri  | 0                          | 0                      | na   |
| Bonusi i strehimit (vlëra)  | Grant nga qeveria lokale për pagesën e qirasë së tregut. Grande nga qeveria qendrore për disa kategori të përcaktuara në ligjin 9232. |                            |                        |      |
| Subveçion i qirasë për banesat sociale me qira në pronësi të bashkive | Grant nga qeveria qendrore për pagesën e qirasë për personat me të ardhura të ulëta.  | 0                          | 0                      | na   |
| Zhvillimi i tokës për qëllime strehimi                                | Zona e ndërtimit dhe shërbimet  | 0                          | 0                      | na   |
| Grante të vogla   | Përmirësimi i kushteve të banimit   | 60                         | 60                     | na   |


Përmirësimi të kushteve të banimit, të komunitetit Rom në Bashkinë e Lushnjes ka qënë hapi i parë i bashkëpunimit qeveri qendrore dhe vendore në fushën e strehimit social. Ky bashkëpunim ka shkuar me tej me një marrëveshje bashkëpunimi për ndërtimin e rreth 70 apartamenteve të banimit, për familjet që kanë nevojë për strehim, e cila i korrespondon një vlere investimi prej rreth 180 milion lekë. Nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave janë ndërtuar dy objekteve me kosto të ulët por cilësore nga pikëpamja teknike. Ky është një kontribut i përbashkët i Bashkisë, që ka ofruar truallin dhe ka marrë përsipër të investojë në infrastrukturën e zonës si dhe një kontribut MZHU-se që nëpërmjet financimeve të Entit Kombëtar të Banesave, të sigurojë shitjen me kosto, të apartamenteve të banimit.

E veçanta e këtij projekti është që Banesat do të ndërtohen në Lushnje, bëjnë pjesë në programin e ri të Entit, për ndërtimet me përdorim eficient të energjisë. Kjo do të sigurojë, njëkohësisht, një konfort më të lartë për qytetarët dhe kursim në faturat e tyre të energjisë, si dhe do të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit apo kursimin e burimeve energjetike.

**Tabela 4: Situata e familjeve te pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Lushnje**

| Emërtimi zonës   | Total | Rome | %   | Egjiptiane | %   |
|--|-------|------|-----|------------|-----|
| Familje gjithsej   | 445   | 65   | 15% | 380        | 85% |
| Familje në nevojë për strehim:                           | 215   | 40   | 19% | 175        | 81% |
| Nuk zotërojnë një hapësirë për të jetuar                 | 150   | 30   | 20% | 120        | 80% |
| Zotërojnë një hapësirë jetese nën standartet e strehimit | 65    | 10   | 15% | 55         | 85% |

**Figura 1: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Lushnje**




**Tabela 5: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E**

| Lloji i kushteve te strehimit          | Numri |
|--|-------|
| Jetojne ne tenda, baraka, depo         | 150   |
| Jetojne ne garsionere                  | 50    |
| Jetojne ne apartmente 1+1              | 15    |
| Jetojne ne apartmente 2+1              | 0     |
| Jetojne ne apartmente 3+1 ose me shume | 0     |
| Total                                  | 215   |



**Figura 2: Situata aktuale e akomodimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Lushnje**



## 6.

## PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN

Përmirësimi i cilësisë së strehimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian është një nevojë urgjente dhe duhet parë në kuadrin e politikave të strehimit në përgjithësi, që në të njëjtën kohë përputhen me objektivat e politikave ekonomike dhe kontribuojnë në forcimin e politikave sociale. Këto politika të strehimit duhet të zhvillohen brenda një kuadri të përgjithshëm legjislativ, që propozojnë masa konkrete për të mbështetur financimin nëpërmjet planeve dhe politikave të qeverisë mbi strehimin.

Për të përmirësuar kushtet e banesave të komuniteteve rome dhe egjiptiane është analizuar kosto për riparim e banesave ekzistuese, e shtesave të nevojshme të këtyre banesave. Në shumicën e rasteve banesat kanë nevojë për të dyja këto ndërhyrje. Për të përcaktuar çmimin e riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë në konsideratë lloji i ndërtimeve të gjendja ekzistuese. Ndërhyrja do të konsistojë në riparimin e muratave, shtatimeve, dyshemve, terraces ose çatisë, tavanit, ndërhyrje në dyert dhe dritaret, riparim dhe zëvendësim i tyre, riparimi i nyjeve hidrosanitare. Nga përlllogaritja, çmimi riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi ka rezultuar nga 7000-11000 lekë/m<sup>2</sup> (mesatarisht 9000 lekë/m<sup>2</sup>). Llogaritjet tregojnë që duhen 300.000 lekë/familje riparime për garsonieret, 500.000 lekë/familje për apartamentet 1+1, 600.000 lekë/familje riparime për apartamentet 2+1 dhe 800.000 lekë/familje riparime për apartamentet 3+1. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përlllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht : garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kjo analizë ka konkluduar me koston 1.200.000 lekë/familje për sipërfaqen shtesë për apartamentet 1+1, 2+1, dhe 3+1 llogaritur si prodhim i sipërfaqes të shtesës në m<sup>2</sup> me çmimin e ndërtimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, duke konsideruar sipërfaqen e nevojshme për shtesë 30-40 m<sup>2</sup>, (sipërfaqe që do të përfshijë një ambient dite dhe një ambient ndihmes/ një ambient gjumi dhe dy ambiente ndihmese ose dy ambiente gjumi sipas secilit rast). Për garsonieret është menduar të bëhet rikonstrukcioni i tyre për të zgjidhur problemet e femijeve të familjeve dhe jo shtesë, pasi shtesa në to nuk justifikon koston e lartë të ndërtimit si për nga sipërfaqja e madhe, ashtu edhe për gjendjen e amortizuar të garsonierëve. Banesat 3+1 kanë sipërfaqe të mjaftueshme banimi ndaj nuk është e nevojshme të ndërtohet shtesë. Më poshtë jepet tabela me llogaritjen e koston të riparimeve dhe shtesave të banesave.

### Analiza e Kostove për Rikonstrukcionin

Struktura e mëposhtme është një zberthim i menyrës së shpërndarjes së vlerës në mënyrë të shumtën e rasteve, por kjo menyrë është variabël sipas situatës që paraqitet.

#### • Ndërtim Garsoniere

| Nr. | Emertimi punimit  | Vlera (në Lekë) |
|-----|---|-----------------|
| 1   | Rikonstrukcion WC   | 120,000         |
| 2   | Rikonstrukcion Suva dhe Mure                                      | 70,000          |
| 3   | Rikonstrukcion DysHEME dhe Cati                                   | 50,000          |
| 4   | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 30,000          |
| 5   | Rikonstrukcion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 30,000          |
|     | <b>Total</b>  | <b>300,000</b>  |

• **Ndertim 1+1**

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 150,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 120,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 110,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 60,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 60,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>500,000</b>  |

• **Ndertim 2+1**

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 160,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 140,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 130,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 90,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 80,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>600,000</b>  |

• **Ndertim 3+1**

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 170,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 200,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 200,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 120,000         |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 110,000         |
| <b>Total</b> |   | <b>800,000</b>  |

Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstruksion dhe shtesa eshte si me poshte:

Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstruksion dhe shtesa eshte si me poshte:

- Kosto e rikonstruksionit per garsionere = numri familjeve \* 300.000 lekë/familje rikonstruksion = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstruksionit + shtesë per apartamente 1+1 = numri familjeve \* 1.700.000 lekë/familje (500.000 lekë/familje rikonstruksion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstruksionit + shtesë per apartamente 2+1 = numri familjeve \* 1.800.000 lekë/familje (600.000 lekë/familje rikonstruksion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstruksionit per apartamente 3+1 = numri familjeve \* 800.000 lekë/familje rikonstruksion = Shuma gjithsej
- **Kosto totale per rikonstruksion + shtesë** = Kosto e rikonstruksionit per garsionere + Kosto e rikonstruksionit + shtesë per apartamente (1+1) + Kosto e rikonstruksionit + shtesë per apartamente (2+1) + Kosto e rikonstruksionit per apartamente (3+1)

**Tabela 6: Vlerësimi i koston per rikonstruksion + shtesa në Bashkinë Lushnje**

| Tipi         | Kosto per rikonstruksion lekë | Kosto per Shtesa lekë | Nr familjeve | Kosto lekë        |
|--------------|-------------------------------|-----------------------|--------------|-------------------|
| garsoniere   | 300,000                       | -                     | 50           | 15,000,000        |
| ap 1+1       | 500,000                       | 1,200,000             | 15           | 25,500,000        |
| ap 2+1       | 600,000                       | 1,200,000             | 0            | -                 |
| ap 3+1       | 800,000                       | -                     | 0            | -                 |
| <b>Total</b> |                               |                       | <b>65</b>    | <b>40,500,000</b> |

**Tabela 7: Aksesit per uje, kanalizime dhe furnizim me energji elektrike I komunitetit R/E ne Bashkine Lushnjë**

| Punë ne infrastrukturën inxhinierike (Për secilën zonë) | Gjatesia në metra |
|---|-------------------|
| Rrjeti i furnizimit me ujë                              | 3000              |
| Rrjeti i kanalizimeve                                   | 2900              |
| Rrjeti i furnizimit me energji elektrike                | 3300              |
| Rruge   | 3500              |

Ne estimimin qe eshte bere per infrastrukturen ne keto zona eshte parashikuar permiresimi i rrjetit infrastrukturor per te gjithë komunitetin (zonen), pra ky rrjet do ti sherbeje dhe atyre familjeve qe nuk kane nevojë per permiresim te kushteve. Vlerësimi i koston për investimin në infrastrukturë është llogaritur si prodhim i gjatësisë në metra te infrastukturës primare të nevojitur, me çmimin për metër linear për secilin zë. Çmimi eshte percaktuar si mesatare e të njejtit zë në projekte të mëparshme. Zërat e përfshirë në infrastrukturen primare, për te cilët janë marrë të dhëna nga bashkitë përkatëse janë : gjatësia e rrugëve, çmimi për metër linear i llogaritur për afërsisht 30000 lekë/ml (gjerësia e rruges merret 5m si rrjedhojë 1 meter linear gjatesi=5 m<sup>2</sup> sipërfaqe), gjatësia e rrjetit të furnizimit me ujë\_çmimi 6000 lekë/ml, gjatësia e rrjetit të kanalizimeve, çmimi 8000 lekë/ml dhe gjatësia e rrjetit të furnizimit me energji elektrike, çmimi 4000 lekë/ml. Në rastet kur vlera e zërave te infrastrukturës është 0, si rrjedhojë dhe kosto përkatëse është 0 lekë, tregon se për zërin në fjalë nuk ka nevojë për investim.

Formula e perdorur per vleresimin e koston per infrastrukturen eshte si me poshte:

- Kosto per rrjetin e furnizimit me uje = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per rrjetin e kanalizimeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per furnizimin me energji elektrike = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per ndertimin e rrugeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- **Kosto per infrastrukturen** = Kosto per rrjetin e furnizimit me uje + Kosto per rrjetin e kanalizimeve + Kosto per furnizimin me energji elektrike + Kosto per ndertimin e rrugeve

**Tabela 8: Vlerësimi i kostos per infrastrukturen në Bashkinë Lushnje**

| Tipi         | lekë/ ml | Gjatesia në metra | Kosto lekë         |
|--------------|----------|-------------------|--------------------|
| Rrugë        | 30,000   | 3,500             | 105,000,000        |
| Ujë          | 6,000    | 3,000             | 18,000,000         |
| Elektrike    | 4,000    | 3,300             | 13,200,000         |
| Kanalizime   | 8,000    | 2,900             | 23,200,000         |
| <b>Total</b> |          |                   | <b>159,400,000</b> |

Nevojat për ndërtime të reja përfshin ata që banojnë në kasolle si edhe në banesa që nuk kanë siguri për jetën si: tenda, baraka, depo. Sipas kriterëve dhe normativave të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr 824 datë 3.12.2004 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" është bërë dhe vlerësimi i kostos për keto ndërtime. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht : garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kosto e ndërtimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë për çdo qytet nga manuali i qeverisë në qershor 2015: "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015". Më poshtë jepen formulat e llogaritjes të kostos të ndërtimeve të reja dhe tabela përkatëse me rezultatet.

**Tabela 9: Kërkesa e komunitetit R/E per strehim, ne Bashkine Lushnjë**

| Lloji i Strehimit  | Nevoja per studim komuniteti Rom | Nevoja per studim komuniteti Egjiptian |
|--|----------------------------------|--|
| Numri i familjeve qe u nevojiten garsoniere                                      | 5                                | 10                                     |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 1+1                                 | 10                               | 20                                     |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 2+1                                 | 10                               | 30                                     |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 deri ne 75,5 m <sup>2</sup>     | 5                                | 40                                     |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 me shume se 75,5 m <sup>2</sup> | -                                | 20                                     |
| <b>Numri total i familjeve</b>   | <b>30</b>                        | <b>120</b>                             |

Formulat e perdorura per vleresimin e kostos per ndertime te reja jane si me poshte:

- Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per garsoniere e caktuar 35 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 1+1 = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 1+1 e caktuar 55 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 2+1 = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 2+1 e caktuar 67 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 3+1 = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 3+1 e caktuar 75.5 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- **Kosto totale per ndërtime te reja** = Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere + Kosto e

ndërtimeve te reja, apartamente (1+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (2+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (3+1) = Shuma gjithsej

**Tabela 10: Vlerësimi i kostos per ndertime të reja në Bashkinë Lushnjë**

| Tipi                | lekë/ m <sup>2</sup> | Sipërfaqe m <sup>2</sup> | Nr familjeve | Kosto lekë         |
|---------------------|----------------------|--------------------------|--------------|--------------------|
| garsoniere          | 31,360               | 35                       | 15           | 16,464,000         |
| ap 1+1              | 31,360               | 55                       | 30           | 51,744,000         |
| ap 2+1              | 31,360               | 67                       | 40           | 84,044,800         |
| ap 3+1              | 31,360               | 75.5                     | 45           | 106,545,600        |
| ap 3+1 dhe me shume | 31,360               | 85                       | 20           | 53,312,000         |
| <b>Total</b>        |                      |                          | <b>150</b>   | <b>312,110,400</b> |

**Kosto Total në Bashkinë Lushnjë - 512,010,400**



**Foto nga vendbanimet R/E**

Duke u nisur nga situata konkrete dhe nga informacioni qe morem nga Bashkia, menyra qe i pershtatet me shume realitetit, sipas analizes tone, eshte ndertimi i banesave me kosto te ulet, kjo e kombinuar dhe me rikonstrukcionin dhe me ndertimin e shtesave per banesat ekzistuese. Ndertimi i banesave me kosto te ulet, parashikohet te behet ne hapesirat e lira te zonave ne te cilat keto komunitete jetojne aktualisht. Per shkak te mungeses te informacionit ne lidhje me komunitetin Egjiptian per kërkesa per banesa sociale, eshte menduar qe ne qofte se nga

bashkë do të investohet në këtë drejtim, fondi që do parashikohet për ata familje që do përfitojnë nga banesat sociale, do të zbritet nga fondi që është parashikuar në këtë studim.

Kjo analizë konkludon disa skenarë të rradhitur më poshtë:

#### ► Skenari 1

##### **Rikonstruksioni dhe shtesa për banesat ekzistuese.**

Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk i plotësojnë kushtet e jetesës. Ato mund të kenë nevojë për:

- Rikonstruksion të banesave ekzistuese
- Rikonstruksion + Shtesa në ndërtesat ekzistuese

Familjet që bëjnë pjesë në këtë grup, kanë nevojë për shtesë ambjentesh.

#### ► Skenari 2

##### **Ndërtime të reja.**

Është menduar që përmirësimi i kushteve të këtyre familjeve, nisur nga mënyra e jetesës që ato kanë, të bëhet në hapësirat e zonave ku ata jetojnë aktualisht. Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk plotësojnë kushtet minimale të jetesës. Në këtë rast propozohet të bëhen ndërtime të reja për të cilat janë evidentuar sipërfaqet përkatëse për secilin tip apartamenti (garsoniere, apartamente 1+1, 2+1 ose 3+1).

##### **Punime plotësuese me investime në infrastrukturën primare.**

Përveç punimeve në banesat vetjake të secilës familje është parashikuar nevojë edhe për punime në infrastrukturën primare në ndihmë të familjeve Rome apo Egjiptiane.

Këto punime konsistojnë në katër grupe të mëdha:

1. Punime mirëmbajtjeje dhe ndertimit të rrugëve
2. Ndërtim kanalizimesh për ujërat e zeza dhe përmirësimi i pusetave ekzistuese,
3. Ndërtim si dhe riparim i degëzimeve të ujësjellësit. Për të gjitha këto punime janë parashikuar kostot më lart.
4. Shtim i gjatësisë të rrjetit elektrik.

## 7.

## PËRMBLEDHJE E GJETJEVE


Romët dhe egjiptianët në Bashkinë e Fierit, janë grupe të përjashtuara me nevojë sociale dhe ekonomike, ku nevojë për strehim është me rëndësi më e lartë (nga DGF me përfaqësues të komunitetit). Nevojën për strehim ky komunitet nuk mund ta zgjidhë në mënyrë individuale për shkak të nivelit shumë të ulët të të ardhurave të familjeve. Është e domosdoshme që zgjidhja të jetë sistemike, ku politikat e strehimit social lokal të jenë dominueset.

- Mungesa e informacionit si dhe procedurat e ndërlikuara për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm kanë qenë shkaqet kryesore për mospërfshirjen e familjeve Rome dhe egjiptiane në procesin e legalizimit.
- Ekzistojnë gjithashtu probleme në lidhje me pronësinë e shtëpisë për 15 familjet Rome dhe 15 familje Egjiptiane, të cilat nuk kanë realizuar privatizimin e shtëpive të tyre, kjo për shkak të mungesës së dokumentacionit, ose mungesës së të ardhurave për të paguar shumën e kërkuar për marrjen e certifikatës së privatizimit.
- Nuk ka procedura specifike përmbështetjen e familjeve Rome dhe egjiptiane të pastreha që të regjistrohen pranë Bashkisë Lushnjë. Kërkohej përshtatje e kriterëve për strehim social, transferim vendbanimi dhe dhënia e ndihmës ligjore nga shteti, duke pasur parasysh gjendjen e shumicës së familjeve Rome dhe egjiptiane që punojnë në sektorët informalë dhe nuk mund të verifikojnë të ardhurat e tyre, jetojnë në baraka dhe nuk kanë kontratë qiraje ose certifikatë pronësie për banesën e tyre, ose kanë nevojë për ndihmë administrative dhe ligjore për të pasur qasje në të drejtat e tyre bazë.
- Mungesa e një strategjie të strehimit social për bashkinë dhe territorin e ri të saj.
- Në data bazën e krijuar për familjet aplikuese për strehim social, nuk ka informacion dhe analiza të thelluara për situatën e strehimit të familjeve Rome dhe egjiptiane.
- Në kushtet kur, një pjesë e mirë e familjeve Rome dhe egjiptiane nuk kanë njohuri mbi të drejtat e tyre për strehim dhe informacionin e nevojshëm për mënyrën e aplikimit për strehim social, mbetet detyrë e bashkisë të informojë këtë komunitet mbi skemat sociale të strehimit.
- Romët dhe egjiptianet nuk kanë qasje në informacion dhe ndihmë të specializuar, përsa i përket legalizimit të shtëpive të tyre. Në këtë mënyrë ata rrezikojnë të humbin mundësinë të bëhen pronarë, si dhe rrezikojnë të nxirren në rrugë nga ndërtues dhe zhvillues të pronave të patundura, të cilët janë më të informuar dhe më të shkathët.
- Informacioni i pamjaftueshëm për shkak të përjashtimit social të këtyre grupeve të popullatës.
- Shpesh familjet Rome që jetojnë në banesa me qera, nuk e disponojnë aktin e qiramarrjes/dokumentit të pronësisë, gjë që e bën të pamundur të vërtetohet rezidenca/adresa e familjes Rome ose egjiptiane. Një dokument alternativ do të ishte një certifikatë e lëshuar nga bashkia e Lushnjës, që mund të sigurojë dhënien e një adrese në mënyrë që të mundësohet identifikimi i familjes.

# ANEKSI

## Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Lushnjë





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË DIVJAKË**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Mars 2017



*Missioners of Social Rights*



## Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Divjakë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Klodioda Sh.p.k. dhe Organizata “Misionarët për të Drejtat Sociale” në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Mars 2017




## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME  | 4  |
| 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian           |    |
| 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI   | 6  |
| 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit                              |    |
| 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË DIVJAKË             | 7  |
| 3.1 Arsimimi   |    |
| 3.2 Punësimi dhe të ardhurat   |    |
| 3.3 Formimi profesional  |    |
| 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM  | 9  |
| 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT | 10 |
| 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN              | 11 |
| 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE  | 18 |
| ANEKSI   | 19 |
| Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Divjakë                          |    |

# 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Bashkia e re e Divjakës përbëhet nga qyteti i Divjakës dhe ish komunat Tërbuf, Grabjan, Remas dhe Gradishtë. Bashkia e re Divjakë kufizohet në veri me bashkinë Rrogozhinë, në lindje me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Kryeqendra e bashkisë së re është qyteti i Divjakës, i shpallur qytet me vendim qeverie në vitin 1996, ajo ka nën administrim një qytet dhe 36 fshatra.



Bashkia e Divjakës është nga të paktat bashki të krijuara nga reforma administrative dhe territoriale e cila përbëhet pothuajse tërësisht nga zona rurale. Bashkia ka shumë përparësi në shtrirjen e saj gjeografike jo vetëm për faktin se ndodhet në një zonë bregdetare, por edhe sepse nëpërmjet afërsisë me arterien kryesore rrugore veri-jug akseson qytete kryesore të vendit. Megjithë shtrirjen e favorshme veri-jug rrugët janë më së shumti në drejtimin lindje-perëndim dhe lidhja rrugore mes qytetit të Divjakës dhe komunave Gradishtë e Remas është e dobët.

## 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian

Bashkia e Divjakes ka hartuar Planin e Përgjithshëm Rregullues, i cili trajton një kompleksitet çështjesh duke përfshirë promovimin dhe rritjen e treguesve social kulturor, zhvillimin ekonomik bazuar në potencialet lokale dhe ato rajonale, përmiresimin e rrjeteve të infrastruktures në nivele të tilla që mund të përballojnë rritjen e mundshme të qytetit në vitet në vazhdim, përdorimin dhe menaxhimin sa më të mirë të tokës, mbrojtjen e mjedisit si dhe rikuperimin ambiantal të zonave tëndotura dhe të rrezikuara. Ky plan tenton të mos jetë thjeshtë një dokument teknik, por një instrument për të stimuluar dhe influencuar ndryshimet social ekonomike.

Gjithashtu Bashkia Divjakë është një ndër prej 26 njësi vendore të përzgjedhura për tu ndihmuar me asistencë teknike dhe financiare nga Qeveria për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Plani Operacional i Zhvillimi Lokal (POZHL) është një instrument planifikimi për Bashkinë dhe pjesë integrale e zbatimit të Reformës Territoriale-Administrative dhe planifikimit për zhvillimin e qëndrueshëm territorial. POZHL ka për qëllim të ofrojë i) përshkrim të situatës aktuale dhe potencialeve natyrore, ekonomike dhe njerëzore, ii) analizën e problemeve iii) analizën SËOT, iv) zgjedhjen e sektorëve prioritarë në kuadër të planit operacional tre-vjeçarë v) fishat e projekteve me mundësi financimi nga buxheti i Bashkisë, fonde të Qeverisë (Fondi i Zhvillimit të Rajoneve), si dhe programe të donatorëve të ndryshëm që operojnë në Shqipëri.

Këto plane kristalizojnë të gjitha potencialet ekonomike dhe njerëzore që ka bashkia e Divjakës, ato krijojnë gjithashtu një udhëzues për investitorë vendas dhe të huaj të cilët do të garantojnë një zhvillim më të qëndrueshëm të kësaj zone me vlera të jashtëzakonshme, duke respektuar mjedisin dhe duke nxitur zhvillim ekonomik dhe social të zonës.

Keto plane kanë bërë mundur që gjatë viteve të fundit kjo bashki të përfitojë nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve një fond prej 795,558,048 lekë për projekte si rivitalizimi i sheshit qendror dhe trotuareve të akseve kryesore, shëtitoren Divjakë-Pishat (e përfunduar); ndërtimin e unazës bujqësore Divjakë-Mertish-3 Urat dhe ndërtimin e rrugës Gradisht-Spolat i Madh, i cili pritet të nisë së shpejti.

Megjithatë nuk ka një plan vendor për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, megjithëse numri i familjeve romë dhe egjiptiane që jetojnë në bashkinë e Divjakës është i konsiderueshem krahasuar me pjesën tjetër të popullatës që jeton në këtë bashki.



## 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI

### 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e Divjakës numëron një popullsi prej 34.254 banorësh ndërkohë që në regjistrin civil rezultojnë një popullsi 53.372 banorë. Territori i bashkisë së re është 309.58 kilometra katrore. Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 110 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrin civil densiteti është 172.40 banorë/km<sup>2</sup>.

**Tabela 1: Numri i familjeve rome dhe egjiptiane sipas vendbanimeve në Bashkinë e Divjakës**

| Nr. | Bashkia (Ish komuna) | Zona          | Familje      | Banore     |
|-----|----------------------|---------------|--------------|------------|
| 1.  | Divjakë /Qytet       | 14,556        | 260          | 81         |
| 2.  | Tërbuf               | 16,525        | 480          | 124        |
| 3.  | Grabjan              | 5,012         | 380          | 96         |
| 4.  | Gradishtë            | 10,220        | 85           | 22         |
| 5.  | Remas                | 6,059         | 42           | 13         |
|     | <b>Total</b>         | <b>53,372</b> | <b>1,247</b> | <b>336</b> |

Burimi i të dhënave: BINSTAT, Census 2011; RGJC 2012

Nëse krahasojmë shifrat e Regjistrimit të popullsisë së 2011, ato janë në masë të madhe më të ulta se shifrat e marra në rrugë administrative nga bashkia e Divjakës. Referuar të dhënave të Regjistrimit të Gjendjes Civile, sipas të cilit në Janar 2015 popullsia e Divjakës rezultojnë 53,372 banorë nga të cilët rreth 27% jetojnë në Divjakë dhe rreth 73% në zonën rurale Tërbuf, Grabjan, Gradishtë dhe Remas. Pjesa më e madhe e popullsisë rome dhe egjiptiane jetojnë në njësitë administrative të Grabjanit rreth 100 familje dhe Tërbufit rreth 124 familje. Pjesa më e madhe e familjeve të vendosura në Bashkinë Divjakë janë të paisur me tokë dhe punojnë në bujqësi.

## 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË DIVJAKË

Sektori mbizotërues në ekonominë e Divjakës është bujqësia, ndonëse kjo zonë ka potenciale ende të pazhvilluara në fushën e turizmit. Bashkia Divjakë ka gjithsej 828 biznese nga të cilët 335 janë të vendosur në qytetin e Lushnjës. Grabiani dhe Tërbufi, si njësi me popullsi të madhe kanë gjithashtu një numër të konsiderueshëm biznesesh. Divjaka është zona më e rëndësishme

Po të vërejmë të ardhurat për frymë shohim se mesatarja e të ardhurave të veta për frymë për të gjitha njësitë është 2,265 lekë. Pas bashkimit në një njësi administrative, ky tregues rritet disi në 2349 lekë për frymë për të gjithë zonën rreth 5% më shumë se mesatarja dhe 29% më shumë se mesatarja (media) i të ardhurave të veta për frymë të njësiteve.

Perioda e gjatë e tranzicionit të ekonomisë dhe shoqërisë, ndryshimi i strukturës së ekonomisë dhe proceset e reformave shpesh herë të pasuksesshme, fragmentarizimi i tokës, mungesa e kooperimit dhe inisiativave për të bashkuar mjetet dhe rritur potencialet e zhvillimit janë disa nga faktorët të cilët reflektojnë nivelin e zhvillimit ekonomik dhe social të zonës. Bashkia e Divjakës në sajë të potencialeve të rëndësishme ekonomike (bujqësi dhe turizëm), ka një përqindje më të ulët të nivelit të papunësisë se mesatarja e vendit (14.1% krahasuar me 15.3%). Megjithatë situata sociale dhe ekonomike në Divjakë, dhe sidomos në zonën rurale është e vështirë pasi ndikohet nga emigracioni i lartë i të rinjve (kryesisht në Itali, Greqi dhe vende të tjera).

Varfëria e pjesëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian është shumëdimensionale dhe e vazhdueshme. Romët dhe egjiptianet në qytetin e Divjakës megjithëse kanë në pronësi tokë vuajnë kushte të këqija jetese, nuk kanë akses në shërbimet publike si kujdes mjekësor dhe arsimim, në tregun e punës, në regjistrimin civil dhe siguri. Romët strehohen në shtëpi të mbipopulluara ku mungojnë kushtet elementare si kanalizimet dhe uji i pijshëm. Në zonat ku janë përqendruar romët, familjet jetojnë në kasolle ose në ndërtesa të papërshtatëshme ku mungojnë hapsirat e domosdoshme dhe kushtet higjieno sanitare.

### 3.1 Arsimimi

Përfshirja e fëmijëve romë në sistemin shkollor ka qenë një nga prioritetet kryesore të politikave të ndërmarra në kuadër të Dekadës së Përfshirjes së Romëve, si në nivel qendror, ashtu dhe atë vendor. Megjithatë, romët në Shqipëri vazhdojnë të kenë nivel më të ulët arsimimi dhe kalojnë më pak vite në shkollë sesa grupet e tjera të popullsisë.

Shkaqet e nivelit të ulët të arsimit në komunitetin Rom dhe egjiptian janë të shumta, por më i rëndësishmi vazhdon të mbetet varfëria ekstreme. Migrimi dhe emigrimi janë faktorë të tjerë që ndikojnë në përqindjen e regjistrimit apo të braktisjes së shkollës nga fëmijët romë dhe egjiptiane. Disa fëmijë nuk regjistrohen në shkollë ose ata e braktisin atë sepse familjet e tyre migrojnë gjatë vitit akademik apo vendosin të shkojnë diku jashtë.

Niveli arsimor mesatar përgjithësisht është në përpjesëtim të drejtë me largësinë gjeografike nga qendrat funksionale, të cilat janë dhe qendra të vjetra urbane me një traditë dhe institucione arsimore. Kjo spjegon edhe faktin pse në Divjakë komuniteti egjiptian është shumë më i pa arsimuar se ai rom. Shifrat e marra nga zyra arsimore e bashkisë, tregojnë se numri i fëmijëve

të pa-arsimuar është shumë më i lartë ai i fëmijëve egjiptian se ai i fëmijëve rom. Gjithashtu fëmijët egjiptianë që nuk kryejnë arsimin fillor janë më të shumtë në numër se ata egjiptianë.

### 3.2 Punësimi dhe të ardhurat

Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike në bashkinë e Divjakës është ndër më të ultit në vend. Kjo sepse pothuaj të gjitha familjet kanë përfituar nga ligji 7501, sipas të cilit familjet rezidente në vitin 1991 kanë përfituar tokë. Megjithatë ka një numër familjesh që rezultojnë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme të cilat nuk kanë përfituar nga ky ligj për shkak të vendosjes në territorin e bashkisë pas vitit 1991. Ky fakt është i vërtetë për rreth 30 familje rome dhe egjiptiane që përfitojnë ndihmë ekonomike si pasojë e pamjaftueshmërisë së të ardhurave për shkak të mungesës së mjeteve të jetesës.

**Tabela 2: Familjet rome dhe egjiptiane përfituese të ndihmësekonome në Divjakë**

| Nr. | Bashkia (Ish komuna) | Familje      | Familje në NE | PAK        |
|-----|----------------------|--------------|---------------|------------|
| 1.  | Fier/Dermenas        | 71           | 6             | 22         |
| 2.  | Fier/ Qendër         | 125          | 32            | 10         |
| 3.  | Fier/ Qendër         | 148          | 50            | 18         |
| 4.  | Fier/Mbrostar        | 80           | 3             | 8          |
| 5.  | Fier/Fier            | 2            | 0             | 0          |
|     | <b>Total</b>         | <b>1,027</b> | <b>129</b>    | <b>125</b> |

Burimi: Të dhëna administrative Bashkia Divjakë-2016

Romët dhe egjiptianet japin disa shkaqe lidhur me nivelin e lartë të varferise së tyre. Sipas tyre këto shkaqe lidhen kryesisht me 'mungesën e mundësive të punësimit për të gjithë' në qytetin e Divjakës, 'nivelin e ulët arsimor' dhe etnicitetin. Megjithë shkallën e lartë të papunisë, romët dhe egjiptianët nuk preferojnë të gjejnë punë nëpërmjet zyrave të punës. Ata pranojnë se paragjykojnë dhe mund të gjejnë punë vetëm nëpërmjet të njohurve ose në rrethin e tyre familjar.

Për sa i takon hapësirës së banimit, rreth 45% e familjeve rome në Divjakë, jetojnë në shtëpi me një apo dy dhoma, me një mesatare me më shumë se 6 persona për familje<sup>1</sup>. Rreth 50% e këtyre shtëpive janë pa ujë të pijshëm brenda. Në njësinë administrative Grabian, megjithëse kemi një numër të konsiderueshem familjesh të strehuar në apartamente, ato paraqesin probleme të mëdha të strehimit. Të vendosur në ato godina përpara viteve 90-te, familjet rome dhe egjiptiane kanë sipërfaqe të pamjaftueshme banimi.

### 3.3 Formimi profesional

Megjithëse pjesëmarrja e të rriturve romë dhe egjiptiane në kurset profesionale ka qenë në rritje, rezultatet tregojnë që nuk janë ndërmarrë veprime efçente për të integruar këtë target grup në tregun e punës. Jo vetem kaq, por edhe kurse e formimit profesional në Divjakë janë të kufizuara pasi ato ofrohen kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile dhe pjesa më e madhe e tyre janë të përqendruara në qytetin e Lushnjes.

<sup>1</sup> Census 2011



## 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM

Në vitin 2014 Ministria e Zhvillimit Urban hapi për herë të parë një program investimi, dedikuar përmirësimit të kushteve të banimit për Komunitetin Rom dhe Egjiptian. Për periudhën 2014 – 2016 është investuar 247 milionë lekë, për rikonstruksionin e plotë të 447 shtëpive të komunitetit Rom dhe Egjiptian, ndër të cilat edhe në Divjakë. Rreth 45 qytetarë kanë përfituar direkt nga investimet e kryera, ndërsa rreth 300 qytetarë janë përfitues indirekt përmes ndërhyrjeve në sistemin e ujësjellës - kanalizimeve. Tetë familje në Grabjan kanë përfituar banesësociale nga enti kombëtar i banesave

**Tabela 3: Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që janë klasifikuar për të qenëpërfituese të programeve të strehimit**

| Programi   | Përshkrimi  | Numri i familjeve përfituese | Nga keto Rom/Egjiptian | Zona |
|--|---|------------------------------|------------------------|------|
| Banesat me kosto të ulët   | Ndërtim i ri  | 22                           | 8                      | na   |
| Subvecionimi i interesit të kredisë së lehtësuar                       | Kredia është dhënë nga banka private për blerjen e shtëpive në treg; interesi subvencionohet pjesërisht nga buxheti i shtetit.        | 0                            | 0                      | na   |
| Strehimi social  | Ndërtim i ri  | 0                            | 0                      | na   |
| Bonusi i strehimit (vlëra)   | Grant nga qeveria lokale për pagesën e qirasë së tregut. Grande nga qeveria qendrore për disa kategori të përcaktuara në ligjin 9232. |                              |                        |      |
| Subvencion i qirasë për banesat sociale me qira në pronësi të bashkive | Grant nga qeveria qendrore për pagesën e qirasë për personat me të ardhura të ulëta.  | 0                            | 0                      | na   |
| Zhvillimi i tokës për qëllime strehimi <sup>1</sup>                    | Zona e ndërtimit dhe shërbimet  | 0                            | 0                      | na   |
| Grante të vogla  | Përmirësimi i kushteve të banimit   | 0                            | 0                      | na   |

## 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT

**Tabela 4: Të dhëna të censusit për cilësinë e banesave të komunitetit rom në Divjakë**


| Bashkia        | Shtëpi private (me tulla, bloqe apo beton) | Apartament në pallat | Kasolle e rrethuar me dërrasa llamarinë apo plamas | Banese e përshtatur në një objekt të përshtatur | E shembur |
|----------------|--|----------------------|--|---|-----------|
| Divjakë /Qytet | 40   | 21                   | 13   | 5   | 2         |
| Tërbuf         | 62   | 21                   | 30   | 8   | 3         |
| Grabjan        | 34   | 51                   | 6  | 4   | 1         |
| Gradishtë      | 22   | 00                   | 0  | 0   | 0         |
| Remas          | 8  | 0                    | 5  | 0   | 0         |

## 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN


**Tabela 5: Situata e familjeve te pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkine Divjakë**

| Emërtimi zonës   | Total | Rome | %   | Egjiptiane | %   |
|--|-------|------|-----|------------|-----|
| Familje gjithsej   | 228   | 108  | 47% | 120        | 53% |
| Familje në nevojë për strehim:                           | 120   | 25   | 21% | 95         | 79% |
| Nuk zotërojnë një hapësirë për të jetuar                 | 19    | 9    | 47% | 10         | 53% |
| Zotërojnë një hapësirë jetese nën standartet e strehimit | 101   | 16   | 16% | 85         | 84% |

**Figura 1: Familje në nevojë për akomodim në Bashkinë Divjake**




**Figura 2: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Fier**



**Tabela 6: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E**

| Lloji i kushteve te strehimit          | Numri      |
|--|------------|
| Jetojne ne tenda, baraka, depo         | 19         |
| Jetojne ne garsionere                  | 3          |
| Jetojne ne apartmente 1+1              | 83         |
| Jetojne ne apartmente 2+1              | 15         |
| Jetojne ne apartmente 3+1 ose me shume | 0          |
| <b>Total</b>                           | <b>120</b> |

**Figura 3: Situata aktuale e akomodimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Divjakë**



Për të përmiresuar kushtet e banesave të komuniteteve rome dhe egjiptiane është analizuar kosto për riparim e banesave ekzistuese, e shtesave te nevojshme te ketyre banesave. Ne shumicen e rasteve banesat kane nevoje per te dyja keto nderhyrje. Për të përcaktuar çmimin e riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë në konsideratë lloji i ndërtimeve e gjendja ekzistuese. Nderhyrja do te konsistoje ne riparimin e muratures,suvatimeve,dyshemve, terraces ose çatisë, tavanit, ndërhyrje në dyert dhe dritaret, riparim dhe zëvendësim i tyre, riparimi i nyjeve hidrosanitare. Nga përlllogaritja, çmimi riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi ka rezultuar nga 7000-11000 lekë/m<sup>2</sup> (mesatarisht 9000 lekë/m<sup>2</sup>). Llogaritjet tregojne qe duhen 300.000 lekë/familje riparime për garsonieret, 500.000 lekë/familje për apartamentet 1+1, 600.000 lekë/familje riparime për apartamentet 2+1 dhe 800.000 lekë/familje riparime për apartamentet 3+1. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përlllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht : garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kjo analizë ka konkluduar me koston 1.200.000 lekë/familje për sipërfaqen shtesë per apartamentet 1+1, 2+1, dhe 3+1 llogaritur si prodhim i sipërfaqes te shteses ne m<sup>2</sup> me çmimin e ndertimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, duke konsideruar sipërfaqen e nevojshme per shtese 30-40 m<sup>2</sup>, (siperfaqe qe do te perfshije nje ambjent dite dhe nje ambjent ndihmes/ nje ambjent gjumi dhe dy ambjente ndihmese ose dy ambjente gjumi sipas secilit rast). Per garsonieret eshte menduar te behet rikonstruksioni i tyre per te zgjidhur

problemet e femijeve te familjeve dhe jo shtese, pasi shtesa ne to nuk justifikon koston e larte te ndertimit si per nga siperfaqja e madhe, ashtu edhe per gjendjen e amortizuar te garsoniereve. Banesat 3+1 kane siperfaqe te mjaftueshme banimi ndaj nuk eshte e nevojshme te ndertohtet shtese. Më poshtë jepet tabela me llogaritjen e koston te riparimeve dhe shtesave të banesave.

### Analiza e Kostove per Rikonstruksionin

Struktura e meposhtme eshte nje zberthim i menyres se shperndarjes se vleres ne me te shumten e rasteve, por kjo menyre eshte variabel sipas situates qe paraqitet.

#### • Ndertim Garsoniere

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 120,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 70,000          |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 50,000          |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 30,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 30,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>300,000</b>  |

#### • Ndertim 1+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 150,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 120,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 110,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 60,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 60,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>500,000</b>  |

#### • Ndertim 2+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 160,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 140,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 130,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 90,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 80,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>600,000</b>  |

• **Ndertim 3+1**

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 170,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 200,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 200,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 120,000         |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 110,000         |
| <b>Total</b> |   | <b>800,000</b>  |

Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstruksion dhe shtesa eshte si me poshte:

- Kosto e rikonstruksionit per garsoniere = numri familjeve \* 300.000 lekë/familje rikonstruksion = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstruksionit + shtesë per apartamente 1+1 = numri familjeve \* 1.700.000 lekë/familje (500.000 lekë/familje rikonstruksion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstruksionit + shtesë per apartamente 2+1 = numri familjeve \* 1.800.000 lekë/familje (600.000 lekë/familje rikonstruksion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstruksionit per apartamente 3+1 = numri familjeve \* 800.000 lekë/familje rikonstruksion = Shuma gjithsej
- **Kosto totale per rikonstruksion + shtesë** = Kosto e rikonstruksionit per garsoniere + Kosto e rikonstruksionit + shtesë per apartamente (1+1) + Kosto e rikonstruksionit + shtesë per apartamente (2+1) + Kosto e rikonstruksionit per apartamente (3+1)

**Tabela 7: Vlerësimi i koston per rikonstruksion + shtesa në Bashkinë Divjakë**

| Tipi         | Kosto per rikonstruksion lekë | Kosto per Shtesa lekë | Nr familjeve | Kosto lekë         |
|--------------|-------------------------------|-----------------------|--------------|--------------------|
| garsoniere   | 300,000                       | -                     | 3            | 900,000            |
| ap 1+1       | 500,000                       | 1,200,000             | 83           | 141,100,000        |
| ap 2+1       | 600,000                       | 1,200,000             | 15           | 27,000,000         |
| ap 3+1       | 800,000                       | -                     | 0            | -                  |
| <b>Total</b> |                               |                       | <b>101</b>   | <b>169,000,000</b> |

**Tabela 8: Aksesi per uje, kanalizime dhe furnizim me energji elektrike I komunitetit R/E ne Bashkine Divjakë**

| Punë ne infrastrukturën inxhinierike (Për secilën zonë) | Gjatesia në metra |
|---|-------------------|
| Rrjeti i furnizimit me ujë                              | 670               |
| Rrjeti i kanalizimeve                                   | 770               |
| Rrjeti i furnizimit me energji elektrike                | 730               |
| Rruge   | 800               |

Ne estimimin qe eshte bere per infrastrukturen ne keto zona eshte parashikuar permiresimi i rrjetit infrastrukturor per te gjithë komunitetin (zonen), pra ky rrjet do ti sherbeje dhe atyre familjeve qe nuk kane nevojë per permiresim te kushteve. Vlerësimi i koston per investimin në infrastrukturë është llogaritur si prodhim i gjatësisë në metra te infrastukturës primare të nevojitur, me çmimin për metër linear për secilin zë. Çmimi eshte percaktuar si mesatare e të njejtit zë në projekte të mëparshme. Zërat e përfshirë në infrastrukturën primare, për te cilët janë marrë të dhëna nga bashkitë përkatëse janë : gjatësia e rrugëve, çmimi për metër linear i llogaritur për afërsisht 30000 lekë/ml (gjeresia e rruges merret 5m si rrjedhoje 1 meter linear gjatesi=5 m<sup>2</sup> sipërfaqe), gjatësia e rrjetit të furnizimit me ujë çmimi 6000 lekë/ml, gjatësia e rrjetit të kanalizimeve, çmimi 8000 lekë/ml dhe gjatësia e rrjetit të furnizimit me energji elektrike, çmimi 4000 lekë/ml. Në rastet kur vlera e zërave te infrastrukturës është 0, si rrjedhojë dhe kosto përkatëse është 0 lekë, tregon se për zërin në fjalë nuk ka nevojë për investim.

Formula e perdorur per vleresimin e koston per infrastrukturen eshte si me poshte:

- Kosto per rrjetin e furnizimit me uje = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per rrjetin e kanalizimeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per furnizimin me energji elektrike = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per ndertimin e rrugeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- **Kosto per infrastrukturen** = Kosto per rrjetin e furnizimit me uje + Kosto per rrjetin e kanalizimeve + Kosto per furnizimin me energji elektrike + Kosto per ndertimin e rrugeve

**Tabela 9: Vlerësimi i koston per infrastrukturen në Bashkinë Divjakë**

| Tipi         | lekë/ ml | Gjatesia në metra | Kosto lekë        |
|--------------|----------|-------------------|-------------------|
| Rrugë        | 30,000   | 800               | 24,000,000        |
| Ujë          | 6,000    | 670               | 4,020,000         |
| Elektrike    | 4,000    | 730               | 2,920,000         |
| Kanalizime   | 8,000    | 770               | 6,160,000         |
| <b>Total</b> |          |                   | <b>37,100,000</b> |

**Tabela 10: Kerkesa e komunitetit R/E per strehim, ne Bashkine Divjakë**

| Lloji i Strehimit  | Nevoja per studim komuniteti Rom | Nevoja per studim komuniteti Egjiptian |
|--|----------------------------------|--|
| Numri i familjeve qe u nevojiten garsoniere                                      | 3                                | 4                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 1+1                                 | 6                                | 6                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 2+1                                 | 0                                | 0                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 deri ne 75,5 m <sup>2</sup>     | 0                                | 0                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 me shume se 75,5 m <sup>2</sup> | 0                                | 0                                      |
| <b>Numri total i familjeve</b>   | <b>9</b>                         | <b>10</b>                              |

Formulat e perdorura per vleresimin e koston per ndertime te reja jane si me poshte:

- Kosto e ndertimeve te reja, garsoniere = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per garsoniere e caktuar 35 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndertimeve te reja, apartamente 1+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 1+1 e caktuar 55 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndertimeve te reja, apartamente 2+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 2+1 e caktuar 67 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndertimeve te reja, apartamente 3+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 3+1 e caktuar 75.5 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- **Kosto totale per ndertime te reja** = Kosto e ndertimeve te reja, garsoniere + Kosto e ndertimeve te reja, apartamente (1+1) + Kosto e ndertimeve te reja, apartamente (2+1) + Kosto e ndertimeve te reja, apartamente (3+1) = Shuma gjithsej

**Tabela 11: Vlerësimi i koston per ndertime të reja në Bashkinë Divjakë**

| Tipi                | lekë/ m <sup>2</sup> | Siperfaqe m <sup>2</sup> | Nr familjeve | Kosto lekë        |
|---------------------|----------------------|--------------------------|--------------|-------------------|
| garsoniere          | 31,360               | 35                       | 7            | 7,683,200         |
| ap 1+1              | 31,360               | 55                       | 12           | 20,697,600        |
| ap 2+1              | 31,360               | 67                       | 0            | -                 |
| ap 3+1              | 31,360               | 75.5                     | 0            | -                 |
| ap 3+1 dhe me shume | 31,360               | 85                       | 0            | -                 |
| <b>Total</b>        |                      |                          | <b>19</b>    | <b>28,380,800</b> |

**Kosto Total në Bashkinë Divjakë - 234,480,800**

Duke u nisur nga situata konkrete dhe nga informacioni qe morem nga Bashkia, menyra qe i pershtatet me shume realitetit, sipas analizes tone, eshte ndertimi i banesave me kosto te ulet, kjo e kombinuar dhe me rikonstruksin dhe me ndertimin e shtesave per banesat ekzistuese. Ndertimi i banesave me kosto te ulet, parashikohet te behet ne hapësirat e lira te zonave ne te cilat keto komunitete jetojne aktualisht. Per shkak te mungeses te informacionit ne lidhje me komunitetin Egjiptian per kerkesa per banesa sociale, eshte menduar qe ne qofte se nga bashkite do te investohet ne kete drejtim, fondi qe do parashikohet per ata familje qe do perfitojne nga banesat sociale, do te zbritet nga fondi qe eshte parashikuar ne kete studim.

Kjo analizë konkludon disa skenarë të rradhitur më poshtë:

#### ► Skenari 1

##### **Rikonstrukcioni dhe shtesa për banesat ekzistuese.**

Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk i plotësojnë kushtet e jetesës. Ato mund të kenë nevojë për:

- Rikonstrukcion të banesave ekzistuese
- Rikonstrukcion + Shtesa në ndërtesat ekzistuese

Familjet që bëjnë pjesë në këtë grup, kanë nevojë për shtesë ambjentesh.

#### ► Skenari 2

##### **Ndërtime të reja.**

Eshte menduar qe permiresimi i kushteve te ketyre familjeve, nisur nga menyra e jeteses qe ato kane, te behet ne hapësirat e zonave ku ata jetojne aktualisht. Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk plotësojnë kushtet minimale të jetesës. Në këtë rast propozohet të bëhen ndërtime të reja për të cilat janë evidentuar sipërfaqet përkatëse për secilin tip apartamenti (garsoniere, apartamente 1+1, 2+1 ose 3+1).

##### **Punime plotësuese me investime në infrastrukturën primare.**

Përveç punimeve në banesat vetjake të secilës familje është parashikuar nevoja edhe për punime në infrastrukturën primare në ndihmë të familjeve Rome apo Egjiptiane.

Këto punime konsistojnë në katër grupe të mëdha:

1. Punime mirëmbajtjeje dhe ndertimit të rrugëve
2. Ndërtim kanalizimesh për ujërat e zeza dhe përmirësimi i pusetave ekzistuese,
3. Ndërtim si dhe riparim i degëzimeve të ujësjellësit. Për të gjitha këto punime janë parashikuar kostot më lart.
4. Shtim i gjatësisë të rrjetit elektrik.

## 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

- ▶ Mungesa e një strategjie të strehimit social për bashkinë dhe territorin e ri të saj.
- ▶ Në buxhetin vjetor të bashkisë nuk ka fonde të parashikuara për strehim, si një zë i veçantë.
- ▶ Nuk ka studime (qoftë edhe pjesore) mbi infrastrukturën e vendbanimeve rome dhe egjiptiane
- ▶ Në data bazën e krijuar për familjet aplikuese për strehim social, nuk ka informacion dhe analiza të thelluara për situatën e strehimit të familjeve rome dhe egjiptiane.
- ▶ Në kushtet kur, një pjesë e mirë e familjeve rome dhe egjiptiane nuk kanë njohuri mbi të drejtat e tyre për strehim dhe informacionin e nevojshëm për menyrën e aplikimit për strehim social, mbetet detyrë e bashkisë të informojë këtë komunitet mbi skemat sociale të strehimit.
- ▶ Romët dhe egjiptianet nuk kanë qasje në informacion dhe ndihmë të specializuar, përsa i përket legalizimit të shtëpive të tyre. Në këtë mënyrë ata rrezikojnë të humbin mundësinë të bëhen pronarë, si dhe rrezikojnë të nxirren në rrugë nga ndërtues dhe zhvillues të pronave të patundura, të cilët janë më të informuar dhe më të shkathët.
- ▶ Informacioni i pamjaftueshëm për shkak të përjashtimit social të këtij grupi të popullatës.
- ▶ Shpesh familjet rome që jetojnë nëbanesa me qera, nuk e disponojnë aktin e qiramarrjes/dokumentit të pronësisë, gjë që e bën të pamundur të vërtetohet rezidenca/adresa e familjes rome ose egjiptiane.

## ANEKSI

### Hartat e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Divjakë





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË FIER**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Mars 2017





## Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Fier me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Klodiada Sh.p.k. dhe Organizata “Misionarët për të Drejtat Sociale” në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Mars 2017




## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME  | 4  |
| 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI   | 5  |
| 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit                              |    |
| 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË FIER                | 6  |
| 3.1 Arsimimi   |    |
| 3.2 Punësimi dhe të ardhurat   |    |
| 3.3 Formimi profesional  |    |
| 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM  | 8  |
| 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT | 9  |
| 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN              | 11 |
| 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE  | 18 |
| ANEKSI   | 19 |
| Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Fier                             |    |

# 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Bashkia e Fierit shtrihet në pjesën perëndimore të Shqipërisë, në jug të fushës së Myzeqesë dhe ndodhet 18 km larg bregut të detit Adriatik. Kjo bashki kufizohet me bashkitë: Divjakë, Lushnje, Roskovec, Mallakastër, Selenicë dhe Vlorë.

Bashkia e Fierit ka një sipërfaqe prej 620 km<sup>2</sup> si dhe një popullsi prej 122.475 banorësh. Ajo përbëhet nga 10 njësi administrative të cilat janë: Fier, Mbrostar, Topojë, Dërmenas, Levan, Frakull, Cakran, Libofshë, Portëz dhe Qendër. Para ndarjes territoriale Bashkia e Fierit, e cila kishte në përbërje të saj vetëm qytetin e Fierit dhe 17 lagjet e tij, kishte një sipërfaqe prej 800 Ha dhe një popullsi prej 82.262 banorë.



# 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI

## 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit

Fieri është ndër qytetet me ritmet më të shpejta të rritjes së popullsisë në vend. Në harkun kohor të 15 viteve të fundit popullsia pothuajse është dyfishuar dhe si pasojë e një urbanizimi intensiv më së shumti informal. Një dukuri e cila shfaqet rëndom në qytet, është konvertimi i tokës bujqësore në zona të banuara dhe krijimi i zonave informale dhe pa shërbime në periferi. Nga ana tjetër, hapësira të tjera, nëpërgjithësi zona ish-industriale, qëndrojnë të braktisura dhe të pashfrytëzuara në nevojën që t'u kthehet funksionaliteti si zona potenciale për zhvillim ekonomik dhe që të frenohet dëmtimi i mëtejshëm i mjedisit.

Në bashkinë e Fierit komuniteti rom dhe egjiptian është vendosur kryesisht në pesë nga nëntë njësitë e reja administrative. Në bashkinë e re të Fierit ka një përqendrim të konsiderueshëm të komunitetit Rom kryesisht në njësinë administrative Levan, Qendër, Mbrostar, Seman dhe Topojë.

Nëse i referohemi shpërndarjes së popullsisë rome vihet re se popullsia më e madhe është e vendosur në zonën e Qendër Fier me rreth 38% të popullsisë rome dhe rreth 21% në njësinë administrative të Levanit (Fier)<sup>1</sup>.

**Tabela 1: Numri i familjeve rom edhe egjiptiane sipas vendbanimeve**

| Nr.          | Bashkia (Ish komuna) | Zona          | Familje      | Banore       |
|--------------|----------------------|---------------|--------------|--------------|
| 1.           | Fier/Dërmenas        | Fshati Baltez | 71           | 320          |
| 2.           | Fier/Qender          | Fshati Clirim | 125          | 760          |
| 3.           | Fier/Qender          | Fshati/Rrom   | 148          | 1000         |
| 4.           | Fier/Mbrostar        | Mbrostar Ura  | 80           | 450          |
| 5.           | Fier/Fier            | Qytet Fier    | 2            | 8            |
| 6.           | Fier/Seman           | Seman/Sektor  | 22           | 85           |
| 7.           | Fier/Levan           | Levan         | 270          | 1000         |
| 8.           | Fier/Dërmenas        | Povelce       | 285          | 900          |
| 9.           | Fier/Topoje          | Topoje        | 24           | 121          |
| <b>Total</b> |                      |               | <b>1,027</b> | <b>4,644</b> |

Burimi i të dhënave: Bashkia Fier të dhëna administrative 2015

<sup>1</sup> Te dhena nga njesite administrative te Bashkise Fier, Dhjetor 2015.

## 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË FIER

### 3.1 Arsimimi

Integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian në shkollë ka qënë një nga sfidat e hasura në qarkun e Fierit. Panvarësisht përpjekejeve për të minimizuar braktisjen e shkollës përseri ngelet i lartë numri i nxënësve që braktisin atë. Sipas anëtareve të komunitetit rom arsyet kryesore të braktisjes shkollore janë: emigracioni, problemet ekonomike si dhe martesat në moshë të hershme, mungesa e aksesit në institucionet arsimore (vendbanimi larg shkollës). Megjithatë pretendimi se shkolla është larg vendbanimit të tyre, ky fakt nuk duket të jetë i vërtetë sepse vendbanimi që ka distancën më të madhe nga shkolla 9-vjecare është vendbanimi i Levanit me 1,4 km. Të gjitha vendbanimet e tjera kanë distancën nga shkolla 9 vjecare më pak se 1 km.

### 3.2 Punësimi dhe të ardhurat

Mundësitë më të mëdha për punësim janë shtyja kryesore të popullsisë romedhe egjiptiane të ardhur në Fier pas viteve 90-të. Me gjithë potencialet, luhajtjet e tregueseve të punësimit kanë qënë të shpeshta edhe për shkak të reformave rristrukturose në ndërmarrjet e mëdha të Nxjerrjes dhe Përpunimit të Naftës, TEC-it, Telekomit etj., si burime të rëndësishme punësimi në Fier. Papunësia zyrtare për 2015 në Fier është 12.9%, ndërsa papunësia tek komuniteti rom në këtë qytet është dukshëm më e lartë, rreth 35%<sup>2</sup>. Por meqenëse gjatë periudhës së tranzicionit ekonomik, punësimi i popullsisë romedhe egjiptiane ishte më tepër një fenomen informal, shkalla e papunësisë duhet të jetë në nivele shumë më të ulta. Pjesa më e madhe e anëtarëve të komunitetit rom kanë zgjedhur tregun informal të punës, kryesisht në mbledhjen e hekurishteve, në tregtinë e robave të përdorura, punët e rastit dhe ndërtim (ndërkohë që shumë i përhapur është edhe fenomeni i lypjes). Këto punë sigurojnë të ardhura të pamjaftueshme për familjet e tyre<sup>3</sup>. Kjo shkallë papunësie shoqërohet nga një nivel i ulët kualifikimi, tkurrje e hapësirave në tregun formal dhe informal të ekonomisë së Bashkisë, të cilat kërcënojnë seriozisht mirëqënien e shumicës së familjeve romedhe egjiptiane.

Vlerësime të nivelit të jetesës, si (LSMS 2018; 2012) tregojnë se 21% e popullsisë romedhe egjiptiane në Fier mund të klasifikohen si ekstremisht të varfër dhe 30% brenda kufirit të plotë të varfërisë. Gjithashtu një pjesë e mirë e familjeve romedhe egjiptiane nuk mund të plotësojnë nevojat e përditshme ushqimore. Një karakteristikë e gjendes ekonomike të këtij komuniteti në Fier është emigracioni. Në pjesën më të madhe individë të familjeve romedhe egjiptiane që kanë një pjestar të familjes emigrant jetojnë me të ardhura të siguruara nga emigracioni. Të dhënat administrative tregojnë se numri i familjeve në situatë të vështirë ekonomike është 129 (Familje përfituese të ndihmës ekonomike) ose 23% e totalit të familjeve.

Tabela 2: Familjet romedhe egjiptiane përfituese të ndihmës ekonomike

| Nr.          | Bashkia (Ish komuna) | Familje      | Familje në NE | PAK        |
|--------------|----------------------|--------------|---------------|------------|
| 1.           | Fier/Dermenas        | 71           | 6             | 22         |
| 2.           | Fier/ Qendër         | 125          | 32            | 10         |
| 3.           | Fier/ Qendër         | 148          | 50            | 18         |
| 4.           | Fier/Mbrostar        | 80           | 3             | 8          |
| 5.           | Fier/Fier            | 2            | 0             | 0          |
| 6.           | Fier/Seman           | 22           | 1             | 4          |
| 7.           | Fier/ Levan          | 270          | 14            | 62         |
| 8.           | Fier/Dermenas        | 285          | 22            | 1          |
| 9.           | Fier/Topoje          | 24           | 1             | 0          |
| <b>Total</b> |                      | <b>1,027</b> | <b>129</b>    | <b>125</b> |

Burimi: Te dhëna administrative 2016

Një ndikim të ndjeshëm në përcaktimin e varfërisë kanë edhe komponentët jomonetarë. Banorët e pyetur në kuadër të këtij projekti, rendisin infrastrukturën e dobët, kushtet jo të mira të jetesës, që lidhen kryesisht me strehimin, praninë e zonave të paurbanizuara etj., si disa nga faktorët që ndikojnë në gjendjen e tyre ekonomike. Në përgjithësi, periferia e qytetit, në të cilën është përqendruar popullsia romedhe egjiptiane, cilësohet si zona më e varfër e cila mbulohet pjesërisht ose aspak nga shërbimet publike bazë të ujësjellës-kanalizimeve dhe të pastrimit, infrastrukturës sociale etj.

### 3.3 Formimi profesional

Numri i personave në komunitetin rom që kanë përfituar nga kurset profesionale falas është shumë i vogël. Në dy vitet 2014-2015 kanë përfituar kurse profesionale 6 anëtarë të komunitetit Rom po asnjë prej tyre nuk ka filluar punë. Numri i ulët i përfituesve nga kurset profesionale është i lidhur me pamundësinë e komunitetit për të mbuluar kostot e transportit për në Qendrën e Formimit Profesional në Fier si dhe me mungesën e besimit nga ana e komunitetit që mund të gjejnë punë pas përfundimit të kursit profesional.

<sup>2</sup> Te dhëna administrative të marra nga Zyra e Punës Fier

<sup>3</sup> FGD organizuar me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, në kuadrin e realizimit të projektit.

## 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM

Situata social ekonomike e komunitetit rom dhe egjiptian ka lidhje me kushtet e strehimit. Pikërisht strehimi, si pasojë e lëvizjeve të shumtademografike në kërkim të burimeve të jetesës, të ardhurave të pakta dhe aksesit të ulët në programet e strehimit social është dhe një nga problemet më serioze me të cilat përballen një pjesë e mirë e komunitetit rom dhe egjiptian. Për më tepër, raportime të shumta dhe vizita në terren tregojnë se në Fier, numri i banesave informale pa perspektivë legalizimi është mjaft i lartë. Ky status i pafavorshëm për banesat e njëpjese të komunitetit rom shënon një perspektivë strehimi mjaft të zymtë dhe vazhdimisht të kërcënuar nga planet urbanistike, investimet publike në infrastrukturë apo kërkesa të kompanive të ndërtimit për të zgjeruar investimet e tyre.

Nga një vlerësim i buxhetit lokal të Bashkisë për vitet 2016 dhe 2017, vëmë re se megjithëse një nga "Programet e zhvillimit të qytetit" është edhe "Programi i strehimit dhe politikave sociale", në Buxhetin e këtij viti (2016) është parashikuar vetëm "Likuidimi i detyrimeve për banesat sociale të ndërtuara", ndërsa për vitin 2017 nuk ka parashikuar asnjë shpenzim për "Strehimin social".

### 4.1 Specifikat e lidhura me kostot e strehimit në bashkinë e Fierit

Në këtë studim janë trajtuar edhe çështje që kanë të bëjnë me tregun e banesave si dhe buxhetet dhe fondet për strehim të alokuara për programet sociale të strehimit. Kështu në bazë të një vrotimi të bërë nga ekipi i ekspertëve për efekt të përlllogaritjeve të strehimit sipas opsioneve të propozuara, kemi cmimet e mëposhtme:

**Tabela 3: Kostot mesatare të qirasë dhe shitjes së apartamenteve në Fier**

| Lloji i apartamentit | Çmimi per Apart të përdorura (në 000 lekë) |         | Çmimi per Apart të reja (në 000 lekë) |
|----------------------|--|---------|---------------------------------------|
|                      | Qerasë (Lekë/muaj)                         | Shitjes | Kostoja e shitjes                     |
| 1 dhomë + kuzhinë    | 6-7  | 1,5-1,8 |                                       |
| 2 dhoma + kuzhinë    | 8-10                                       | 2, -2,5 |                                       |
| 3 dhoma + kuzhinë    | 12-15                                      | 2,7-3   |                                       |
| Enti i Banesave      |  |         | 20                                    |
| Tregu privat         |  |         | 36-42                                 |

Burimi i informacionit: Studimi Janar 2017

## 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT

Lëvizjet demografike dhe procesi i urbanizimit, njohja e pronësisë private mbi tokën, ndjekja e një politike për një ndërhyrje të vogël të shtetit në sektorin e strehimit, të gjithë këta faktorë kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në situatën e strehimit dhe tregun e banesave gjatë periudhës së tranzicionit. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, sektori privat, individët dhe ndërtuesit privatë, kanë mbajtur peshën kryesore në procesin e sigurimit, shpërndarjes dhe konsumit të banesave në Fier gjatë kësaj kohe.

Nga të dhënat e Censurit për banesat dhe popullatën Rome në Shqipëri, Prill 2014, rezultojnë se numri më i madh i familjeve Rome në Bashkinë Fier jetojnë në banesat e llojit shtëpi private. Sipas një vrotimi të bërë nga Departamenti i Strehimit social në bashki.

**Tabela 4: Të dhëna të censurit për cilesinë e banesave e komunitetit rom në Fier**

| Bashkia Fier | Shtëpi private (me tulla, blloqe apo beton) | Apartament në pallat | Kasolle e rrethuar me dërrasa llamarinë apo plamas | Banese e përshtatur në një objekt të përshtatur | E shembur |
|--------------|---|----------------------|--|---|-----------|
| Levan        | 170   | 19                   | 40   | 0   | 0         |
| Mbrostar     | 43  | 0                    | 6  | 0   | 0         |
| Qender       | 136   | 6                    | 33   | 0   | 0         |
| Topoje       | 13  | 0                    | 1  | 0   | 0         |
| Dërmenas     | 84  | 1                    | 5  | 0   | 0         |
| <b>Total</b> | <b>446</b>                                  | <b>26</b>            | <b>85</b>  | <b>0</b>  | <b>0</b>  |

Përsa i përket gjendjes fizike së banesave të komunitetit Rom në Fier, Censusi, i ka vlerësuar si 11% të banueshme, 32% pothuajse të pabanueshme, dhe 25% të pabanueshme. Numri më i madh i familjeve rome të cilat jetojnë në banesa të pabanueshme e zë Levani me 130 familje dhe më pas vjen komuna qendër me 104 familje.

Pavarsisht të dhënave të Censurit në Bashkinë e Fierit ka një bazë të dhënash e krijuar në bazë të aplikimeve të familjeve që konsiderohen të pastreha. Pjesa më e madhe e familjeve kanë aplikuar për banesë sociale me qera, rreth 86% e tyre. Ndërsa 14% e tyre kanë aplikuar për banesë me kosto të ulët ose kredi me kushte lehtësuese.

Sipas informacionit të siguruar nga studimi dhe vecanërisht nga diskutimet me grupet e interesit, përdorimi dhe aksesin në programet e strehimit social nga komuniteti rom dhe egjiptian është mjaft i ulët. Shume pak prej pjesëmarrësve nga ky komunitet pohojnë se ekziston një institucion që ofron këtë shërbim në zonën ku ata banojnë. Kjo gjë është e qartë edhe nga të dhënat e siguruar nga studimi. Ndër 960 familje që kanë aplikuar për të fituar statusin e të pastrehit në bashkinë e Fierit vetëm 5 janë familje Rome (Pyetsori i plotësuar nga bashkia e Fierit).


## PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN

**Tabela 5: Numri i familjeve që kanë aplikuar për të përfituar statusin “i pa-strehe” në bashkinë Fier, sipas etnicitetit**

| Vitet              | Gjithsej | R&E | %     |
|--------------------|----------|-----|-------|
| deri ne vitin 2014 | 865      | 5   | 0.6%  |
| 2015               | 145      | 5   | 3.5%  |
| 2016               | 40       | 5   | 12.5% |

Megjithëse në terma relative numri i familjeve rome dhe egjiptiane që kanë aplikuar për të marrë statusin e të pastrehit është rritur ndjeshëm nga viti në vit, përsëri ky numër nuk përfaqëson situatën e vërtetë të familjeve me problem të strehimit nga ky komunitet. Skemat e mbështetjes me strehim, janë pothuaj të panjohura për familjet rome dhe egjiptiane. Një problem tjetër që hasin këto familje në procesin e aplikimit është informaliteti. Ashtu sic është theksuar edhe në paragrafet e mësipërm, një pjesë e konsiderueshme e kësaj popullsie është e parregjistruar në vendbanimet ku janë vendosur. Kjo gjë krijon vështiresi në plotësimin e dokumentacionit dhe vërtetimin e të ardhurave, statusit të punësimit, gjendjes familjare etj. Për rjedhoje edhe si përfitues romët dhe egjiptianët janë në minorancë.

**Figura 1: Familjet që kanë përfituar nga skemat e strehimit social sipas viteve**




Por pavarishtë të dhënave, nga studimi vlerësohet një numër shumë më i madh i familjeve rome dhe egjiptiane me probleme të strehimit.


**Tabela 6: Situata e familjeve të pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Fier**

| Emërtimi zonës   | Total | Rome | %   | Egjiptiane | %   |
|--|-------|------|-----|------------|-----|
| Familje gjithsej   | 871   | 858  | 99% | 13         | 1%  |
| Familje në nevojë për strehim:                           | 450   | 437  | 97% | 13         | 3%  |
| Nuk zotërojnë një hapësirë për të jetuar                 | 70    | 60   | 86% | 10         | 14% |
| Zotërojnë një hapësirë jetese nën standartet e strehimit | 380   | 377  | 99% | 3          | 1%  |

**Figura 2: Familje në nevojë për akomodim në Bashkinë Fier**




**Figura 3: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Fier**



**Tabela 7: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E**

| Lloji i kushteve te strehimit          | Numri      |
|--|------------|
| Jetojne ne tenda, baraka, depo         | 70         |
| Jetojne ne garsionere                  | 80         |
| Jetojne ne apartmente 1+1              | 130        |
| Jetojne ne apartmente 2+1              | 160        |
| Jetojne ne apartmente 3+1 ose me shume | 10         |
| <b>Total</b>                           | <b>450</b> |

**Figura 4: Situata aktuale e akomodimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Fier**



Për të përmiresuar kushtet e banesave të komuniteteve rome dhe egjiptiane është analizuar kosto për riparim e banesave ekzistuese, e shtesave te nevojshme te ketyre banesave. Ne shumicen e rasteve banesat kane nevojte per te dyja keto nderhyrje. Për të përcaktuar çmimin e riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë në konsideratë lloji i ndërtimeve e gjendja ekzistuese. Nderhyrja do te konsistoje ne riparimin e muratures,suvatimeve,dyshemve, terraces ose çatisë, tavanit, ndërhyrje në dyert dhe dritaret, riparim dhe zëvendësim i tyre, riparimi i nyjeve hidrosanitare. Nga përlllogaritja, çmimi riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi ka rezultuar nga 7000-11000 lekë/m<sup>2</sup> (mesatarisht 9000 lekë/m<sup>2</sup>). Llogaritjet tregojne qe duhen 300.000 lekë/familje riparime për garsonieret, 500.000 lekë/familje për apartamentet 1+1, 600.000 lekë/familje riparime për apartamentet 2+1 dhe 800.000 lekë/familje riparime për apartamentet 3+1. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përlllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht : garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kjo analizë ka konkluduar me koston 1.200.000 lekë/familje për sipërfaqen shtesë per apartamentet 1+1, 2+1, dhe 3+1 llogaritur si prodhim i siperfaqes te shteses ne m<sup>2</sup> me çmimin e ndertimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, duke konsideruar siperfaqen e nevojshme per shtese 30-40 m<sup>2</sup>, (siperfaqe qe do te perfshije nje ambjent dite dhe nje ambjent ndihmes/ nje ambjent gjumi dhe dy ambjente ndihmese ose dy ambjente gjumi sipas secilit rast). Per garsonieret eshte menduar te behet rikonstruksioni i tyre per te zgjidhur problemet e femijeve te familjeve dhe jo shtese, pasi shtesa ne to nuk justifikon koston e larte te ndertimit si per nga siperfaqja e madhe, ashtu edhe per gjendjen e amortizuar te garsoniereve. Banesat 3+1 kane siperfaqe te mjaftueshme banimi ndaj nuk eshte e nevojshme te ndertohet shtese. Më poshtë jepet tabela me llogaritjen e koston te riparimeve dhe shtesave të banesave.

## Analiza e Kostove per Rikonstruksionin

Struktura e meposhtme eshte nje zberthim i menyres se shperndarjes se vleres ne me te shumten e rasteve, por kjo menyre eshte variabel sipas situates qe paraqitet.

### • Ndertim Garsoniere

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 120,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 70,000          |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 50,000          |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 30,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 30,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>300,000</b>  |

### • Ndertim 1+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 150,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 120,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 110,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 60,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 60,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>500,000</b>  |

### • Ndertim 2+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 160,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 140,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 130,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 90,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 80,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>600,000</b>  |

### • Ndertim 3+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 170,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 200,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 200,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 120,000         |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 110,000         |
| <b>Total</b> |   | <b>800,000</b>  |

Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstrukcion dhe shtesa eshte si me poshte:

- Kosto e rikonstrukcionit per garsoniere = numri familjeve \* 300.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 1+1 = numri familjeve \* 1.700.000 lekë/familje (500.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 2+1 = numri familjeve \* 1.800.000 lekë/familje (600.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit per apartamente 3+1 = numri familjeve \* 800.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- **Kosto totale per rikonstrukcion + shtesë** = Kosto e rikonstrukcionit per garsoniere + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (1+1) + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (2+1) + Kosto e rikonstrukcionit per apartamente (3+1)

**Tabela 8: Vlerësimi i koston per rikonstrukcion + shtesa në Bashkinë Fier**

| Tipi         | Kosto per rikonstrukcion lekë | Kosto per Shtesa lekë | Nr familjeve | Kosto lekë         |
|--------------|-------------------------------|-----------------------|--------------|--------------------|
| garsoniere   | 300,000                       | -                     | 80           | 24,000,000         |
| ap 1+1       | 500,000                       | 1,200,000             | 130          | 221,000,000        |
| ap 2+1       | 600,000                       | 1,200,000             | 160          | 288,000,000        |
| ap 3+1       | 800,000                       | -                     | 10           | 8,000,000          |
| <b>Total</b> |                               |                       | <b>380</b>   | <b>541,000,000</b> |

**Tabela 9: Aksesi per uje, kanalizime dhe furnizim me energji elektrike I komunitetit R/E ne Bashkine Fier**

| Punë ne infrastrukturën inxhinierike (Për secilën zonë) | Gjatesia në metra |
|---|-------------------|
| Rrjeti i furnizimit me ujë                              | 900               |
| Rrjeti i kanalizimeve                                   | 1600              |
| Rrjeti i furnizimit me energji elektrike                | 0                 |
| Rruge   | 1600              |

Ne estimimin qe eshte bere per infrastrukturën ne keto zona eshte parashikuar permiresimi i rrjetit infrastrukturor per te gjithë komunitetin (zonen), pra ky rrjet do ti sherbeje dhe atyre familjeve qe nuk kane nevojë per permiresim te kushteve. Vlerësimi i koston për investimin në infrastrukturë është llogaritur si prodhim i gjatësisë në metra te infrastukturës primare të nevojitur, me çmimin për metër linear për secilin zë. Çmimi eshte percaktuar si mesatare e të njejtit zë në projekte të mëparshme. Zërat e përfshirë në infrastrukturën primare, për te cilët janë marrë të dhëna nga bashkitë përkatëse janë : gjatësia e rrugëve, çmimi për metër linear i llogaritur përafërsisht 30000 lekë/ml (gjerësia e rruges merret 5m si rrjedhoje 1 meter linear gjatesi=5 m<sup>2</sup> siperfaqe), gjatësia e rrjetit të furnizimit me ujë çmimi 6000 lekë/ml, gjatësia e rrjetit të kanalizimeve, çmimi 8000 lekë/ml dhe gjatësia e rrjetit të furnizimit me energji elektrike, çmimi 4000 lekë/ml. Në rastet kur vlera e zërave te infrastrukturës është 0, si rrjedhojë dhe kosto përkatëse është 0 lekë, tregon se për zërin në fjalë nuk ka nevojë për investim.

Formula e perdorur per vleresimin e koston per infrastrukturën eshte si me poshte:

- Kosto per rrjetin e furnizimit me uje = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per rrjetin e kanalizimeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per furnizimin me energji elektrike = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per ndertimin e rrugeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- **Kosto per infrastrukturën** = Kosto per rrjetin e furnizimit me uje + Kosto per rrjetin e kanalizimeve + Kosto per furnizimin me energji elektrike + Kosto per ndertimin e rrugeve



**Foto nga vendbanimet R/E**

**Tabela 10: Vlerësimi i koston per infrastrukturën në Bashkinë Fier**

| Tipi         | lekë/ ml | Gjatesia në metra | Kosto lekë        |
|--------------|----------|-------------------|-------------------|
| Rrugë        | 30,000   | 1,600             | 48,000,000        |
| Ujë          | 6,000    | 900               | 5,400,000         |
| Elektrike    | 4,000    | -                 | -                 |
| Kanalizime   | 8,000    | 1,600             | 12,800,000        |
| <b>Total</b> |          |                   | <b>66,200,000</b> |

Nevojat për ndërtime të reja perfshin ata që banojnë në kasolle si edhe në banesa që nuk kanë siguri për jetën si: tenda, baraka, depo. Sipas kriterëve dhe normativave të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr 824 datë 3.12.2004 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" eshte berë dhe vlerësimi i koston për keto ndërtime. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, eshte përlllogaritur sipërfaqja

minimale që u takon, përkatësisht : garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kosto e ndërtimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë për çdo qytet nga manuali i qeverisë në qershor 2015: "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive për vitin 2015". Më poshtë jepen formulat e llogaritjes të koston të ndërtimeve të reja dhe tabela përkatëse me rezultatet.

**Tabela 11: Kërkesa e komunitetit R/E per strehim, ne Bashkine Fier**

| Lloji i Strehimit  | Nevoja per studim komuniteti Rom | Nevoja per studim komuniteti Egjiptian |
|--|----------------------------------|--|
| Numri i familjeve qe u nevojiten garsoniere                                      | 10                               | 5                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 1+1                                 | 25                               | 3                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 2+1                                 | 20                               | 2                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 deri ne 75,5 m <sup>2</sup>     | 5                                | 0                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 me shume se 75,5 m <sup>2</sup> | 0                                | 0                                      |
| <b>Numri total i familjeve</b>   | <b>60</b>                        | <b>10</b>                              |

Formulat e perdorura per vleresimin e koston per ndertime te reja jane si me poshte:

- Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per garsoniere e caktuar 35 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 1+1 = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 1+1 e caktuar 55 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 2+1 = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 2+1 e caktuar 67 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 3+1 = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 3+1 e caktuar 75.5 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- **Kosto totale per ndërtime te reja** = Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (1+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (2+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (3+1) = Shuma gjithsej

**Tabela 12: Vlerësimi i koston per ndertime të reja në Bashkinë Fier**

| Tipi         | lekë/ m <sup>2</sup> | Sipërfaqe m <sup>2</sup> | Nr familjeve | Kosto lekë         |
|--------------|----------------------|--------------------------|--------------|--------------------|
| garsoniere   | 31,599               | 35                       | 15           | 16,589,475         |
| ap 1+1       | 31,599               | 55                       | 28           | 48,662,460         |
| ap 2+1       | 31,599               | 67                       | 22           | 46,576,926         |
| ap 3+1       | 31,599               | 75.5                     | 5            | 11,928,623         |
| <b>Total</b> |                      |                          | <b>70</b>    | <b>123,757,484</b> |

**Kosto Total në Bashkinë Fier - 730,957,484**

Duke u nisur nga situata konkrete dhe nga informacioni qe morem nga Bashkia, menyra qe i pershtatet me shume realitetit, sipas analizes tone, eshte ndertimi i banesave me kosto te ulet, kjo e kombnuar dhe me rikonstruksionin dhe me ndertimin e shtesave per banesat ekzistuese. Ndertimi i banesave me kosto te ulet, parashikohet te behet ne hapesirat e lira te zonave ne te cilat keto komunitete jetojne aktualisht. Per shkak te mungeses te informacionit ne lidhje me komunitetin Egjiptian per kerkesa per banesa sociale, eshte menduar qe ne qofte se nga bashkita do te investohet ne kete drejtim, fondi qe do parashikohet per ata familje qe do perfitojne nga banesat sociale, do te zbritet nga fondi qe eshte parashikuar ne kete studim.

Kjo analizë konkludon disa skenarë të rradhitur më poshtë:

► **Skenari 1**

**Rikonstruksioni dhe shtesa për banesat ekzistuese.**

Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk i plotësojnë kushtet e jetesës. Ato mund të kenë nevojë për:

- Rikonstruksion të banesave ekzistuese
- Rikonstruksion + Shtesa në ndërtesat ekzistuese

Familjet që bëjnë pjesë në këtë grup, kanë nevojë për shtesë ambjentesh.

► **Skenari 2**

**Ndërtime të reja.**

Eshte menduar qe permiresimi i kushteve te ketyre familjeve, nisur nga menyra e jeteses qe ato kane, te behet ne hapesirat e zonave ku ata jetojne aktualisht. Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk plotësojnë kushtet minimale të jetesës. Në këtë rast propozohet të bëhen ndërtime të reja për të cilat janë evidentuar sipërfaqet përkatëse për secilin tip apartamenti (garsoniere, apartamente 1+1, 2+1 ose 3+1).

**Punime plotësuese me investime në infrastrukturën primare.**

Përveç punimeve në banesat vetjake të secilës familje është parashikuar nevoja edhe për punime në infrastrukturën primare në ndihmë të familjeve Rome apo Egjiptiane.

Këto punime konsistojnë në katër grupe të mëdha:

1. Punime mirëmbajtjeje dhe ndertimit të rrugëve
2. Ndërtim kanalizimesh për ujërat e zeza dhe përmirësimi i pusetave ekzistuese,
3. Ndërtim si dhe riparim i degëzimeve të ujësjellësit. Për të gjitha këto punime janë parashikuar koston më lart.
4. Shtim i gjatësisë të rrjetit elektrik.




## 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE


Romët dhe egjiptianët në Bashkinë e Fierit, janë grupe të përjashtuara me nevoja sociale dhe ekonomike, ku nevoja për strehim është me rëndësishmja (nga DGF me përfaqësues të komunitetit). Nevojën për strehim ky komunitet nuk mund ta zgjidhë në mënyrë individuale për shkak të nivelit shumë të ulët të të ardhurave të familjeve. Është e domosdoshme që zgjidhja të jetë sistemike, ku politikat e strehimit social lokal të jenë dominueset.

- ▶ Mungesë e politikave lokale konsekuente dhe të vazhdueshme të strehimit social.
- ▶ Pamundësi e Bashkisë së Fierit për të siguruar buxhetin e nevojshëm, nga burimet e veta, për përballimin e nevojave të strehimit social. Deri në vitin 2011-12, bashkia ka mundur të sigurojë një fond 35,000,000 leke për ndertimin e 3 banesave sociale, ku janë strehuar një numer i pakonsiderueshem i familjeve rome dhe egjiptiane krahasur me nevojat.
- ▶ Bashkia e Fierit ka eksperiencë të mira të bashkëpunimit me institucione publike dhe private për sigurimin e mjeteve monetare për ndërtimin e banesave sociale.
  - Bashkia e Fierit ka nënshkruar një Marreveshje nënhuaje (Ministria e Financave me cilësinë e huadhënësit dhe Bashkia Fier me cilësinë e huamarrësit) nëpërmjet Bankës për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB).
  - Enti Kombëtar i Banesave me cilësinë e investitorit në ndërtimin e dy banesave (gjithsej 75 apartamente në dy sip, truallit të dhuruara nga Bashkia Fier në funksion të programit social të strehimit të banesave me kosto të ulët).
- ▶ Nuk ka studime (qoftë edhe pjesore) mbi infrastrukturën e vendbanimeve rome dhe egjiptiane
- ▶ Në bashkinë e Fierit me gjithë data bazën e krijuar për familjet aplikuese për statusin e të pastrehit, nuk ka informacion dhe analiza të thelluara për situatën e strehimit të këtyre familjeve.
- ▶ Në kushtet kur, një pjesë e mirë e familjeve rome dhe egjiptiane nuk kanë njohuri mbi të drejtat e tyre për strehim dhe informacionin e nevojshëm për mënyrën e aplikimit për strehim social, mbetet detyrë e bashkisë të informojë këtë komunitet mbi skemat sociale të strehimit.
- ▶ Të jetuarit në familje të mëdha, përkeqëson statusin e strehimit të këtyre familjeve.
- ▶ Pamundësia ekonomike për të siguruar individualisht nevojat për strehim. Rreth 34% e familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, përfituese të ndihmës ekonomike, janë nga komuniteti rom dhe egjiptian.
- ▶ Informacioni i pamjaftueshem për shkak të përjashtimit social të këtij grupi të popullatës.
- ▶ Informaliteti i këtij grupi, në aspekte të ndryshme sic janë rregjistrimi në zyrat e gjendjes civile, zyrat e punës, vërtetimi për të ardhurat etj.

## ANEKSI

### Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Fier





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË BERAT**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Mars 2017



BASHKIA BERAT

## Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Berat me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Klodioda Sh.p.k. dhe Organizata “Misionarët për të Drejtat Sociale” në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Mars 2017




## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME  | 4  |
| 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian           |    |
| 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI   | 5  |
| 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit                              |    |
| 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË BERAT               | 6  |
| 3.1 Arsimimi   |    |
| 3.2 Punësimi dhe të ardhurat   |    |
| 3.3 Formimi profesional  |    |
| 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM  | 8  |
| 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT | 10 |
| 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN              | 11 |
| 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE  | 18 |
| ANEKSI   | 20 |
| Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Berat                            |    |

# 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Qyteti i Beratit është i vendosur në Shqipërinë Jug-Qendrore. Qyteti ka një sipërfaqe prej 939 km<sup>2</sup> dhe popullsi prej 65 mijë banorë. Berati është një ndër qytetet më të vjetër të Shqipërisë dhe ka një trashëgimi kulturore unike, tashmë pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Qyteti i vjetër është një qendër e rëndësishme për zhvillimin e turizmit në vend.

Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Berati, Otlaku, Roshniku, Velabisht dhe Sinjë. Berati ka një pozicion gjeografik të favorshëm për instalimin e një infrastrukture moderne dhe të kompletuar. Vendndodhja e tij, mjedisi gjeografik, arkitektura dhe trashëgimia e tij urbane e bejnë qytetin tërheqës për turistët dhe të përshtatshëm për zhvillimin e një cilësie jete të mire për qytetarët e tij.



## 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian

Plani i Veprimit për "Për Dekadën e Përfshirjes së Romëve", Qarku Berat, është një dokument i hartuar në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit të Dekadës Rome. Ky plan thekson këto prioritet: arsimit, punësimi, shëndetësinë, mbrojtja sociale, dhe mundësitë e barabarta. Ai reflekton plotësisht standardet e të drejtave të njeriut të parashikuara si në legjislativonin shqiptar, ashtu edhe atë ndërkombëtar. Ky dokument është konsideruar nga grupi i ekspertëve për të detajuar nevojat sociale të këtij komuniteti.

# 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI

## 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit

Sipas të dhënave në Bashkinë e Beratit jetojnë rreth 670 familje rome dhe egjiptiane. Romët dhe egjiptianët në Bashkinë e Beratit janë përqëndruar kryesisht në qytet dhe në njesinë administrative të ish komunës Otllak. Në qytet komuniteti rom përbëhet nga 120 familje rome me një popullsi rreth 600 banorë. Familjet rome janë të përqëndruara në Rajonin Administrativ 2 të bashkisë dhe kanë natyrë endacake.

Njësia administrative Otllak është një nga zonat me një përqëndrim të lartë të komunitetit rom. Në të janë vendosur rreth 197 familje rome. Popullsia rome e kësaj komune llogaritet rreth 931 banorë të vendosur kryesisht në fshatin Moravë. Në këtë fshat jetojnë shumica dërmuese e komunitetit rom të kësaj njësie administrative, megjithatë familje rome ka edhe në fshatra të tjerë të saj, si në Orizaj dhe në Lapardha. Edhe pse komuniteti rom në këtë zonë ka marrë herë pas here vëmendjen e nismave për fuqizimin dhe integrimin e tyre, nuk është bërë thujtë asgjë për vlerësimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të këtij komuniteti.

Të dhënat tregojnë se shpërndarja e këtyre familjeve sipas vendbanimeve kryesore është si në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 1: Numri i familjeve romedhe egjiptiane sipas vendbanimeve në Bashkinë e Beratit**

| Nr.          | Bashkia (Ish komuna) | Zona                                 | Familje     | Banore      |
|--------------|----------------------|--------------------------------------|-------------|-------------|
| 1.           | Berat/Qytet          | Periferi te qytetit prane lumit Osum | 670         | 3350        |
| 2.           | Berat/ Otllak        | Lapardhaja                           | 61          | 286         |
| 3.           | Berat/ Otllak        | Orizaj                               | 44          | 208         |
| 4.           | Berat/ Otllak        | Morave                               | 92          | 434         |
| <b>Total</b> |                      |                                      | <b>1504</b> | <b>4278</b> |

Burimi i të dhënave: Bashkia Beratit2015

Identifikimi i numrit të romëve dhe egjiptianeve në Bashkinë e Beratit, paraqet disa problematika që lidhen me: rregjistrimin e fëmijëve për herë të parë, levizshmërinë e familjeve rome, emigracionin si dhe ndërtimet pa leje. Të dhënat e mësipërme të popullsisërome janë siguruar nga burime dytësore dhe jo drejtpërsëdrejti nga Gjendja civile e Bashkisëapo nga Censusi "Banesat dhe popullata rome në Shqipëri". Ekipi i studimit gjeti në Berat, të dhëna kontradiktore lidhur me numrin e popullsisë së romeve dhe egjiptianeve banues në qytetin e Beratit. Nisur nga kjo, të dhënat e konsideruara në këtë studim janë marre nga Bashkia e Beratit e cila i referohet një vlerësimi të bërë nga organizatat jo-qeveritare në vitin 2015.

Po sipas këtij vlerësimi, emigrimi i të rinjve Romë dhe Egjiptianë në Bashkinë e Beratit, është shumë i lartë dhe ndikon në situatën social ekonomike të këtij komuniteti.

## 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË BERAT

### 3.1 Arsimimi

Niveli arsimor i komunitetit rom dhe egjiptian në Bashkinë e Beratit është përkeqësuar gjatë tranzicionit. Pavarësisht faktit se ka një përmirësim pas vitit 2000 në krahasim me vitet '90 niveli i tyre arsimor dhe rritja e hendekut krahasuar me popullsinë në shumicë përbën një nga shkaqet kryesore të papunësisë dhe varfërisë së familjeve rome dhe egjiptiane. Shumica e anëtarëve të komunitetit rom nuk kanë ndjekur arsimin bazë 9-vjeçar. Sipas të dhënave nga zyra arsimore në Berat, ka rreth 111 fëmijë rom të moshës 0-18 vjeç që nuk arrijnë të përfundojnë arsimin e mesëm pjesërisht sepse familjet e tyre jetojnë në varfëri të theksuar dhe angazhimit të fëmijëve në punë<sup>1</sup>. Ndjekja e shkollës nga anëtarët e komunitetit egjiptian është më e lartë në krahasim me anëtarët e komunitetit rom. Shumë të rinj të komunitetit egjiptian ndjekin arsimin e lartë dhe pasuniversitar. Komuniteti egjiptian përgjithësisht merr mësim në shkollën 9-vjeçare "Xhemal Cekini," "Thimi Tani" dhe në shkollën e mesme të bashkuar "Shyqyri Lakra".

### 3.2 Punësimi dhe të ardhurat

Të ardhurat e familjeve rome dhe egjiptiane në Bashkinë Berat, sigurohen kryesisht përmes tregut informal të punës. Megjithatë nuk ka të dhëna të detajuara për nivelin e papunësisë së romeve dhe egjiptianëve, perceptimi i marrë nga DGF është që punësimi përbën një prej problemeve më të rëndësishme me të cilin duhet të përballen anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian. Rreth 90% e romëve dhe egjiptianëve nuk kanë kontratë pune dhe nuk paguajnë sigurime shoqërore. Si pasojë e varfërisë dhe përjashtimit nga tregu formal i punës, këto komunitete janë të angazhuar kryesisht në tregtimin e rrobave të përdorura, mbledhjen dhe riciklimin e mbetjeve metalike, sektorin e ndërtimit, ndërkohë që shumë i përhapur është edhe fenomeni i lypjes. Angazhimi në këto punë siguron të ardhura të pamjaftueshme për familjen rome dhe egjiptiane. Përsa i përket punësimit romët dhe egjiptianët përballen edhe me barrierë të fshehta, siç janë diskriminimi dhe stigmatizimi e të qenit rom/egjiptian, shpeshësia e migrimit, mungesa e kartave të identitetit dhe të dokumenteve të tjera personale dhe administrative, mungesa e informacionit mbi ekzistencën e programeve të punësimit, etj<sup>2</sup>.

Në bazë të të dhënave të Drejtorisë së Shërbimit Social, 175 familje trajtohen me ndihmë ekonomike ose rreth 12% e totalit të familjeve rome dhe egjiptiane. Niveli relativisht ulët i numrit të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike shpejtohet me faktin se një pjesë e mirë e familjeve që jetojnë në zonën rurale kanë tokë në pronësi. Po kështu lëvizshmëria e familjeve rome i penalizon ata për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike.

Tabela 2: Familjet rome dhe egjiptiane përfituese të ndihmës ekonomike në Berat

| Nr. | Bashkia (Ish komuna) | Familje     | Familje në NE    | PAK       |
|-----|----------------------|-------------|------------------|-----------|
| 1.  | Berat qytet          | 670         | 134 (20%)        | 62        |
| 2.  | Lapardhaja           | 61          | 28 (45%)         | 4         |
| 3.  | Orizaj               | 44          | 3(6%)            | 0         |
| 4.  | Morave               | 92          | 10(10%)          | 1         |
|     | <b>Total</b>         | <b>1504</b> | <b>175 (12%)</b> | <b>67</b> |

Burimi: Te dhëna administrative Bashkia Berat -2016

Krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë, niveli i varfërisë i familjeve rome dhe egjiptiane është shumë i lartë dhe hendeku në krahasim me popullsinë në shumicë ka ardhur në rritje. Familjet e varfra dhe shumë të varfra rome dhe egjiptiane përballen me nivele të larta të përjashtimit social, sepse ato janë më pak të afta të përballojnë nevojat e jetës së përditshme dhe kanë më pak mundësi të marrin pjesë në proceset që ndikojnë në përmirësimin e jetesës së tyre, të tilla si punësimi dhe arsimimi. Për shumë familje rome dhe egjiptiane burimi i të ardhurave përbëhet nga transfertat si psh. pagesa e ndihmës ekonomike, pensionet e pleqërisë, pagesa e papunësisë, pagesa për aftësinë e kufizuar dhe pensionet për jetimët. Bazuar në të dhënat e Censurit 2014<sup>3</sup>, 40% e familjeve rome dhe egjiptiane në Berat janë me të ardhura nën 5,000 lekë në muaj, 40% e familjeve kanë të ardhura 5,001-10,000 lekë në muaj dhe vetëm 20% kanë deklaruar të ardhura 10,001-15,000 lekë në muaj.

### 3.3 Formimi profesional

Në Berat nuk ekziston asnjë qendër publike e formimit profesional e cila të ofrojë trajnime profesionale për të rinjtë. Mungesa e një qendre të tillë bën që të rinjtë të mos përfitojnë nga programet të përshtatura për romët dhe egjiptianët që ofrohen falas për ta, dhe qënë perspektivëtë sigurojnë një mundësi më të favorshme për punësim dhe rritjen e nivelit të jetesës. Vetëm një numër i kufizuar individësh nga komuniteti rom kanë marrë kurse të formimit profesional si parukier, kamerier, kuzhinier etj., ofruar nga organizata të shoqërisë civile dhe të financuara nga programe dhe donacione të huaja<sup>4</sup>.

1 Studim i bere ne kuadrin e hartimit te Plan Ndër-Vendor i Zhvillimit të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane nga Bashkia e Beratit 2014

2 PNUD, Vlerësimi i nevojave të individëve romë dhe egjiptianë për punësimin dhe sipërmarrjen në rrethin e Korçës, Beratit dhe Vlorës, i përgatitur nga Krisela Hackaj, f. 21.

3 OSFA

4 Studim i bere ne kuadrin e hartimit te Plan Ndër-Vendor i Zhvillimit të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane nga Bashkia e Beratit 2014

Bashkia Berat e ka vlerësuar strehimin si një nga prioritetet e politikave të saj sociale. Familjet që paraqesin kërkesën e tyre për strehim pranë Bashkisë, janë kryesisht familje me të ardhura të ulta, të cilat për shkak të mungesës së burimeve të tyre financiare, kërkojnë mbështetjen e institucioneve vendore për zgjidhjen e problemit të strehimit. Ky numër deri tani ka arritur në rreth 800 aplikant<sup>5</sup>.

Eksperiencat e bashkëpunimit të Bashkisë së Beratit për ndërtimin e banesave sociale janë positive. Kështu në vitin 2008 Bashkia Beratit nënshkroi me Qeverinë Shqiptare, kontratën e nën-huase për projektin “Ndërtimi i Banesave me Qëllim Social”. Ky projekt u realizua me bashkëfinancimin e Bankës së Këshillit të Europës, Qeverisë Shqiptare dhe Bashkisë së Beratit. Nëpërmjet këtij projekti u realizua ndërtimi i dyndërtesave 6 –katëshe me 24 apartamente në lagjen Murat Celebiu. Një rëndësi të veçantë bashkia i kushtoi dhe infrastruktures rrugore duke ndërtuar rrugën “Pal Golemi” si dhe kanalin e ujërave të zeza, të cilat ishin një problem shumë i madhe për banorët e kësaj lagjeje dhe që i shërbejnë dhe banoreve të rinj që do sistemohen në keto pallate. Gjithashtu në kuadrin e përmirësimit të kushteve të jetesës së banorëve të kësaj zone u krye dhe sistemimi i territorit pranë këtyre pallateve me qëllim krijimin e një ambjenti shlodhës dhe argëtues për femijët.

Përzgjedhja paraprake e familjeve të pastreha që perfituan këto banesa është bërë në bazë të Ligjit nr.9232, dt.13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit të qytetareve në zonat urbane” dhe kriterëve të vendosura nga Këshilli Bashkiak. Në këtë përzgjedhje prioritet patën familjet që kanë në përbërjen e tyre persona paraplegjike e tetraplegjike, invalide pune (6 familje); të verbërit e grupit të parë (1 familje), jetimë deri në 30 vjeç si dhe familjet ku kryefamiljari është grua (17 familje); pensionist (3 familje), çiftet e reja (2 familje) dhe familje të pastreha që nuk kanë perfituar nga ligji nr.7652 dt 31.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” (14 familje).

Përveç programit të trajtimit të banesave sociale me qera Bashkia Berat ka aplikuar dhe projektin për trajtimin e familjeve të pastreha me kredi të zbutur. Nga ky projekt kanë perfituar 97 familje nga të cilat: Invalid pune, para-tetraplegjik 16 familje.

Gjithashtu në vitin 2015, Enti Kombëtar Banësive ka ndërmarre ndërtimin e 35 apartamenteve me kosto të ulët dhe një kat njësi shërbimi në objektin e banimit në lagjen “Çlirimi” Berat.

Drejtorja e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë së Beratit raporton se megjithëse problemii strehimit të familjeve rome dhe egjiptiane është mjaft i mprehtë, numri i familjeve rome dhe egjiptiane përfituese nga programet e strehimit ka qenë pak konsiderueshëm krahasuar me nevojat e këtyre familjeve. Megjithatë edhe ato familje që kanë perfituar, janë detyruar të largohen nga skema, për shkak të të ardhurave shumë të ulta, të cilat nuk kanë lejuar përbalimin e qerasë.

**Tabela 3: Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që janë klasifikuar për të qenë përfituese të programeve të strehimit**

| Programi  | Përshkrimi  | Numri i familjeve përfituese | Nga keto Rom/Egjiptian | Zona           |
|---|---|------------------------------|------------------------|----------------|
| Banesat me kosto të ulët  | Ndërtim i ri  | 24                           | 2                      | Murat Celebiu  |
| Banesat me kosto të ulët  | Ndërtim i ri  | 35                           | 3                      | Lagja Çlirim   |
| Subveçionimi i interesit të kredisë së lehtësuar                      | Kredia është dhënë nga banka private për blerjen e shtëpive në treg; interesi subveçionohet pjesërisht nga buxheti i shtetit          | 97                           | 1                      | Qyteti Beratit |
| Strehimi social   | Ndërtim i ri  |                              |                        |                |
| Bonusi i strehimit (vlëra)  | Grant nga qeveria lokale për pagesën e qirasë së tregut. Grande nga qeveria qendrore për disa kategori të përcaktuara në ligjin 9232. | 63                           | 2                      | Qyteti Beratit |
| Subveçion i qirasë për banesat sociale me qira në pronësi të bashkive | Grant nga qeveria qendrore për pagesën e qirasë për personat me të ardhura të ulëta   | 0                            | 0                      |                |
| Zhvillimi i tokës për qëllime strehimi <sup>1</sup>                   | Zona e ndërtimit dhe shërbimet  | 0                            | 0                      |                |
| Grante të vogla   | Përmirësimi i kushteve të banimit   | 0                            | 0                      |                |

Siç vihet re edhe nga tabela 5.3 numri i familjeve rome dhe egjiptiane, përfituese nga skemat e miësipërme është shumë i ulët krahasuar me kategoritë e tjera të familjeve. Një nga arsytet që familjet rome dhe egjiptiane nuk perfitojnë nga këto programe është edhe fakti që romët dhe egjiptianët janë shumë pak të informuar rreth programeve të strehimit dhe kushteve që duhet të plotësojnë për të perfituar strehim<sup>6</sup>. Kështu të pyetur se sa këto familje kanë perfituar dhe sa ato i njohin skemat e mbështetjes së strehimit, vetëm 7% e të pyeturve deklarojnë se kanë perfituar nga kjo skemë, ndërkohë që 47% deklarojnë se nuk kanë perfituar dhe 46% nuk e njohin këtë skemë.

Një problem tjetër që hasin romët dhe egjiptianët në bashkinë e Beratit është legalizimi i shtëpive ndërtuar pa leje. Kështu, disa prej familjeve rome që kanë ndërtuar pa leje në zonën historike të qytetit nuk plotësojnë dot dokumentacionin e nevojshëm për legalizim. Po kështu disa familje të tjera për shkak të të ardhurave të ulëta, nuk mund të sigurojnë dot çertifikatat e pronësisë dhe dokumenta të tjera të domosdoshme për legalizim, të cilat kushtojnë përtej mundësive ekonomike të këtyre familjeve.

<sup>5</sup> Të dhëna administrative Bashkia Berat 2017

<sup>6</sup> I njëjti studim i bere ne kuadrin e hartimit te Plan Ndër-Vendor i Zhvillimit të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane nga Bashkia e Beratit 2014

## 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT

Eshtë e gjetur nga shumë studime dhe vlerësime që familjet rome dhe egjiptiane shpesh banojnë në banesa nën standard dhe vuajnë pasigurinë e qiramarrjes. Sipas studimit të OSFA-së, Censusi 2014, tregon se në bashkinë e Beratit rreth 16% e banesave të romëve dhe egjiptianeve klasifikohen si "kasolle e rrethuar me dërrasa dhe llamarinë", 68% e familjeve rome dhe egjiptiane jetojnë në shtëpi private përdhese, 3% në banesa të përshtatura si ish-magazina, kabanone etj, dhe vetëm 13% në blloqe apartamentesh.

Kushtet e jetesës dhe të strehimit të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë e Beratit ndikohen nga mungesa e burimeve financiare, si dhe aksesit të kufizuar të tyre në punësim dhe sidomos në punësimin me pagesë. Për shkak të përjashtimit nga tregu formal i punës, ata janë futur në një rreth varfërie dhe përjashtimi social që i privon nga të gjitha mundësitë që do të kishin normalisht dhe i vështirëson kushtet e jetesës.

Ky studim i kushteve të banimit të romeve dhe egjiptianeve në bashkinë e Beratit gjeti se 35 familje kanë shtëpi të papërshtatshme sipas një standardi minimal dhe 15 familje jetojnë në tenda në kushte të varfërisë ekstreme. Rreth 20 familje të pozicionuar me banesat e tyre pranë lumit Osum, janë të rrezikuar çdo vit nga përmbytjet.

Në lidhje me zotërimin e një shtëpie apo jo, 69% e të intervistuarve rom dhe egjiptianë pranojnë se kanë një shtëpi, ndërkohë që 31% e të pyeturve deklarojnë se nuk kanë një shtëpi. Në lidhje me numrin mesatar të anëtarëve të një familjeje ilustruar sipas grafikut të mëposhtëm, vihet re një prani e familjeve të zgjeruara. 23% e të intervistuarve deklarojnë se jetojnë në familje të përbëra me 5 anëtarë, 17% jetojnë në familje me 6 anëtarë, 6% në familje me 7 anëtarë dhe 18% jetojnë në familje me mbi 8 anëtarë. Vetëm 36% e të intervistuarve pranojnë se jetojnë në familje me 4 dhe më pak anëtarë përbërës.

Të intervistuarit janë pyetur edhe në lidhje me kushtet higjieno-sanitare në banesat e tyre. Nga përgjigjet e dhëna vihet re mungesa e kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare duke qenë se 47% e të anketuarve i vlerësojnë keq, 39% mesatarisht dhe vetëm 4% i vlerësojnë shumë keq. Vetëm 10% e të pyeturve i vlerësojnë kushtet higjieno-sanitare në banesat e tyre si të mira.

**Tabela 4: Të dhëna të censurit për cilësinë e banesave të komunitetit rom në Berat**


| Bashkia      | Shtëpi private (me tulla, blloqe apo beton) | Apartament në pallat | Kasolle e rrethuar me dërrasa llamarinë apo plasmas | Banese e përshtatur në një objekt të përshatur | E shembur |
|--------------|---|----------------------|---|--|-----------|
| Berat Qytet  | 72  | 1                    | 1   | 8  | 0         |
| Otlak        | 133   | 0                    | 0   | 5  | 0         |
| <b>Total</b> | <b>205</b>                                  | <b>1</b>             | <b>1</b>  | <b>13</b>                                      | <b>0</b>  |

## 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN


**Tabela 5: Situata e familjeve te pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkine Berat**

| Emërtimi zonës   | Total | Rome | %   | Egjiptiane | %   |
|--|-------|------|-----|------------|-----|
| Familje gjithsej   | 178   | 58   | 33% | 120        | 67% |
| Familje në nevojë për strehim:                           | 134   | 44   | 33% | 90         | 67% |
| Nuk zotërojnë një hapësirë për të jetuar                 | 84    | 29   | 35% | 55         | 65% |
| Zoterojnë një hapësirë jetese nën standartet e strehimit | 50    | 15   | 30% | 35         | 70% |

**Figura 1: Familje në nevojë për akomodim në Bashkinë Berat**




**Figura 2: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkine Berat**



**Tabela 6: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E**

| Lloji i kushteve te strehimit          | Numri      |
|--|------------|
| Jetojne ne tenda, baraka, depo         | 84         |
| Jetojne ne garsionere                  | 18         |
| Jetojne ne apartmente 1+1              | 27         |
| Jetojne ne apartmente 2+1              | 5          |
| Jetojne ne apartmente 3+1 ose me shume | 0          |
| <b>Total</b>                           | <b>134</b> |

**Figura 3: Situata aktuale e akomodimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Berat**



Për të përmiresuar kushtet e banesave të komuniteteve rome dhe egjiptiane është analizuar kosto për riparim e banesave ekzistuese, e shtesave të nevojshme të këtyre banesave. Në shumicën e rasteve banesat kanë nevojë për të dyja këto ndërhyrje. Për të përcaktuar çmimin e riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë në konsideratë lloji i ndërtimeve të gjendja ekzistuese. Nderhyrja do të konsistojë në riparimin e muratave, sivatimeve, dyshemeve, terraces ose çatisë, tavanit, ndërhyrje në dyert dhe dritaret, riparim dhe zëvendësim i tyre, riparimi i nyjeve hidrosanitare. Nga përlllogaritja, çmimi i riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi ka rezultuar nga 7000-11000 lekë/m<sup>2</sup> (mesatarisht 9000 lekë/m<sup>2</sup>). Llogaritjet tregojnë se duhen 300.000 lekë/familje riparime për garsonieret, 500.000 lekë/familje për apartamentet 1+1, 600.000 lekë/familje riparime për apartamentet 2+1 dhe 800.000 lekë/familje riparime për apartamentet 3+1. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përlllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht: garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kjo analizë ka konkluduar me koston 1.200.000 lekë/familje për sipërfaqen shtesë për apartamentet 1+1, 2+1, dhe 3+1 llogaritur si prodhim i sipërfaqes të shtesës në m<sup>2</sup> me çmimin e ndërtimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, duke konsideruar sipërfaqen e nevojshme për shtesë 30-40 m<sup>2</sup>, (sipërfaqe që do të përfshijë një ambient dite dhe një ambient ndihmes/ një ambient gjumi dhe dy ambiente ndihmese ose dy ambiente gjumi sipas secilit rast). Për garsonieret është menduar të bëhet rikonstruksioni i tyre për të zgjidhur problemet e fëmijëve të familjeve dhe jo shtesë, pasi shtesa në to nuk justifikon koston e lartë të ndërtimit si për nga sipërfaqja e madhe, ashtu edhe për gjendjen e amortizuar të garsonierëve.

Banesat 3+1 kanë sipërfaqe të mjaftueshme banimi ndaj nuk është e nevojshme të ndërtohet shtesë. Më poshtë jepet tabela me llogaritjen e koston të riparimeve dhe shtesave të banesave.

### Analiza e Kostove per Rikonstruksionin

Struktura e mëposhtme është një zberthim i mënyrës së shpërndarjes së vlerës në mënyrë të shumtën e rasteve, por kjo mënyrë është variabël sipas situatës që paraqitet.

#### • Ndërtim Garsoniere

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 120,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 70,000          |
| 3            | Rikonstruksion Dysheme dhe Cati                                   | 50,000          |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 30,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 30,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>300,000</b>  |

#### • Ndërtim 1+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 150,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 120,000         |
| 3            | Rikonstruksion Dysheme dhe Cati                                   | 110,000         |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 60,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 60,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>500,000</b>  |

#### • Ndërtim 2+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 160,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 140,000         |
| 3            | Rikonstruksion Dysheme dhe Cati                                   | 130,000         |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 90,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 80,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>600,000</b>  |

#### • Ndërtim 3+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 170,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 200,000         |
| 3            | Rikonstruksion Dysheme dhe Cati                                   | 200,000         |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 120,000         |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 110,000         |
| <b>Total</b> |   | <b>800,000</b>  |



Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstrukcion dhe shtesa eshte si me poshte:

Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstrukcion dhe shtesa eshte si me poshte:

- Kosto e rikonstrukcionit per garsoniere = numri familjeve \* 300.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 1+1 = numri familjeve \* 1.700.000 lekë/familje (500.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 2+1 = numri familjeve \* 1.800.000 lekë/familje (600.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit per apartamente 3+1 = numri familjeve \* 800.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- **Kosto totale per rikonstrukcion + shtesë** = Kosto e rikonstrukcionit per garsoniere + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (1+1) + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (2+1) + Kosto e rikonstrukcionit per apartamente (3+1)

**Tabela 7: Vlerësimi i koston per rikonstrukcion + shtesa në Bashkinë Lushnje**

| Tipi         | Kosto per rikonstrukcion lekë | Kosto per Shtesa lekë | Nr familjeve | Kosto lekë        |
|--------------|-------------------------------|-----------------------|--------------|-------------------|
| garsoniere   | 300,000                       | -                     | 18           | 5,400,000         |
| ap 1+1       | 500,000                       | 1,200,000             | 27           | 45,900,000        |
| ap 2+1       | 600,000                       | 1,200,000             | 5            | 9,000,000         |
| ap 3+1       | 800,000                       | -                     | 0            | -                 |
| <b>Total</b> |                               |                       | <b>50</b>    | <b>60,300,000</b> |

**Tabela 8: Aksesi per uje, kanalizime dhe furnizim me energji elektrike I komunitetit R/E ne Bashkine Berat**

| Punë ne infrastrukturën inxhinierike (Për secilën zonë) | Gjatesia në metra |
|---|-------------------|
| Rrjeti i furnizimit me ujë                              | 650               |
| Rrjeti i kanalizimeve                                   | 900               |
| Rrjeti i furnizimit me energji elektrike                | 480               |
| Rruge   | 2076              |

Ne estimimin qe eshte bere per infrastrukturën ne keto zona eshte parashikuar permiresimi i rrjetit infrastrukturor per te gjithë komunitetin (zonen), pra ky rrjet do ti sherbeje dhe atyre familjeve qe nuk kane nevojë per permiresim te kushteve. Vlerësimi i koston për investimin në infrastrukturë është llogaritur si prodhim i gjatësisë në metra te infrastukturës primare të nevojitur, me çmimin për metër linear për secilin zë. Çmimi eshte percaktuar si mesatare e të njejtit zë në projekte të mëparshme. Zërat e përfshirë në infrastrukturën primare, për te cilët janë marrë të dhëna nga bashkitë përkatëse janë : gjatësia e rrugëve, çmimi për metër linear i llogaritur përafërsisht 30000 lekë/ml (gjerësia e rruges merret 5m si rrjedhoje 1 meter linear gjatesi=5 m<sup>2</sup> siperfaqe), gjatësia e rrjetit të furnizimit me ujë çmimi 6000 lekë/ml, gjatësia e rrjetit të kanalizimeve, çmimi 8000 lekë/ml dhe gjatësia e rrjetit të furnizimit me energji elektrike, çmimi 4000 lekë/ml. Në rastet kur vlera e zërave te infrastrukturës është 0, si rrjedhojë dhe kosto përkatëse është 0 lekë, tregon se për zërin në fjalë nuk ka nevojë për investim.

Formula e perdorur per vleresimin e koston per infrastrukturën eshte si me poshte:

- Kosto per rrjetin e furnizimit me uje = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per rrjetin e kanalizimeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per furnizimin me energji elektrike = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per ndertimin e rrugeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- **Kosto per infrastrukturën** = Kosto per rrjetin e furnizimit me uje + Kosto per rrjetin e kanalizimeve + Kosto per furnizimin me energji elektrike + Kosto per ndertimin e rrugeve



**Foto nga vendbanimet R/E**

**Tabela 9: Vlerësimi i koston per infrastrukturën në Bashkinë Berat**

| Tipi         | lekë/ ml | Gjatesia në metra | Kosto lekë        |
|--------------|----------|-------------------|-------------------|
| Rrugë        | 30,000   | 2,076             | 62,280,000        |
| Ujë          | 6,000    | 650               | 3,900,000         |
| Elektrike    | 4,000    | 480               | 1,920,000         |
| Kanalizime   | 8,000    | 900               | 7,200,000         |
| <b>Total</b> |          |                   | <b>75,300,000</b> |

Nevojat për ndërtim të reja perfshin ata që banojnë në kasolle si edhe në banesa që nuk kanë siguri për jetën si: tenda, baraka, depo. Sipas kriterëve dhe normativave të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr 824 datë 3.12.2004 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" eshte berë dhe vlerësimi i koston për keto ndërtim. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, eshte përlllogaritur sipërfaqja

minimale që u takon, përkatësisht : garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kosto e ndërtimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë për çdo qytet nga manuali i qeverisë në qershor 2015: "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive për vitin 2015". Më poshtë jepen formulat e llogaritjes të koston të ndërtimeve të reja dhe tabela përkatëse me rezultatet.

**Tabela 10: Kërkesa e komunitetit R/E per strehim, ne Bashkine Berat**

| Lloji i Strehimit  | Nevoja per studim komuniteti Rom | Nevoja per studim komuniteti Egjiptian |
|--|----------------------------------|--|
| Numri i familjeve qe u nevojiten garsoniere                                      | 0                                | 0                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 1+1                                 | 5                                | 10                                     |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 2+1                                 | 9                                | 32                                     |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 deri ne 75,5 m <sup>2</sup>     | 15                               | 13                                     |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 me shume se 75,5 m <sup>2</sup> | -                                | -                                      |
| <b>Numri total i familjeve</b>   | <b>29</b>                        | <b>55</b>                              |

Formulat e perdorura per vleresimin e koston per ndertime te reja jane si me poshte:

- Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per garsoniere e caktuar 35 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 1+1 = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 1+1 e caktuar 55 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 2+1 = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 2+1 e caktuar 67 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 3+1 = numri familjeve \* sipërfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 3+1 e caktuar 75.5 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- **Kosto totale per ndërtime te reja** = Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (1+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (2+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (3+1) = Shuma gjithsej

**Tabela 11: Vlerësimi i koston per ndertime të reja në Bashkinë Berat**

| Tipi         | lekë/ m <sup>2</sup> | Siperfaqe m <sup>2</sup> | Nr familjeve | Kosto lekë         |
|--------------|----------------------|--------------------------|--------------|--------------------|
| garsoniere   | 32,317               | 35                       | 0            | -                  |
| ap 1+1       | 32,317               | 55                       | 15           | 26,661,525         |
| ap 2+1       | 32,317               | 67                       | 41           | 88,774,799         |
| ap 3+1       | 32,317               | 75.5                     | 28           | 68,318,138         |
| <b>Total</b> |                      |                          | <b>84</b>    | <b>183,754,462</b> |

**Kosto Total në Bashkinë Berat - 319,354,462**

Duke u nisur nga situata konkrete dhe nga informacioni qe morem nga Bashkia, menyra qe i pershtatet me shume realitetit, sipas analizes tone, eshte ndertimi i banesave me kosto te ulet,

kjo e kombinuar dhe me rikonstrukcionin dhe me ndertimin e shtesave per banesat ekzistuese. Ndertimi i banesave me kosto te ulet, parashikohet te behet ne hapesirat e lira te zonave ne te cilat keto komunitete jetojne aktualisht. Per shkak te mungeses te informacionit ne lidhje me komunitetin Egjiptian per kerkesa per banesa sociale, eshte menduar qe ne qofte se nga bashkita do te investohet ne kete drejtim, fondi qe do parashikohet per ata familje qe do perfitojne nga banesat sociale, do te zbritet nga fondi qe eshte parashikuar ne kete studim.

Kjo analizë konkludon disa skenarë të rradhitur më poshtë:

► **Skenari 1**

**Rikonstrukcioni dhe shtesa për banesat ekzistuese.**

Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk i plotësojnë kushtet e jetesës. Ato mund të kenë nevojë për:

- Rikonstrukcion të banesave ekzistuese
- Rikonstrukcion + Shtesa në ndërtesat ekzistuese

Familjet që bëjnë pjesë në këtë grup, kanë nevojë për shtesë ambjentesh.

► **Skenari 2**

**Ndërtime të reja.**

Eshte menduar qe permiresimi i kushteve te ketyre familjeve, nisur nga menyra e jeteses qe ato kane, te behet ne hapesirat e zonave ku ata jetojne aktualisht. Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk plotësojnë kushtet minimale të jetesës. Në këtë rast propozohet të bëhen ndërtime të reja për të cilat janë evidentuar sipërfaqet përkatëse për secilin tip apartamenti (garsoniere, apartamente 1+1, 2+1 ose 3+1).

**Punime plotësuese me investime në infrastrukturën primare.**

Përveç punimeve në banesat vetjake të secilës familje është parashikuar nevojja edhe për punime në infrastrukturën primare në ndihmë të familjeve Rome apo Egjiptiane.

Këto punime konsistojnë në katër grupe të mëdha:

1. Punime mirëmbajtjeje dhe ndertimit të rrugëve
2. Ndërtim kanalizimesh për ujërat e zeza dhe përmirësimi i pusetave ekzistuese,
3. Ndërtim si dhe riparim i degëzimeve të ujësjellësit. Për të gjitha këto punime janë parashikuar koston më lart.
4. Shtim i gjatësisë të rrjetit elektrik.




## 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE


Në pamje të parë situata e kushteve të banimit të romëve dhe egjiptianëve në bashkinë e Beratit duket e lidhur drejtpërdrejt me varfërinë, por në fakt është më komplekse se kaq. Megjithatë qeveria shqiptare ofron një numër të konsiderueshëm programesh strehimi ato mbeten mjaft të vështira për t'u aksesuar nga romët dhe egjiptianët. Ndër arsyt kryesore janë mungesa (e verifikueshme) e të ardhurave që do t'i mundësonte atyre pjesëmarrjen në disa programe, varfëria e cila i pengon njerëzit të paguajnë tarifat e legalizimit, diskriminimi dhe mungesa e dokumentacionit dhe njohurive rreth kësaj fushe me karakter mjaft teknik.

- ▶ Së pari, ashtu si edhe në bashkitë e tjera të vendit, problemi më i madhe me romët dhe egjiptianët qëndron tek identifikimi i numrit të familjeve, vendbanimit dhe i kushteve të tyre social ekonomike. Megjithatë janë realizuar një sërë studimesh për identifikimin e situatës social ekonomike të familjeve romë, do të duhej ndërmarë një Census i plotë, vetëm për këtë komunitet, ku identifikimi i numrit të banoreve dhe vendodhja e banesave të shoqërohet edhe me identifikimin e kushteve social ekonomike të tyre. Në kushtet e njësive të reja administrative, si dhe të një legjislacioni të përshtatshëm për mbështetjen e këtyre familjeve me strehim, kjo gjë bëhet imediate. Do të ishte i parakohshëm dhe jo shterues një planifikim i nevojave për shërbime publike në përgjithësi, dhe shërbime të strehimit në veçanti, në kushtet kur nuk kemi të sigurtë për numrin e tyre dhe vendbanimet e sakta. Ky mund të ishte një rekomandim që duhet të mbetet në vëmendjen e MZHU si përgjegjëse për hartimin e politikave të strehimit dhe INSTAT si përgjegjëse për realizimin e regjistrimit të ardhshëm të popullsisë dhe banesave në vitin 2021.
- ▶ Në planin vendor të bashkisë së Beratit janë parashikuar zonat urbane për ndertimin e banesave sociale me mbështetjen e Entit Kombëtar të banesave.
- ▶ Në buxhetin vjetor të bashkisë së Beratit nuk ka fonde të parashikuara për strehim, si një zë i veçantë.
- ▶ Nuk ka studime (qoftë edhe pjesore) mbi infrastrukturen e vendbanimeve romë dhe egjiptiane
- ▶ Në data bazën e krijuar për familjet aplikuese për statusin e të pastrehit, nuk ka informacion dhe analiza të thelluara për situatën e strehimit të familjeve romë dhe egjiptiane.
- ▶ Në kushtet kur, një pjesë e mirë e familjeve romë dhe egjiptiane nuk kanë njohuri mbi të drejtat e tyre për strehim dhe informacionin e nevojshëm për menyrën e aplikimit për strehim social, mbetet detyrë e bashkisë të informojë këtë komunitet mbi skemat sociale të strehimit.
- ▶ Të jetuarit në familje të mëdha, përkeqeson statusin e strehimit të këtyre familjeve.
- ▶ Informacioni i pamjaftueshëm për shkak të përjashtimit social të këtij grupi të popullatës.
- ▶ Informaliteti i këtij grupi, në aspekte të ndryshme siç janë regjistrimi në zyrat e gjendjes civile, zyrat e punës, vërtetimi për të ardhurat etj.
- ▶ Levizshmëria e komunitetit rom.

## ANEKSI

### Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Berat





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË KUÇOVË**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Mars 2017



*Missioners of Social Rights*



BASHKIA KUÇOVË

## Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Kuçovë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Klodioda Sh.p.k. dhe Organizata “Misionarët për të Drejtat Sociale” në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Mars 2017



## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME  | 4  |
| 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian           |    |
| 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI   | 5  |
| 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit                              |    |
| 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË KUÇOVË              | 6  |
| 3.1 Arsimimi   |    |
| 3.2 Punësimi dhe të ardhurat   |    |
| 3.3 Formimi profesional  |    |
| 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM  | 8  |
| 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT | 9  |
| 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN              | 10 |
| 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE  | 18 |
| ANEKSI   | 20 |
| Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Kuçovë                           |    |

# 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Bashkia Kuçovë është pjesë e qarkut të Beratit, dhe shtrihet në pjesën lindore të Ultësirës Perëndimore, e kufizuar në veri dhe veriperëndim nga zona e Sulovës dhe lumi Devoll, e në jug e jugperëndim nga rrjedha e poshtme e lumit Osum. Me një sipërfaqe prej 160.22 km<sup>2</sup>.

Bashkia Kuçovë, me ndarjen e re administrative, përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Kuçovës, dhe 3 komunat Kozare, Lumas dhe Përondi. Nga pikëpamja administrative, Kuçova kufizohet me bashkitë Lushnje, Belsh, Cërrik, Gramsh, Berat dhe Ura Vajgurore.



## 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian

Bashkia e Kuçovës, për t'iu përgjigjur detyrimeve ligjore si edhe sfidave reale të zhvillimit urban, ka përgatitur dhe miratuar në këshillin Bashkiak, Strategjinë e Zhvillimit të Bashkisë. Duke patur parasysh që planifikimi i territorit përmban dimensionin strategjik dhe atë rregullator, kjo strategji përbën hapin e parë të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit të bashkisë Kuçovë. Ky plan është hartuar nga Bashkia Kuçovë, për të evidentuar synimet dhe pritshmëritë afatmesme në lidhje me zhvillimin ekonomik.

Strategjia e Zhvillimit të bashkisë përmban kapitullin e analizave, duke veçuar këtu analizën territoriale dhe social-ekonomike, që hapin shtegun për analizat e thelluara në vijim të hartimit të këtij dokumenti i cili adreson vlerësimin e nevojave të romëve dhe egjiptianëve për kushte më të mira banimi. Në këtë kuadër ky vlerësim, i cili adreson vetëm një prej grupeve demografike të popullsisë që jeton në territorin e bashkisë Kuçovë nga njëra anë do të jetë pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë dhe nga ana tjetër do të shërbejë për të jetësuar politikat vendore të strehimit social të bashkisë.

# 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI

## 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit

Bashkia Kuçovë, është një nga qendrat e rëndësishme demografike dhe ekonomike të qarkut të Beratit. Sipas INSTAT, Bashkia e Kuçovës ka një popullsi prej 31,424 banorësh. Kuçova ka një ndër dendësitë më të larta në rajonin e Shqipërisë Qëndrore, me 196 banorë/km<sup>2</sup>. Rreth 80% e kësaj popullsie është vendosur në qytetin e Kuçovës, dhe në njësinë administrative Perondi. Bashkia ka nën administrimin e saj 31 fshatra, dhe një qytet.

Kuçova është ndërtuar si një qytet industrial dhe zhvillimet më të mëdha i ka patur pas viteve 70-të, kur në qytet u ngritën një sërë veprash industriale kryesisht bazuar në industrinë e naftës. Aktualisht bashkia ka kaluar nga një territor vetëm urban në një territor më kompleks urbanor-rural.

Gjatë periudhës së zhvillimit të saj si qytet popullsia ka pësuar rritje të jashtëzakonshme, nga 300 banorë në 1923, në 15 000 në 1979 e 30 000 në 1998. Vetëm vitet e fundit, me kolapsin e industrisë përpunuese dhe mekanike, popullsia ka pësuar ritme të vogla uljeje, që priten të ndodhin në gjithë bashkinë për 10 vitet e ardhshme.

Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqëndruar kryesisht në qytetin e Kuçovës me rreth 40% të saj ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë së bashkisë, është e shpërndarë në komunat Kozare, Lumas dhe Perondi, respektivisht me 18%, 13%, dhe 29%. Përsa i përket familjeve romë dhe egjiptiane, nuk ka të dhëna të sakta, për këtë arsye grupi i ekspertëve ka bërë vlerësime nisur nga disa burime informacioni. Të dhënat administrative të bashkisë janë të dhënat bazë, por edhe keto të dhëna nuk janë produkt i zyrës së gjendjes civile të bashkisë, por i vlerësimeve të bëra bazuar në kërkesat për strehim të këtij grupi familjesh. Një nga vecoritë demografike të komunitetit rom dhe egjiptian në Kuçovë është se ato nuk karakterizohen nga migrimi dhe lëvizja. Në total numri i familjeve romë dhe egjiptiane mendohet të jetë rreth 214 familje.

**Tabela 1: Numri i familjeve romë dhe egjiptiane sipas vendbanimeve**

| Nr. | Bashkia (Ish komuna) | Popullsia     | Popullsia Rome dhe Egjiptiane | Nr i familjeve romë dhe egjiptiane |
|-----|----------------------|---------------|-------------------------------|------------------------------------|
| 1.  | Kuçovë /Qytet        | 12,720        | 804                           | 211                                |
| 2.  | Kozare               | 5,651         | 162                           | 45                                 |
| 3.  | Lumas                | 4,002         | 84                            | 23                                 |
| 4.  | Perondi              | 9,052         | 191                           | 59                                 |
|     | <b>Total</b>         | <b>31,424</b> | <b>1241</b>                   | <b>338</b>                         |

**Burimi i të dhënave:** Census 2014 "Banesat dhe popullata romë në Shqipëri" Bashkia e Kuçovës (2015)

Popullsia e kësaj zone, krahasuar me regjistrimin e fundit të popullsisë, vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 1500 banorë, osë me 5% më pak. Shkaqet e rënies së popullsisë në bashkinë Kuçovë, lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brëndshëm, (nga zonat rurale drejt atyre urbane dhe bregdetare) duke ndjekur të njëjtin model –profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit.

## 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË KUÇOVË

### 3.1 Arsimimi

Niveli arsimor i komunitetit rom dhe egjiptian në bashkinë e Kuçovës, nuk ka specifika të vecanta, nëse do ti referohemi tregueseve arsimor të këtij grupi të popullsisë. Niveli arsimor i fëmijëve rom dhe egjiptian është përkeqësuar gjatë tranzicionit dhe është rritur hendeku krahasuar me popullsinë e pjesës tjetër të popullsisë. Në shumicën e rasteve niveli i ulët arsimor, përbën një nga shkaqet kryesore të papunësisë dhe varfërisë së familjeve rome dhe egjiptiane. Shumica e anëtarëve të komunitetit rom nuk kanë ndjekur arsimin bazë 9-vjeçar. Sipas të dhënave nga zyra arsimore në Kuçovë, ka rreth 50 fëmijë rom të moshës 0-14 vjeç që nuk arrijnë të përfundojnë arsimin 9-vjeçar pjesërisht sepse familjet e tyre jetojnë në varfëri të theksuar dhe angazhimit të fëmijëve në punë<sup>1</sup>.

### 3.2 Punësimi dhe të ardhurat

Shkalla e papunësisë për bashkinë është relativisht e ulët, në raport me rajonin: Kuçova ka një normë 20.5% të papunësisë, përkundrajt normës mesatare kombëtare 29.3, normës në nivel qarku (20.3%) dhe normave të papunësisë së bashkive të të njëjtit karakter. Por edhe në këtë tregues, gjejmë pabarazi, përse i përket komunitetit rom dhe egjiptian.

Si pasojë e nivelit të ulët arsimor, mungesës së një profesioni dhe përjashtimit social, shumica e romëve dhe egjiptianëve në Kuçovë bëjnë punë të pakualifikuara në sektorin informal, shitblerje rroba te përdorura, grumbullimin e hekurishteve dhe kanaçeve, dhe shumë pak prej tyre deklarojnë se punojnë në sektorin e naftës. Megjithatë, ata deklarojnë se punësimi nuk i siguron të ardhura të mjaftueshme për familjet e tyre. Të dhënat demografike tregojnë se 40% e romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë e Kuçovës, jetojnë në periferi të qytetit ose në zonat rurale, për këtë arsye një pjesë e mirë e tyre janë të punësuar në sektorin bujqësor. Por edhe në këtë sektor, mardhëniet e tyre të punës nuk janë të formalizuara përmes një kontrate pune.

Romët dhe egjiptianët karakterizohen nga një nivel i lartë inaktiviteti, këtë gjë e vërteton edhe numri shumë i regjistruar në zyrat e punës si punëkërkues të papunë. Ndërkaq, përqindja e të papunëve pikërisht për shkak të informalitetit është shumë e ulët, krahasuar me të papunët e tjerë të regjistruar në zyrat e punës. Ky është një problem i dyfishtë, nga njëra anë kryefamiljarët nuk sigurojnë të ardhura për familjet e tyre, nga ana tjetër familjet nuk mund të kualifikohen për të përfituar ndihmë ekonomike, përderisa nuk janë të regjistruar si punëkërkues të papunë.

Në bazë të të dhënave të Drejtorisë së Shërbimit Social, 94 familje trajtohen me ndihmë ekonomike ose rreth 28% e totalit të familjeve rome dhe egjiptiane. Niveli relativisht ulët i numrit të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike shpejgohet me faktin se një pjesë e mirë e familjeve që jetojnë në zonën rurale kanë tokën pronësi. Po kështu informaliteti i penalizon ata për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike.

Tabela 2: Familjet rome dhe egjiptiane përfituese të ndihmës ekonomike në Kuçovë

| Nr. | Bashkia (Ish komuna) | Familje    | Familje në NE   | PAK       |
|-----|----------------------|------------|-----------------|-----------|
| 1.  | Kuçovë /Qytet        | 211        | 61 (28.9%)      | 21        |
| 2.  | Kozare               | 45         | 13 (28%)        | 8         |
| 3.  | Lumas                | 23         | 8 (34%)         | 2         |
| 4.  | Perondi              | 59         | 20 (13%)        | 16        |
|     | <b>Total</b>         | <b>338</b> | <b>94 (28%)</b> | <b>47</b> |

Burimi: Të dhëna administrative Bashkia Kuçovë-2016

Krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë, niveli i varfërisë i familjeve rome dhe egjiptiane është shumë i lartë, më shumë se nga statistikat ky është një konkluzion i nxjerrë nga DGF. Familjet e varfra dhe shumë të varfëra rome dhe egjiptiane përballen me nivele të larta të përjashtimit social, sepse ato janë më pak të afta të përballojnë nevojat e jetës së përditshme dhe kanë më pak mundësi të marrin pjesë në proceset që ndikojnë në përmirësimin e jetesës së tyre, të tilla si punësimi dhe arsimimi.

Familje rome dhe egjiptiane përballen edhe me ngushtimin e aksesit tek shërbimet publike dhe transfertat për shkak të informalitetit të tyre dhe mungesës së informacionit. Burimi i të ardhurave të familjeve rome dhe egjiptiane përbëhet kryesisht nga pensionet e pleqërisë, pagesa për aftësinë e kufizuar dhe pensionet për jetimët. Bazuar në të dhënat e Censurit 2014<sup>2</sup>, 80% e familjeve rome dhe egjiptiane në Kuçovë janë me të ardhura nën 5,000 lekë në muaj, 20% e familjeve kanë të ardhura 5,001-10,000 lekë në muaj.

Megjithëse në Bashkinë Kuçovë ka një numër relativisht të vogël të njësive ekonomike aktive, vetëm 3 prej tyre janë të administruara nga romët dhe egjiptianët, përkatësisht 1 dhe 2 biznese<sup>3</sup>. Përse i përket sektorit ku këto njësi ekonomike operojnë, ai është tregtia (shitblerja e rrobave te përdorura).

### 3.3 Formimi profesional

Pavarësisht nga nivelet e ulëta të punësimit dhe nivelit të përgjithshëm të ulët të arsimit bazë, pjesëtarët e komunitetit rom që janë të regjistruar në zyrat e punës thonë se nuk kanë përfituar nga trajnimet profesionale të ofruara nga qendrat e formimit profesional.

Interpretimi ekonomik i këtyre tregueseve është i vlefshëm për të vlerësuar nevojat e këtij komuniteti për mbështetje nga skemat sociale, si ato të ndihmës ekonomike ashtu edhe nga ato të strehimit apo transfertat të tjera të mirëqenies. Nga ana tjetër analiza demografike, ku struktura moshore e këtij komuniteti rezulton shumë favorizuese dhe me vlerë në drejtim të rritjes në të ardhmen afatmesme të nivelit ekonomik të këtyre familjeve, na tregojnë se kundrejt kësaj fashe të popullsisë duhet treguar kujdes sidomos në drejtim të formimit profesional dhe integritimit në tregun e punës. Ky gjithashtu është "sinjal" për rritje shpenzimesh, alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqenien e kësaj kategorie të popullsisë.

<sup>2</sup> OSFA

<sup>3</sup> Zyra lokale e regjistrimit të Biznesit, DGF

<sup>1</sup> Të dhëna të Zyrës Arsimore Kuçovë

## 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM

Bashkia e Kuçovës e ka vlerësuar strehimin si një nga prioritetet e politikave të saj sociale. Duhet theksuar se informacioni në bashkinë e Kuçovës mbi numrin e familjeve që janë vlerësuar si përfituese të strehimit social është shumë i detajuar.

Në bashkinë Kuçovë keto vite nuk është zbatuar asnjë program strehimi social, qofshin banesa sociale me qira, banesa me kosto të ulët, apo bonus qiraje. Vetëm në vitin 2016, Bashkia ka planifikuar një fond për strehimin social prej 600 000 lekë, për subvecion qiraje. Megjithë planifikimin, ky fond nuk u disbursua për disa arsye, një nga të cilat ishte dhe refuzimi i fondit duke e konsideruar atë të pamjaftueshëm për të zgjidhur prioritetet e strehimit.

Megjithë vështirësitë, shkaktuar nga mungesa e bashkëpunimit, vecaneërisht e komunitetit egjiptian, bashkia ka bërë një punë të lavdërueshme në krijimin e një baze të dhënash për familjet e pastreha. Bazuar në rregjistrimet e bëra nga bashkia, familjet e klasifikuara si të pastreha, ndahen në: (i) familje që jetojnë në banesa private (3 kategori); (ii) Familje që kanë sipërfaqe të pamjaftueshme; dhe (iii) familje të cilat jetojnë në kushte shumë të këqia të shkaktuara nga infrastruktura e keqe e zonës në të cilën janë vendosur familjet.

Familjet që paraqesin kërkesën e tyre për strehim pranë Bahkisë, janë kryesisht familje që kanë jetuar me të ardhura të ulta, të cilat për shkak të mungesës së burimeve të tyre financiare, kërkojnë mbështetjen e institucioneve vendore për zgjidhjen e problemit të strehimit. Ky numër deri tani ka arritur nërreth 211 familje<sup>4</sup>.

**Tabela 3: Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që janë klasifikuar për të qenë përfituese të programeve të strehimit**

| Programi  | Përshkrimi  | Nr. i familjeve përfituese | Nga keto Rom/Egjiptian | Zona   |
|---|---|----------------------------|------------------------|--------|
| Banesat me kosto të ulët  | Ndërtim i ri  | 0                          | 0                      | na     |
| Subvecionimi i interesit të kredisë së lehtësuar                      | Kredia është dhënë nga banka private për blerjen e shtëpive në treg; interesi subvencionohet pjesërisht nga buxheti i shtetit.        | 0                          | 0                      | na     |
| Strehimi social   | Ndërtim i ri  | 0                          | 0                      | na     |
| Bonusi i strehimit (vlera)  | Grant nga qeveria lokale për pagesën e qirasë së tregut. Grande nga qeveria qendrore për disa kategori të përcaktuara në ligjin 9232. | 17                         | 2                      | Kucove |
| Subvecion i qirasë për banesat sociale me qira në pronësi të bashkive | Grant nga qeveria qendrore për pagesën e qirasë për personat me të ardhura të ulëta.  | 0                          | 0                      | na     |
| Zhvillimi i tokës për qëllime strehimi                                | Zona e ndërtimit dhe shërbimet  | 0                          | 0                      | na     |
| Grante të vogla   | Përmirësimi i kushteve të banimit   | 0                          | 0                      | na     |

4 Të dhëna nga 2017

## 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT

Siç vihet re edhe nga tabela 6.3, skemat e strehimit social, pothuajse nuk kanë funksionuar në bashkinë e Kuçovës. Po kështu numri i familjeve rome dhe egjiptiane, përfituese nga skemat e mësipërme është shumë i ulët krahasuar me kategoritë e tjera të familjeve, vetëm 2 familje nga ky komunitet kanë përfituar bonusin e strehimit. Një nga arsyet që familjet rome dhe egjiptiane nuk përfitojnë nga këto programe është edhe fakti që keto familje sidomos ato egjiptiane nuk janë bashkëpunuese gjatë procesit të verifikimit të situatës së strehimit.

Një problem tjetër që hasin romet dhe egjiptianet në bashkinë e Kuçovës është dhe kushtet e këqia higjieno sanitare të shkaktuara nga mungesa e infrastrukturës. Janë identifikuar nga bashkia e Kuçovës rreth 50 familje që jetojnë në kushte të rënduara dhe kanë nevoja urgjente për ndërhyrje në infrastrukture. Po kështu 3 familje rome dhe egjiptiane (prej 59 familje gjithsej) vazhdojnë të jetojnë në banesa që janë vlerësuar si rrezik shembje janë në kushte e emergjences për ndërhyrje.

**Tabela 4: Të dhëna të censurit për cilesinë e banesave e komunitetit rom në Kuçovë**

| Bashkia      | Shtëpi private (me tulla, blloqe apo beton) | Apartament në pallat | Kasolle e rrethuar me dërrasa llamarinë apo plamas | Banese e përshtatur në një objekt të përshtatur | E shembur |
|--------------|---|----------------------|--|---|-----------|
| Kucove       | 34  | 3                    | 4  | 11  | 3         |
| <b>Total</b> | <b>34</b>                                   | <b>3</b>             | <b>4</b>   | <b>11</b>                                       | <b>3</b>  |




## 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN

**Tabela 5: Situata e familjeve te pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Kuçovë**

| Emërtimi zonës   | Total | Rome | %   | Egjiptiane | %   |
|--|-------|------|-----|------------|-----|
| Familje gjithsej   | 66    | 44   | 67% | 22         | 33% |
| Familje në nevojë për strehim:                           | 59    | 37   | 63% | 22         | 37% |
| Nuk zotërojnë një hapësirë për të jetuar                 | 39    | 30   | 77% | 9          | 23% |
| Zotërojnë një hapësirë jetese nën standartet e strehimit | 20    | 7    | 35% | 13         | 65% |


**Figura 1: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Kuçovë**



**Tabela 6: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E**

| Lloji i kushteve te strehimit          | Numri |
|--|-------|
| Jetojne ne tenda, baraka, depo         | 39    |
| Jetojne ne garsionere                  | 0     |
| Jetojne ne apartmente 1+1              | 15    |
| Jetojne ne apartmente 2+1              | 3     |
| Jetojne ne apartmente 3+1 ose me shume | 2     |
| Total                                  | 59    |

**Figura 2: Situata aktuale e akomodimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Kuçovë**



Përmirësimi i cilësisë së strehimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian është një nevojë urgjente dhe duhet parë në kuadrin e politikave të strehimit në përgjithësi, që në të njëjtën kohë përputhen me objektivat e politikave ekonomike dhe kontribuojnë në forcimin e politikave sociale. Këto politika të strehimit duhet të zhvillohen brenda një kuadri të përgjithshëm legjislativ, që propozojnë masa konkrete për të mbështetur financimin nëpërmjet planeve dhe politikave të qeverisë mbi strehimin.

Për të përmirësuar kushtet e banesave të komuniteteve rome dhe egjiptiane është analizuar kosto për riparim e banesave ekzistuese, e shtesave të nevojshme të këtyre banesave. Në shumicën e rasteve banesat kanë nevojë për të dyja këto nderhyrje. Për të përcaktuar çmimin e riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë në konsideratë lloji i ndërtimeve të gjendja ekzistuese. Nderhyrja do të konsistoje në riparimin e muratave, shtesave, dyshemve, terraces ose çatisë, tavanit, ndërhyrje në dyert dhe dritaret, riparim dhe zëvendësim i tyre, riparimi i nyjeve hidrosanitare. Nga përllogaritja, çmimi i riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi ka rezultuar nga 7000-11000 lekë/m<sup>2</sup> (mesatarisht 9000 lekë/m<sup>2</sup>). Llogaritjet tregojnë që duhen 300.000 lekë/familje riparime për garsonieret, 500.000 lekë/familje për apartamentet 1+1, 600.000 lekë/familje riparime për apartamentet 2+1 dhe 800.000 lekë/familje riparime për apartamentet 3+1. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht: garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kjo analizë ka konkluduar me koston 1.200.000 lekë/familje për sipërfaqen shtesë për apartamentet 1+1, 2+1, dhe 3+1 llogaritur si prodhim i sipërfaqes të shtesës në m<sup>2</sup> me çmimin e ndërtimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, duke konsideruar sipërfaqen e nevojshme për shtesë 30-40 m<sup>2</sup>, (sipërfaqe që do të përfshijë një ambient dite dhe një ambient ndihmes/ një ambient gjumi dhe dy ambiente ndihmese ose dy ambiente gjumi sipas secilit rast). Për garsonieret është menduar të bëhet rikonstrukcioni i tyre për të zgjidhur problemet e femijëve të familjeve dhe jo shtesë, pasi shtesa në to nuk justifikon koston e lartë të ndërtimit si për nga sipërfaqja e madhe, ashtu edhe për gjendjen e amortizuar të garsonierëve. Banesat 3+1 kanë sipërfaqe të mjaftueshme banimi ndaj nuk është e nevojshme të ndërtohet shtesë. Më poshtë jepet tabela me llogaritjen e koston të riparimeve dhe shtesave të banesave.

## Analiza e Kostove per Rikonstrukcionin

Struktura e meposhtme eshte nje zberthim i menyres se shperndarjes se vleres ne me te shumten e rasteve, por kjo menyre eshte variabel sipas situates qe paraqitet.

### • Ndertim Garsoniere

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstrukcion WC   | 120,000         |
| 2            | Rikonstrukcion Suva dhe Mure                                      | 70,000          |
| 3            | Rikonstrukcion DysHEME dhe Cati                                   | 50,000          |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 30,000          |
| 5            | Rikonstrukcion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 30,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>300,000</b>  |

### • Ndertim 1+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstrukcion WC   | 150,000         |
| 2            | Rikonstrukcion Suva dhe Mure                                      | 120,000         |
| 3            | Rikonstrukcion DysHEME dhe Cati                                   | 110,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 60,000          |
| 5            | Rikonstrukcion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 60,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>500,000</b>  |

### • Ndertim 2+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstrukcion WC   | 160,000         |
| 2            | Rikonstrukcion Suva dhe Mure                                      | 140,000         |
| 3            | Rikonstrukcion DysHEME dhe Cati                                   | 130,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 90,000          |
| 5            | Rikonstrukcion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 80,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>600,000</b>  |

### • Ndertim 3+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstrukcion WC   | 170,000         |
| 2            | Rikonstrukcion Suva dhe Mure                                      | 200,000         |
| 3            | Rikonstrukcion DysHEME dhe Cati                                   | 200,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 120,000         |
| 5            | Rikonstrukcion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 110,000         |
| <b>Total</b> |   | <b>800,000</b>  |

Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstrukcion dhe shtesa eshte si me poshte:

Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstrukcion dhe shtesa eshte si me poshte:

- Kosto e rikonstrukcionit per garsoniere = numri familjeve \* 300.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 1+1 = numri familjeve \* 1.700.000 lekë/familje (500.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 2+1 = numri familjeve \* 1.800.000 lekë/familje (600.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit per apartamente 3+1 = numri familjeve \* 800.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- **Kosto totale per rikonstrukcion + shtesë** = Kosto e rikonstrukcionit per garsoniere + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (1+1) + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (2+1) + Kosto e rikonstrukcionit per apartamente (3+1)

**Tabela 7: Vlerësimi i koston per rikonstrukcion + shtesa në Bashkinë Kuçovë**

| Tipi         | Kosto per rikonstrukcion lekë | Kosto per Shtesa lekë | Nr familjeve | Kosto lekë        |
|--------------|-------------------------------|-----------------------|--------------|-------------------|
| garsoniere   | 300,000                       | -                     | -            | -                 |
| ap 1+1       | 500,000                       | 1,200,000             | 15           | 25,500,000        |
| ap 2+1       | 600,000                       | 1,200,000             | 3            | 5,400,000         |
| ap 3+1       | 800,000                       | -                     | 2            | 1,600,000         |
| <b>Total</b> |                               |                       | <b>20</b>    | <b>32,500,000</b> |

**Tabela 8: Aksesit per uje, kanalizime dhe furnizim me energji elektrike I komunitetit R/E ne Bashkine Kuçovë**

| Punë ne infrastrukturën inxhinierike (Për secilën zonë) | Gjatesia në metra |
|---|-------------------|
| Rrjeti i furnizimit me ujë                              | 0                 |
| Rrjeti i kanalizimeve                                   | 1120              |
| Rrjeti i furnizimit me energji elektrike                | 0                 |
| Rruge   | 1750              |

Ne estimimin qe eshte bere per infrastrukturen ne keto zona eshte parashikuar permiresimi i rrjetit infrastrukturor per te gjithë komunitetin (zonen), pra ky rrjet do ti sherbeje dhe atyre familjeve qe nuk kane nevojë per permiresim te kushteve. Vlerësimi i koston për investimin në infrastrukturë është llogaritur si prodhim i gjatësisë në metra te infrastukturës primare të nevojitur, me çmimin për metër linear për secilin zë. Çmimi eshte percaktuar si mesatare e të njejtit zë në projekte të mëparshme. Zërat e përfshirë në infrastrukturën primare, për te cilët janë marrë të dhëna nga bashkitë përkatëse janë : gjatësia e rrugëve, çmimi për metër linear i llogaritur për afërsisht 30000 lekë/ml (gjeresia e rruges merret 5m si rrjedhoje 1 meter linear gjatesi=5 m<sup>2</sup> siperfaqe), gjatësia e rrjetit të furnizimit me ujë\_çmimi 6000 lekë/ml, gjatësia e rrjetit të kanalizimeve, çmimi 8000 lekë/ml dhe gjatësia e rrjetit të furnizimit me energji elektrike, çmimi 4000 lekë/ml. Në rastet kur vlera e zërave te infrastrukturës është 0, si rrjedhojë dhe kosto përkatëse është 0 lekë, tregon se për zërin në fjalë nuk ka nevojë për investim.

Formula e perdorur per vleresimin e koston per infrastrukturen eshte si me poshte:

- Kosto per rrjetin e furnizimit me uje = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per rrjetin e kanalizimeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per furnizimin me energji elektrike = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per ndertimin e rrugeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- **Kosto per infrastrukturen** = Kosto per rrjetin e furnizimit me uje + Kosto per rrjetin e kanalizimeve + Kosto per furnizimin me energji elektrike + Kosto per ndertimin e rrugeve

**Tabela 9: Vlerësimi i koston per infrastrukturen në Bashkinë Kuçovë**

| Tipi         | lekë/ ml | Gjatesia në metra | Kosto lekë        |
|--------------|----------|-------------------|-------------------|
| Rrugë        | 30,000   | 1,750             | 52,500,000        |
| Ujë          | 6,000    | -                 | -                 |
| Elektrike    | 4,000    | -                 | -                 |
| Kanalizime   | 8,000    | 1,120             | 8,960,000         |
| <b>Total</b> |          |                   | <b>61,460,000</b> |

Nevojat për ndërtime të reja përfshin ata që banojnë në kasolle si edhe në banesa që nuk kanë siguri për jetën si: tenda, baraka, depo. Sipas kritereve dhe normativave të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr 824 datë 3.12.2004 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" është bërë dhe vlerësimi i koston për keto ndërtime. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht : garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kosto e ndërtimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë për çdo qytet nga manuali i qeverisë në qershor 2015: "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit te banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015". Më poshtë jepen formulat e llogaritjes të koston të ndërtimeve të reja dhe tabela përkatëse me rezultatet.

**Tabela 10: Kërkesa e komunitetit R/E per strehim, ne Bashkine Kuçovë**

| Lloji i Strehimit  | Nevoja per studim komuniteti Rom | Nevoja per studim komuniteti Egjiptian |
|--|----------------------------------|--|
| Numri i familjeve qe u nevojiten garsoniere                                      | 5                                | 0                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 1+1                                 | 15                               | 0                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 2+1                                 | 10                               | 9                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 deri ne 75,5 m <sup>2</sup>     | 0                                | 0                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 me shume se 75,5 m <sup>2</sup> | 0                                | 0                                      |
| <b>Numri total i familjeve</b>   | <b>30</b>                        | <b>9</b>                               |

Formulat e perdorura per vleresimin e koston per ndertime te reja jane si me poshte:

- Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per garsoniere e caktuar 35 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 1+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 1+1 e caktuar 55 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 2+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 2+1 e caktuar 67 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 3+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 3+1 e caktuar 75.5 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- **Kosto totale per ndërtime te reja** = Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (1+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (2+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (3+1) = Shuma gjithsej



**Foto nga vendbanimet R/E**



Foto nga vendbanimet R/E

Tabela 11: Vlerësimi i kostos për ndertime të reja në Bashkinë Kuçovë

| Tipi         | lekë/ m <sup>2</sup> | Sipërfaqe m <sup>2</sup> | Nr familjeve | Kosto lekë        |
|--------------|----------------------|--------------------------|--------------|-------------------|
| garsoniere   | 32,317               | 35                       | 5            | 5,655,475         |
| ap 1+1       | 32,317               | 55                       | 15           | 26,661,525        |
| ap 2+1       | 32,317               | 67                       | 19           | 41,139,541        |
| ap 3+1       | 32,317               | 76                       | -            | -                 |
| <b>Total</b> |                      |                          | <b>39</b>    | <b>73,456,541</b> |

**Kosto Total në Bashkinë Kuçovë - 167,416,541**

Duke u nisur nga situata konkrete dhe nga informacioni që mësohet nga Bashkia, menyrë që i përshkruhet me shumë realitet, sipas analizës të bërë, është ndërtimi i banesave me kosto të ulët, kjo e kombinuar dhe me rikonstruksionin dhe me ndërtimin e shtesave për banesat ekzistuese. Ndërtimi i banesave me kosto të ulët, parashikohet të bëhet në hapësirat e lira të zonave në të cilat këto komunitete jetojnë aktualisht. Për shkak të mungesës së informacionit në lidhje me komunitetin Egjiptian për kërkesa për banesa sociale, është menduar që në qoftë se nga bashkita do të investohet në këtë drejtim, fondi që do parashikohet për ata familje që do përfitojnë nga banesat sociale, do të zbritet nga fondi që është parashikuar në këtë studim.

Kjo analizë konkludon disa skenarë të rradhitur më poshtë:

► **Skenari 1**

**Rikonstruksioni dhe shtesa për banesat ekzistuese.**

Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk i plotësojnë kushtet e jetesës. Ato mund të kenë nevojë për:

- Rikonstruksion të banesave ekzistuese
- Rikonstruksion + Shtesa në ndërtesat ekzistuese

Familjet që bëjnë pjesë në këtë grup, kanë nevojë për shtesë ambjentesh.

► **Skenari 2**

**Ndërtim të reja.**

Është menduar që përmirësimi i kushteve të katër familjeve, nisur nga menyrë e jetesës që ato kanë, të bëhet në hapësirat e zonave ku ata jetojnë aktualisht. Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk plotësojnë kushtet minimale të jetesës. Në këtë rast propozohet të bëhen ndërtim të reja për të cilat janë evidentuar sipërfaqet përkatëse për secilin tip apartamenti (garsoniere, apartamente 1+1, 2+1 ose 3+1).

**Punime plotësuese me investime në infrastrukturën primare.**

Përveç punimeve në banesat vetjake të secilës familje është parashikuar nevoja edhe për punime në infrastrukturën primare në ndihmë të familjeve Rome apo Egjiptiane.

Këto punime konsistojnë në katër grupe të mëdha:

1. Punime mirëmbajtjeje dhe ndërtimit të rrugëve
2. Ndërtim kanalizimesh për ujërat e zeza dhe përmirësimi i pusetave ekzistuese,
3. Ndërtim si dhe riparim i degëzimeve të ujësjellësit. Për të gjitha këto punime janë parashikuar kostot më lart.
4. Shtim i gjatësisë të rrjetit elektrik.

## 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

Aktualisht, në qytetin e Kuçovës ka 865 familje të pastreha, nga të cilat 526 jetojnë në banesa me bashkëpronësi dhe 212 në banesa individuale. Ndërkaq, situata e aplikantëve për strehim social është si më poshtë:

- ▶ 17 familje që kanë liruar banesat e pronarëve, nga të cilat 2 R&E
- ▶ 13 familje që janë në proces gjyqësor, nga të cilat 0 familje R&E
- ▶ 59 familje që vazhdojnë të jetojnë në banesa të pronarëve, nga të cilat 3 R&E
- ▶ 3 familje që jetojnë në banesa në rrezik shembjeje, nga të cilat 2 familje rome
- ▶ 50 familje R&E që jetojnë në kushte të vështira të infrastruktures së keqe
- ▶ 43 familje që jetojnë në territorin e UPN
- ▶ 440 familje janë miratuar me VKB si aplikantë për Programin e Banesës me Kosto të Ulët, nga të cilat 28 kanë marrë miratimin nga Banka.

Në bashkinë e Kuçovës nuk kanë funksionuar sic duhet skemat e strehimit social, megjithë informacionin e detajuar të mbledhur nga kjo bashki. Të pyetur për këtë, punonjësit e bashkisë argumentuan se mungesa e mjeteve financiare si dhe mungesa e bashkëpunimit e grupeve të interesit, kanë qenë arsye kryesore të mosfunksionimit të skemes.

Një arsye tjetër është edhe mungesa (e verifikueshme) e të ardhurave që do t'i mundësonte atyre pjesëmarrjen në disa programe, varfëria e cila i pengon njerëzit të paguajnë tarifën e legalizimit, diskriminimi dhe mungesa e dokumentacionit dhe njohurive rreth kësaj fushe me karakter mjaft teknik.


- ▶ Mungesa e një strategjie të strehimit social për bashkinë dhe territorin e ri të saj.
- ▶ Megjithëse janë realizuar një sërë vleresimesh nga ana e bashkisë për identifikimin e situatës sociale ekonomike të familjeve rome, do të duhej ndërmarë një Census i plotë, vetëm për këtë komunitet, ku identifikimi i numrit të banorëve dhe vendodhja e banesave të shoqërohet edhe me identifikimin e kushteve sociale ekonomike të tyre. Në kushtet e njësisive të reja administrative, si dhe të një legjislativi të përshtatshëm për mbështetjen e këtyre familjeve me strehim, kjo gjë bëhet imediate. Do të ishte i parakohshëm dhe jo shtrues një planifikim i nevojave për shërbime publike në përgjithësi, dhe shërbime të strehimit në veçanti, në kushtet kur nuk kemi të sigurtë për numrin e tyre dhe vendbanimet e sakta. Ky mund të ishte një rekomandim që duhet të mbetet në vëmendjen e MZHU si përgjegjëse për hartimin e politikave të strehimit dhe INSTAT si përgjegjëse për realizimin e regjistrimit të ardhshëm të popullsisë dhe banesave në vitin 2021.
- ▶ Në planin vendor të bashkisë nuk janë parashikuar zonat urbane për ndërtimin e banesave sociale me mbështetjen e Entit Kombëtar të banesave.
- ▶ Në buxhetin vjetor të bashkisë (përfshirë vitin 2016) nuk ka fonde të parashikuara për strehim, si një zë i veçantë.

- ▶ Në data bazën e krijuar për familjet aplikuese për strehim social, nuk ka informacion dhe analiza të thelluara për situatën e strehimit të familjeve rome dhe egjiptiane.
- ▶ Në kushtet kur, një pjesë e mirë e familjeve rome dhe egjiptiane nuk kanë njohuri mbi të drejtat e tyre për strehim dhe informacionin e nevojshëm për menyrën e aplikimit për strehim social, mbetet detyrë e bashkisë të informojë këtë komunitet mbi skemat sociale të strehimit.
- ▶ Informacioni i pamjaftueshëm për shkak të përjashtimit social të këtij grupi të popullatës.
- ▶ Informaliteti i këtij grupi, në aspekte të ndryshme siç janë regjistrimi në zyrat e gjendjes civile, zyrat e punës, vërtetimi për të ardhurat etj.

# ANEKSI

## Hartat e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Kuçovë





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË VLORE**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Mars 2017



## Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Vlorë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Klodioda Sh.p.k. dhe Organizata “Misionarët për të Drejtat Sociale” në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Mars 2017



## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME  | 4  |
| 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI   | 5  |
| 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit                              |    |
| 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË VLORË               | 6  |
| 3.1 Arsimimi   |    |
| 3.2 Punësimi dhe të ardhurat   |    |
| 3.3 Formimi profesional  |    |
| 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM  | 8  |
| 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT | 9  |
| 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN              | 17 |
| 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE  | 18 |
| ANEKSI   | 19 |
| Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Vlorë                            |    |



# 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Bashkia e re e Vlorës kufizohet në veri me bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Selenicë dhe në jug me bashkinë Himarë. Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia e re ka 104.827 banorë. Gjithsesi, në regjistrin civil në këtë bashki rezultojnë si popullsi banuese 194.147 banorë. Bashkia e re e Vlorës ka një sipërfaqe prej 616.85 km<sup>2</sup>.

Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novosele dhe Shushicë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra. Në listën e fshatrave përfshihet edhe Sazani.



Menaxhimi urban dhe infrastruktura bazë, përfshirë menaxhimin e mbetjeve të gurta apo mbetjeve të zakonshme, janë problemet kryesore me të cilat përballet bashkia. Qyteti ka tashmë një Plan të Përgjithshëm Vendor i cili nga pikepamja territoriale ka konsideruar territorin e ri të Bashkisë si dhe vijën bregdetare. Ky plan përbën tërësinë e të gjitha strukturave të ndërtuara të pranishme në territor si dhe perspektivën e zhvillimit urban të bashkisë, duke përfshirë zonën për banesa; shërbime; zonën industriale; të turizmit; rekreative etj. Analiza e këtij sistemi jep një vështrim të përgjithshëm të të gjithë peizazhit të ndërtuar dhe thekson llojshmërinë tipologjike të pranishme në zonën e territorit të bashkisë.

Zonat ku bashkia mund të ketë zhvillim territorial urban përbën një pjesë të vogël të territorit të Bashkisë së Vlorës dhe i referohen zonave urbane ekzistuese. Në këto kuader vendosja e popullsisë rome dhe egjiptiane në territorin e Bashkisë së Vlorës, paraqet problematike të cilat janë konsideruar në këtë studim të integruar me Planin e Përgjithshëm Vendor të hartuar në vitin 2016.

# 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI

## 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit

Tendencat demografike të Vlorës, kanë qenë ato të një qyteti që ka pësuar si emigrimin edhe migrimin nga zonat rurale në atë urbane. Emigrimi i popullsisë dallohet edhe nga diferenca e theksuar mes numrit të popullsisë të regjistruar në gjendjen civile dhe numrit të nxjerrë nga censusi. Kështu nisur nga regjistrimi i popullsisë për vitin 2011 dhe projeksionet, Bashkia Vlorë ka në përbërjen e saj 29,953 familje. Referuar kësaj shifre si edhe vetedeklarimit të marrë gjatë rregjistrimit të vitit 2011, verifikuar me të dhënat administrative të terrenit, numri i familjeve rome dhe egjiptiane përbëjnë rreth 5% të numrit të familjeve që jetojnë në Bashkinë e Vlorës.

Në Bashkinë e Vlorës, Njesia Administrativ Nr. 1, ka një përqendrim të komunitetit egjiptian, rreth 400 familje të vendosur në afërsi të lagjes Partizani. Egjiptianët gjatë periudhës së komunizmit kanë qenë të mirë-integruar në jetën e qytetit, ndërkohë që ndryshimet e viteve '90 shfaqën problemin e papunësisë në mënyrë masive për këtë komunitet. Numri i romëve që jetojnë në qytet është i kufizuar. Sipas të dhënave të Gjendes Civile Vlorë rezultoi se në Bashkinë Vlorë jetojnë 920 familje nga komuniteti rom. Ky numër rritet gjatë periudhës maj-nëntor të vitit. Intervistat e zhvilluara me përfaqësues të autoriteteve publike dhe organizatave jo-fitimprurëse në Vlorë tregojnë se nuk vihen re probleme të regjistrimit civil për komunitetin egjiptian.

Të dhënat tregojnë se shpërndarja e këtyre familjeve sipas vendbanimeve kryesore është si në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 1: Numri i familjeve romedhe egjiptiane sipas vendbanimeve në Bashkinë e Vlorës**

| Nr.          | Bashkia (Ish komuna) | Zona                   | Familje       | Banorë      |
|--------------|----------------------|------------------------|---------------|-------------|
| 1.           | Vlorë/Qendër         | Qytet-Lagjja Partizani | 400 Egjiptian | 1680        |
| 2.           | Vlorë/Qendër         | Qytet                  | 920 Rome      | 3864        |
| 3.           | Vlorë/Novosele       | Novosele               | 69            | 318         |
| 4.           | Vlorë/Novosele       | Akerni                 | 31            | 145         |
| 5.           | Vlorë/Shushicë       | Llakatund              | 53            | 240         |
| 6.           | Vlorë/Orikum         | Orikum qytet           | 31            | 155         |
| <b>Total</b> |                      |                        | <b>1504</b>   | <b>6402</b> |

**Burimi i të dhënave:** Bashkia Vlorës të dhëna administrative 2015

Ndryshe nga rasti i popullsisë rome dhe egjiptiane në Bashki të tjera të vendit, emigrimi i të rinjve Romë dhe Egjiptianë në Bashkinë e Vlorës, është shumë më i lartë dhe ndikon si në profilin e piramidës ashtu edhe në situatën social ekonomike të këtij komuniteti.

### 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË LUSHNJE

#### 3.1 Arsimimi

Anëtarët e komunitetit egjiptian në Vlorë janë arsimdashës dhe treguesit dëshmojnë interes të lartë arsimor. Numërohen rreth 170<sup>1</sup> të rinj të komunitetit egjiptian, të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë kryesisht në degët Pedagogji, Psikologji, Cikël i Ulët. Përgjithësisht anëtarët e komunitetit egjiptian janë të integruar në jetën e qytetit, duke qenë se figura të spikatura egjiptiane ushtrojnë profesionet e tyre si mësues në shkolla publike, stomatologë, biznes privat, etj.

Në Bashkinë e Vlorës nuk ka shkolla dhe kopshte që ofrojnë shërbim arsimor dhe parashkollor të ndarë specifikisht vetëm për komunitetin egjiptian. Gjithsesi disa shkolla kanë një numër më të lartë të fëmijëve të komunitetit egjiptian. Mund të përmendim shkollën e muzikës "Naim Frashëri" ku numri i fëmijëve egjiptian është më i lartë në krahasim me shkollat e tjera. Kjo lidhet me faktin se kjo shkollë është e specializuar për muzikë dhe fëmijët e komunitetit egjiptian janë të talentuar në muzikë dhe art. Gjithashtu edhe shkolla 9-vjeçare "Teli Ndini", që ndodhet në lagjen "15 Tetori" ka një numër të lartë të fëmijëve të komunitetit egjiptian. Kjo shpjegohet me vendndodhjen e shkollës në lagjen ku përqendrimi i komunitetit egjiptian është më i lartë. Këto 2 shkolla frekuentohen edhe nga nxënës që i përkasin shumicës<sup>2</sup>.

#### 3.2 Punësimi dhe të ardhurat

Në Bashkinë e Vlorës niveli I punësimit të komunitetit rom dhe egjiptian është i ulët krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë, por me i lartë se në bashki të tjera. Kjo për faktin se sidomos popullsia Egjiptiane gjatë periudhës së komunizmit ka qenë e mirë-integruar në jetën e qytetit. Megjithatë, ndryshimet e viteve '90 shfaqën problemin e papunësisë në mënyrë masive për këtë komunitet. Sektorët bazë të punës përqendrohen në shërbimin e pastrimit dhe gjelbërimit. Nuk ka një numër të saktë mbi të punësuarit egjiptianë në sektorin publik duke qenë se bazohet kryesisht në vetë-deklarim. Nga një ankete e zhvilluar në lidhje me vazhdueshmërinë në punë<sup>3</sup>, vetëm 28% e të anketuarve shprehen se kanë një punë të vazhdueshme, ndërkohë që 68% e tyre shprehen se nuk kanë një punë të vazhdueshme, ndërkohë që 4% nuk janë të sigurt mbi vazhdueshmërinë e tyre.

Prej numrit total të punëkërkuarve pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit Vlorë, grupimi punëkërkuar të papunë "të tjerë" përbën grupin më të madh. Gjatë 2015 janë regjistruar 32 punëkërkuar të papunë që janë vetedeklaruar si rom. Nuk ka të dhëna zyrtare se cili është raporti i punëkërkuarve egjiptianë në raport me numrin e përgjithshëm të punëkërkuarve duke qenë se në formularin e punëkërkuarve të papunë nuk kërkohet deklarimi i kësaj të dhëne. Gjithsesi, punonjësit të Drejtorisë Rajonale të Punësimit shprehen se një pjesë e konsiderueshme

e punëkërkuarve i përkasin komunitetit egjiptian.

Sipas Drejtorisë së Shërbimit Social pranë Bashkisë së Vlorës rreth 1/3 e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike janë familje rome dhe egjiptiane. Numri i familjeve rome egjiptiane përfituese të ndihmës ekonomike është 374 nga numri total 818 familje për Bashkinë e Vlorës në vitin 2015. Kjo përqindje e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike përbën 25% të familjeve rome dhe egjiptiane në total. Kjo tregon një varësi relativisht të lartë të familjeve rome dhe egjiptiane kundrejt ndihmës ekonomike.

**Tabela 2: Familjet rome dhe egjiptiane përfituese të ndihmëse ekonomike në Vlorë**

| Nr. | Bashkia (Ish komuna) | Familje     | Familje në NE    | PAK        |
|-----|----------------------|-------------|------------------|------------|
| 1.  | Vlore/Qender         | 1320        | 331 (25%)        | 95         |
| 2.  | Novosele/Vlore       | 100         | 24 (24%)         | 12         |
| 3.  | Shushice/Vlore       | 53          | 10 (19%)         | 10         |
| 4.  | Orikum/Vlore         | 31          | 9 (29%)          | 6          |
|     | <b>Total</b>         | <b>1504</b> | <b>374 (25%)</b> | <b>123</b> |

Burimi: Te dhëna administrative 2016

Jetesa e anëtarëve të këtij komuniteti vështirësohet më tej edhe nga kushtet infrastrukturore që rrethojnë vendbanimet e tyre. Kjo ka një ndikim të ndjeshëm edhe në situatën shëndetsore dhe ekonomike të këtij komuniteti. Banorët e pyetur në kuadër të këtij projekti rendisin infrastrukturën e dobët, kushtet jo të mira të jetesës, që lidhen kryesisht me strehimin, praninë e zonave të paurbanizuara etj., si disa nga faktorët që ndikojnë në gjendjen e tyre ekonomike. Në përgjithësi popullsia rome në Vlorë është e vendosur në periferinë e qytetit (Orikum dhe Vlorë), e cila cilësohet si zona më e varfër e cila mbulohet pjesërisht ose aspak nga shërbimet publike bazë të ujësjellës-kanalizimeve dhe të pastrimit, infrastrukturë rrugore, infrastrukturë sociale etj.

Edhe pse pjesa dërmuese e komunitetit raporton të zotërojë banesë (85%), kushtet në të cilat janë këto banesa janë shumë problematike duke filluar që nga cilësia e punimeve (një pjesë jetojnë në shtëpi balte) duke vijuar me kushtet teknike dhe higjieno-sanitare të tyre. Ata raportojnë për mungesë të theksuar dhe cilësi të papranueshme të ujit të pijshëm, për kanalizime jo funksionale, për mungesë të shërbimit të pastrimit në zonat ku ata banojnë, për rrugë të pashtuara dhe pa standardet minimale, si dhe për mungesë totale të mjediseve rekreative/sportive për fëmijët. Në këto kushte, gjendja e përgjithshme infrastrukturore vlerësohet në pjesën më të madhe shumë problematike.

#### 3.3 Formimi profesional

Anëtarë të komunitetit egjiptian në Vlorë janë pyetur nëse ata kanë ndjekur kurse të formimit profesional dhe përgjigjet kanë rezultuar sipas grafikut Formimi Profesional 1 si më poshtë, ku 87% e të pyeturve janë shprehur që nuk kanë ndjekur kurse, ndërkohë që 12% e të pyeturve kanë ndjekur kurse të tilla dhe vetëm 1% nuk e dinë ose nuk kanë informacion.

1 Te dhëna të studimit siguruar nga Drejtoria Arsimore Vlorë 2016

2 Ibid

3 Ankete e zhvilluar në kuadrin e hartimit të planit vendor për integrimin e komuniteteve rom dhe egjiptian në Bashkinë e Vlorës 2015

## 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM

Në Vlorë, 23 familje të komunitetit rom dhe egjiptian kanë përfituar nga programi i Ministrisë së Zhvillimit Urban për rikonstruksionin e banesave. Gjate vitit 2015 është bere i mundur nje investim prej 15,5 milion lekësh, fond i cili është përdorur për përmirësimin e kushteve të banesave në lagjen Partizani, ku pjesa më e madhe e përfituesve janë familje egjiptiane. Gjithashtu gjate vitit 2016 është realizuar nje fond 105 milion leke për rikonstruksionin e banesave të komunitetit rom edhe egjiptian I dhene nga MZHU.

Nga nje vleresim i buxhetit lokal te Bashkise per vitet 2016 dhe 2017, veme re ne strukturen buxhetore te bashkise eshte miratuar nje fond prej 720,000 leke per familjet perfituese nga programi i bonusit te strehimit<sup>4</sup>. Ne strukturen buxhetore te bashkise nuk ka planifikime per skema te tjera te strehimit apo përmirësimit te gjendjes fizike te banesave.

### 4.1 Specifikat e lidhura me ndërtimet për banesa në bashkinë e Vlorës

Po sipas censusit 2011, te dhenat te cilat i referohen statusit të banesave, tregojne një shifër prej 51,775 banesa të shpërndara nëpër të gjithë Bashkinë Vlorë. Nga te dhenat vihet re se ne te gjithë territorin e bashkise se Vlores, por vecanerisht në njësinë bashkiake Orikum ka një shifër të lartë banesash të pabanuara si dhe banesash të përdorura për qëllime dytësore. Këto shifra evidentojnë, nga njëra anë faktin se, në këtë njësi administrative ka një largim të popullsisë, që ka çuar në abandonimin e banesave ekzistuese, si rezultat i emigrimit jashtë vendit, nga ana tjetër Orikumi karakterizohet dhe nga një vlerë e lartë e banesave të reja të ndertuara gjatë viteve 2000 të destinuara për qëllime dytësore të cilat përbëjnë 30% të totalit të banesave në këtë njësi.

Zonat rezidenciale (shenuar konvencionalisht me A) përbëjnë dhe pjesën më të madhe të territorit të urbanizuar të Bashkisë Vlorë, duke përfshirë këtu zonat e shtëpive parësore dhe dytësore. Zonat rezidenciale përfshijnë një shumëllojshmëri teritorësh, ku Zona A6, është zone e percaktuar për strehim social<sup>5</sup>.

Situatën e ndërtesave të banimit na e jep shumë qartë klasifikimi i përdorur sipas Census 2011, i cili përfshin ndërtesat tradicionale dhe fillesat e stilit komunist deri në vitin 1990, dhe shtëpitë e reja ndertuar në vitet 1991 deri në 2011. Vlorë ka një shtim të vazhdueshëm të numrit të ndërtimeve duke arritur kulmin përgjatë periudhës së viteve 1991-2000 ndërtime më shifrën 6165 ndërtime. Në këtë periudhë Bashkia Vlorë rezulton me një vlerë më shumë se 4500 banesa më shumë se në vitin 1960 që evidenton faktin e një fluksi të madh emigrator në këtë zonë gjatë periudhës së viteve 1991-2000

Në Bashkinë Vlorë numërohen mbi 5,000 apartamente stok. Ndërsa, popullsia në nevojë në Bashkinë e Vlores është mbi 1200 familje.

4 <http://www.vendime.al/wp-content/uploads/2017/02/VENDIM-I-K%C3%82BBSHILLIT-T%C3%82B-BASHKIS%C3%82B-VLOR%C3%82B-nr03-DATE-31.01.2017.pdf>

5 <file:///C:/Users/mirela.muca/Documents/2/Mirela%20personale/2016%20Klodioda/Vlore/Plan-Zhvillimi-Vlore.pdf>

## 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT

Sipas te dhenave te Censusit 2014, "banesat dhe popullata rome ne Shqiperi", siuate ne rajonin e Vlores eshte relativisht me e mire se ne rajone te tjera te Shqiperise ku jane perqendruar keto komunitete. Keshtu lidhur me statusin fizik te banesave, banesat e familjeve rome konsiderohen ne masen 26% te pabanueshme dhe 35% pothuaj te pabanueshme, e krahasuar kjo me nivelin e Shqiperise, siuate eshte dukshem me e mire.

Përgjithësisht familjet egjiptiane që jetojnë në lagjen "Partizani" kanë në zotërim shtëpitë ku jetojnë. Nga të anketuarit e pyetur nëse zotërojnë një shtëpi, 71% e tyre pranojnë se kanë shtëpinë e tyre, ndërkohë që 29% nuk zotërojnë një shtëpi. Kjo e dhënë dhe intervistat e zhvilluara me përfaqësues të Shërbimit Social Shtetëror tregojnë se ka raste të pastrehësh midis familjeve egjiptiane, që nuk përmbushin kriteret për të përfituar nga programet për banesa sociale të ofruara nga Bashkia Vlorë.

Të pyetur në lidhje me vlerësimin e kushteve higjieno-sanitare pranë familjeve të tyre, përgjigjet janë të ndryshme, gjë që tregon variacionin midis standardeve të ndryshme të jetesës. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve prej 39% i vlerësojnë kushtet higjieno-sanitare mesatarisht, 23% keq dhe 29% mirë. Ka prani të të dy niveleve ekstreme ku 7% janë shprehur shumë mirë dhe vetëm 2% janë shprehur shumë keq.

**Tabela 3: Të dhëna të censusit për cilësinë e banesave e komunitetit rom në Vlorë**

| Bashkia        | Shtëpi private (me tulla, bloqe apo beton) | Apartament në pallat | Kasolle e rrethuar me dërrasa llamarinë apo plamas | Banese e përshtatur në një objekt të përshtatur | E shembur |
|----------------|--|----------------------|--|---|-----------|
| Vlorë          | 1  | 0                    | 0  | 3   | 0         |
| Novosele/Vlorë | 42   | 0                    | 5  | 6   | 0         |
| Shushice       | 68   | 7                    | 1  | 4   | 0         |
| <b>Total</b>   | <b>111</b>                                 | <b>7</b>             | <b>6</b>   | <b>13</b>                                       | <b>0</b>  |

Përfaqësuesit e Bashkisë Vlorë shprehen se nuk ka diferencime në lidhje me investimet kapitale dhe ofrimin e shërbimeve publike vendore të sanksionuara në ligjin 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore". Të pyetur në lidhje me gjendjen e infrastrukturës si rrugë, ujësjellës dhe kanalizime pranë lagjes Partizani, 48% e të anketuarve japin një vlerësim negativ duke u shprehur keq, 32% japin vlerësim mesatar, 14% shumë keq dhe 6% mirë.

Ne Bashkinë e Fierit nuk ka nje baze te dhenash per situaten e strehimit te familjeve rome dhe egjiptiane. Te dhenat e mesiperme jane siguruar nga studime dhe vleresime te bera kryesisht ne nivel kombetar, per rrjedhoje edhe perfaqsimi i shifrave mund te jete I diskutueshem.

Sipas informacionit të siguruar nga studimi dhe vecanerisht nga diskutimet me grupet e interesit, përdorimi dhe aksesimi në programet e strehimit social nga komuniteti rom dhe egjiptian është


mjaft i ulët. Shume pak prej pjesmarresve nga ky komunitet pohojnë se ekziston një institucion që ofron këtë shërbim në zonën ku ata banojnë.

Por pavarisht te dhenave, nga studimi vleresohet nje numer shume me i madh i familjeve rome dhe egjiptiane me problem te strehimit.

**Tabela 4: Situata e familjeve te pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkine Vlorë**

| Emërtimi zonës   | Total | Rome | %   | Egjiptiane | %   |
|--|-------|------|-----|------------|-----|
| Familje gjithsej   | 568   | 118  | 21% | 450        | 79% |
| Familje në nevojë për strehim:                           | 275   | 45   | 16% | 230        | 84% |
| Nuk zotërojnë një hapësirë për të jetuar                 | 40    | 10   | 25% | 30         | 75% |
| Zoterojnë një hapësirë jetese nën standartet e strehimit | 235   | 35   | 15% | 200        | 85% |


**Figura 1: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Vlorë**



**Tabela 5: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E**

| Lloji i kushteve te strehimit          | Numri |
|--|-------|
| Jetojne ne tenda, baraka, depo         | 40    |
| Jetojne ne garsionere                  | 33    |
| Jetojne ne apartmente 1+1              | 67    |
| Jetojne ne apartmente 2+1              | 135   |
| Jetojne ne apartmente 3+1 ose me shume | 0     |
| Total                                  | 275   |

**Figura 2: Situata aktuale e akomodimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Vlorë**



Përmirësimi i cilësisë së strehimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian është një nevojë urgjente dhe duhet parë në kuadrin e politikave të strehimit në përgjithësi, që në të njëjtën kohë përputhen me objektivat e politikave ekonomike dhe kontribuojnë në forcimin e politikave sociale. Këto politika të strehimit duhet të zhvillohen brenda një kuadri të përgjithshëm legjislativ, që propozojnë masa konkrete për të mbështetur financimin nëpërmjet planeve dhe politikave të qeverisë mbi strehimin.

Për të përmirësuar kushtet e banesave të komuniteteve rome dhe egjiptiane është analizuar kosto për riparim e banesave ekzistuese, e shtesave te nevojshme te ketyre banesave. Ne shumicen e rasteve banesat kane nevojë për te dyja keto nderhyrje. Për të përcaktuar çmimin e riparimeve për 1 m2 sipërfaqe banimi, është marrë në konsideratë lloji i ndërtimeve e gjendja ekzistuese. Nderhyrja do te konsistoje ne riparimin e muratures,suvatimeve,dyshemve, tarraces ose çatisë, tavanit, ndërhyrje në dyert dhe dritaret, riparim dhe zëvendësim i tyre, riparimi i nyjeve hidrosanitare. Nga përlllogaritja, çmimi riparimeve për 1 m2 sipërfaqe banimi ka rezultuar nga 7000-11000 lekë/m2 (mesatarisht 9000 lekë/m2). Llogaritjet tregojne qe duhen 300.000 lekë/familje riparime për garsonieret, 500.000 lekë/familje për apartamentet 1+1, 600.000 lekë/familje riparime për apartamentet 2+1 dhe 800.000 lekë/familje riparime për apartamentet 3+1. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përlllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht : garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kjo analizë ka konkluduar me koston 1.200.000 lekë/familje për sipërfaqen shtesë për apartamentet 1+1, 2+1, dhe 3+1 llogaritur si prodhim i sipërfaqes te shteses ne m<sup>2</sup> me çmimin e ndertimit për 1 m2 sipërfaqe banimi, duke konsideruar sipërfaqen e nevojshme për shtese 30-40 m<sup>2</sup>, (siperfaqe qe do te perfshije nje ambient dite dhe nje ambient ndihmes/ nje ambient gjumi dhe dy ambiente ndihmese ose dy ambiente gjumi sipas secilit rast). Për garsonieret është menduar të bëhet rikonstruksioni i tyre për të zgjidhur problemet e femijeve të familjeve dhe jo shtese, pasi shtesa ne to nuk justifikon koston e larte te ndertimit si per nga siperfaqja e madhe, ashtu edhe per gjendjen e amortizuar te garsioniereve. Banesat 3+1 kane siperfaqe te mjaftueshme banimi ndaj nuk eshte e nevojshme te ndertoht shtese. Më poshtë jepet tabela me llogaritjen e koston te riparimeve dhe shtesave të banesave.

## Analiza e Kostove per Rikonstrukcionin

Struktura e meposhtme eshte nje zberthim i menyres se shperndarjes se vleres ne me te shumten e rasteve, por kjo menyre eshte variabel sipas situates qe paraqitet.

### • Ndertim Garsoniere

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstrukcion WC   | 120,000         |
| 2            | Rikonstrukcion Suva dhe Mure                                      | 70,000          |
| 3            | Rikonstrukcion DysHEME dhe Cati                                   | 50,000          |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 30,000          |
| 5            | Rikonstrukcion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 30,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>300,000</b>  |

### • Ndertim 1+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstrukcion WC   | 150,000         |
| 2            | Rikonstrukcion Suva dhe Mure                                      | 120,000         |
| 3            | Rikonstrukcion DysHEME dhe Cati                                   | 110,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 60,000          |
| 5            | Rikonstrukcion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 60,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>500,000</b>  |

### • Ndertim 2+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstrukcion WC   | 160,000         |
| 2            | Rikonstrukcion Suva dhe Mure                                      | 140,000         |
| 3            | Rikonstrukcion DysHEME dhe Cati                                   | 130,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 90,000          |
| 5            | Rikonstrukcion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 80,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>600,000</b>  |

### • Ndertim 3+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstrukcion WC   | 170,000         |
| 2            | Rikonstrukcion Suva dhe Mure                                      | 200,000         |
| 3            | Rikonstrukcion DysHEME dhe Cati                                   | 200,000         |
| 4            | Rparim /zevendesim Dyer /Dritare                                  | 120,000         |
| 5            | Rikonstrukcion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtem | 110,000         |
| <b>Total</b> |   | <b>800,000</b>  |

Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstrukcion dhe shtesa eshte si me poshte:

- Kosto e rikonstrukcionit per garsoniere = numri familjeve \* 300.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 1+1 = numri familjeve \* 1.700.000 lekë/familje (500.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 2+1 = numri familjeve \* 1.800.000 lekë/familje (600.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit per apartamente 3+1 = numri familjeve \* 800.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- Kosto totale per rikonstrukcion + shtesë** = Kosto e rikonstrukcionit per garsoniere + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (1+1) + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (2+1) + Kosto e rikonstrukcionit per apartamente (3+1)

**Tabela 6: Vlerësimi i koston per rikonstrukcion + shtesa në Bashkinë Vlorë**

| Tipi         | Kosto per rikonstrukcion lekë | Kosto per Shtesa lekë | Nr familjeve | Kosto lekë         |
|--------------|-------------------------------|-----------------------|--------------|--------------------|
| garsoniere   | 300,000                       | -                     | 33           | 9,900,000          |
| ap 1+1       | 500,000                       | 1,200,000             | 67           | 113,900,000        |
| ap 2+1       | 600,000                       | 1,200,000             | 135          | 243,000,000        |
| ap 3+1       | 800,000                       | -                     | -            | -                  |
| <b>Total</b> |                               |                       | <b>235</b>   | <b>366,800,000</b> |

**Tabela 7: Aksesit per uje, kanalizime dhe furnizim me energji elektrike I komunitetit R/E ne Bashkine Vlorë**

| Punë ne infrastrukturën inxhinierike (Për secilën zonë) | Gjatesia në metra |
|---|-------------------|
| Rrjeti i furnizimit me ujë                              | 4360              |
| Rrjeti i kanalizimeve                                   | 3860              |
| Rrjeti i furnizimit me energji elektrike                | 0                 |
| Rruge   | 3860              |

Ne estimimin qe eshte bere per infrastrukturen ne keto zona eshte parashikuar permiresimi i rrjetit infrastrukturor per te gjithë komunitetin (zonen), pra ky rrjet do ti sherbeje dhe atyre familjeve qe nuk kane nevojë per permiresim te kushteve. Vlerësimi i koston për investimin në infrastrukturë është llogaritur si prodhim i gjatësisë në metra te infrastukturës primare të nevojitur, me çmimin për metër linear për secilin zë. Çmimi eshte percaktuar si mesatare e të njejtit zë në projekte të mëparshme. Zërat e përfshirë në infrastrukturën primare, për te cilët janë marrë të dhëna nga bashkitë përkatëse janë : gjatësia e rrugëve, çmimi për metër linear i llogaritur përafërsisht 30000 lekë/ml (gjeresia e rruges merret 5m si rrjedhoje 1 meter linear gjatesi=5 m<sup>2</sup> siperfaqe), gjatësia e rrjetit të furnizimit me ujë\_çmimi 6000 lekë/ml, gjatësia e rrjetit të kanalizimeve, çmimi 8000 lekë/ml dhe gjatësia e rrjetit të furnizimit me energji elektrike, çmimi 4000 lekë/ml. Në rastet kur vlera e zërave te infrastrukturës është 0, si rrjedhojë dhe kosto përkatëse është 0 lekë, tregon se për zërin në fjalë nuk ka nevojë për investim.

Formula e perdorur per vleresimin e koston per infrastrukturen eshte si me poshte:

- Kosto per rrjetin e furnizimit me uje = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per rrjetin e kanalizimeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per furnizimin me energji elektrike = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per ndertimin e rrugeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- **Kosto per infrastrukturen** = Kosto per rrjetin e furnizimit me uje + Kosto per rrjetin e kanalizimeve + Kosto per furnizimin me energji elektrike + Kosto per ndertimin e rrugeve



Foto nga vendbanimet R/E

Tabela 8: Vlerësimi i koston per infrastrukturen në Bashkinë Vlorë

| Tipi         | lekë/ ml | Gjatesia në metra | Kosto lekë         |
|--------------|----------|-------------------|--------------------|
| Rrugë        | 30,000   | 3,860             | 115,800,000        |
| Ujë          | 6,000    | 4,360             | 26,160,000         |
| Elektrike    | 4,000    | -                 | -                  |
| Kanalizime   | 8,000    | 3,860             | 30,880,000         |
| <b>Total</b> |          |                   | <b>172,840,000</b> |

Nevojat për ndërtime të reja përfshin ata që banojnë në kasolle si edhe në banesa që nuk kanë siguri për jetën si: tenda, baraka, depo. Sipas kriterëve dhe normativave të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr 824 datë 3.12.2004 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" është bërë dhe vlerësimi i koston për keto ndërtime. Për

çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht : garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kosto e ndërtimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë për çdo qytet nga manuali i qeverisë në qershor 2015: "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit te banesave nga Enti Kombëtar i Banësive për vitin 2015". Më poshtë jepen formulat e llogaritjes të koston të ndërtimeve të reja dhe tabela përkatëse me rezultatet.

Tabela 9: Kërkesa e komunitetit R/E per strehim, ne Bashkine Vlorë

| Lloji i Strehimit  | Nevoja per studim komuniteti Rom | Nevoja per studim komuniteti Egjiptian |
|--|----------------------------------|--|
| Numri i familjeve qe u nevojiten garsoniere                                      | 5                                | 10                                     |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 1+1                                 | 5                                | 0                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 2+1                                 | 0                                | 15                                     |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 deri ne 75,5 m <sup>2</sup>     | 0                                | 5                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 me shume se 75,5 m <sup>2</sup> | 0                                | 0                                      |
| <b>Numri total i familjeve</b>   | <b>10</b>                        | <b>30</b>                              |

Formulat e perdorura per vleresimin e koston per ndertime te reja jane si me poshte:

- Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per garsoniere e caktuar 35 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 1+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 1+1 e caktuar 55 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 2+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 2+1 e caktuar 67 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 3+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 3+1 e caktuar 75.5 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- **Kosto totale per ndërtime te reja** = Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (1+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (2+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (3+1) = Shuma gjithsej

Tabela 10: Vlerësimi i koston per ndertime të reja në Bashkinë Vlorë

| Tipi                | lekë/ m <sup>2</sup> | Siperfaqe m <sup>2</sup> | Nr familjeve | Kosto lekë         |
|---------------------|----------------------|--------------------------|--------------|--------------------|
| garsoniere          | 31,360               | 35                       | 15           | 16,464,000         |
| ap 1+1              | 31,360               | 55                       | 30           | 51,744,000         |
| ap 2+1              | 31,360               | 67                       | 40           | 84,044,800         |
| ap 3+1              | 31,360               | 75.5                     | 45           | 106,545,600        |
| ap 3+1 dhe me shume | 31,360               | 85                       | 20           | 53,312,000         |
| <b>Total</b>        |                      |                          | <b>150</b>   | <b>312,110,400</b> |

**Kosto Total në Bashkinë Vlorë - 610,606,170**

Duke u nisur nga situata konkrete dhe nga informacioni që mëmë nga Bashkia, menyra që i pershtatet më shumë realitetit, sipas analizës të tone, është ndërtimi i banesave me kosto të ulët, kjo e kombinuar dhe me rikonstruksionin dhe me ndërtimin e shtesave për banesat ekzistuese. Ndërtimi i banesave me kosto të ulët, parashikohet të bëhet në hapësirat e lira të zonave në të cilat këto komunitete jetojnë aktualisht. Për shkak të mungesës të informacionit në lidhje me komunitetin Egjiptian për kërkesa për banesa sociale, është menduar që në qoftë se nga bashkita do të investohet në këte drejtim, fondi që do parashikohet për ata familje që do përfitojnë nga banesat sociale, do të zbritet nga fondi që është parashikuar në këte studim.

Kjo analizë konkludon disa skenarë të rradhitur më poshtë:

#### ► Skenari 1

##### **Rikonstruksioni dhe shtesa për banesat ekzistuese.**

Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk i plotësojnë kushtet e jetesës. Ato mund të kenë nevojë për:

- Rikonstruksion të banesave ekzistuese
- Rikonstruksion + Shtesa në ndërtesat ekzistuese

Familjet që bëjnë pjesë në këtë grup, kanë nevojë për shtesë ambjentesh.

#### ► Skenari 2

##### **Ndërtime të reja.**

Është menduar që përmirësimi i kushteve të këtyre familjeve, nisur nga menyra e jetesës që ato kanë, të bëhet në hapësirat e zonave ku ata jetojnë aktualisht. Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk plotësojnë kushtet minimale të jetesës. Në këtë rast propozohet të bëhen ndërtime të reja për të cilat janë evidentuar sipërfaqet përkatëse për secilin tip apartamenti (garsoniere, apartamente 1+1, 2+1 ose 3+1).

##### **Punime plotësuese me investime në infrastrukturën primare.**

Përveç punimeve në banesat vetjake të secilës familje është parashikuar nevojja edhe për punime në infrastrukturën primare në ndihmë të familjeve Rome apo Egjiptiane.

Këto punime konsistojnë në katër grupe të mëdha:

1. Punime mirëmbajtjeje dhe ndërtimit të rrugëve
2. Ndërtim kanalizimesh për ujërat e zeza dhe përmirësimi i pusetave ekzistuese,
3. Ndërtim si dhe riparim i degëzimeve të ujësjellësit. Për të gjitha këto punime janë parashikuar kostot më lart.
4. Shtim i gjatësisë të rrjetit elektrik.

## 6.

## PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN

Procesi më i rëndësishëm në Bashki, është përcaktimi i trojeve publike dhe regjistrimi i tyre në pronësi, për të pasur mundësinë për të aplikuar për kreditë ndryshme ose projekte që financojnë strehimin social sipas politikave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqënies Sociale. Pronësia e truallit, është kusht i domosdoshëm për çdo vendimarrje në lidhje me strehimin social. Forma të tjera të zhvillimit për strehimin social në të ardhën mund të përdoren instrumenta financiar si: marrje me qera nga bashkia e godinave nga stoku i banesave. Një alternativë tjetër për Bashkinë Vlorë është evidentimi i saktë i stokut të banesave dhe mundësia për tu përdorur nëpërmjet instrumentave financiar apo patneriteteve të ndryshme që bashkia mund të krijojë nga detyrimet fiskale që shumë pronarë të stokut të apartamenteve mund të konvertojnë në apartamente për detyrimet financiare që i kanë bashkise. Në këte rast Bashkia vendos një raport tjetër kontraktimi me familjet në nevojë për tu ardhur në ndihmë nëpërmjet këtij procesi. Bashkia ka planifikuar dy parcela për ndërtime për strehim social. Bashkia në bashkëpunim me entitetin e banesave, në një truall afer "ish-frigoriferit", po shikojnë mundësinë negociimit për ndërtimin e një kompleksi banimi për shtëpi sociale ku mendohet të ndërtohen rreth 150 apartamente.

Një problem shumë i madh për komunitetin egjiptian që jeton në lagjen "Partizani" është furnizimi me ujë të pijshëm. Është kryer investimi për shtrirjen e tubacionit kryesor të ujit në këtë lagje, por nuk janë bërë lidhjet dytësore për çdo shtëpi. Është i domosdoshëm ndërtimi i rrjetit sekondar, lidhja me linjën kryesore dhe shkëputja e lidhjeve të paligjshme që janë kryer me linjën e spitalit të qytetit. Në lidhje me lagjen "15 Tetori", ku përsëri ka një përqendrim të komunitetit egjiptian problem kryesor mbetet infrastruktura rrugore. Rrugët janë të paasfaltuara, mungojnë kanalizimet dhe ndriçimi publik.

## 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

Romet dhe egjiptianet në Bashkinë e Vlores, janë grupe të perjashtuara me nevoja sociale dhe ekonomike, ku nevoja për strehim është një nga më të rëndësishmet. Nga diskutimet me grupet e fokusuar strehimi dhe punësimi kanë të njëjten prevalencë në renditjen e problematikes. Nevojen për strehim ky komunitet nuk mund ta zgjidhë në mënyrë individuale për shkak të nivelit shumë të ulët të të ardhurave të familjeve. Është e domosdoshme që zgjidhja të jetë sistematike, ku politikat e strehimit social lokal të jenë dominueset.


- ▶ Në procesin e planifikimit për shërbime publike në përgjithësi dhe shërbime të strehimit në vecanti, del e domosdoshme rregjistrimi i banorëve (rom dhe egjiptian), verifikimi i tyre, inventari sa më i saktë i banesave të tyre dhe vlerësimi inxhinjerik i kushteve të banimit. Vetëm në këtë mënyrë bashkia mund t'iu shërbejë me shërbime sociale (arsimore dhe shëndetsore) dhe shërbime strehimi. Ky është kusht paraprak për çdo investim projektiv dhe procesi vendimmarrjeje. Duke vlerësuar pasaktësitë për përcaktimin e numrit të saktë të popullatës në diferencat që ekzistojnë midis dy burimeve të ndryshme për popullsinë, asaj administrative dhe Censusit, sugjerohet që për efekt të planifikimit të përdoret burimi i Gjendjes Civile, ndërsa për projektim të përdoren burime alternative informacioni më shkallë më të ulët gabimi.
- ▶ Në planin vendor të bashkisë së Vlores janë parashikuar zonat urbane për ndërtimin e banesave sociale.
- ▶ Strehimit social, nuk është një politikë e vazhdueshme vendore. Në disa raste strehimi social perceptohet si një funksion i qeverisë qendrore.
- ▶ Megjithatë bashkia e Vlores është një nga bashkitë më të ardhurat më të mëdha të vendit, perseri në strukturën buxhetore të bashkisë nuk ka planifikim për ndërtesa sociale ose nderhyrje të qenesishme në infrastrukture.
- ▶ Bashkia e Vlores ka një bashkëpunim të mkiire me MZHU, nga e cila ka përfituar një grant për permiresimin e kushteve të komunitetit egjiptian në qendër të qytetit.
- ▶ Nuk ka studime (qofte edhe pjesore) mbi infrastrukturen e vendbanimeve romë dhe egjiptiane
- ▶ Në data bazen e krijuar për familjet aplikuese për statusin e të pastrehit, nuk ka informacion dhe analiza të thelluara për situatën e strehimit të familjeve romë dhe egjiptiane.
- ▶ Në kushtet kur, një pjesë e mirë e familjeve romë dhe egjiptiane nuk kanë njohuri mbi të drejtat e tyre për strehim dhe informacionin e nevojshëm për mënyrën e aplikimit për strehim social, mbetet detyrë e bashkisë të informojë këto komunitete mbi skemat sociale të strehimit.
- ▶ Të jetuarit në familje të mëdha, përkeqeson statusin e strehimit të këtyre familjeve.
- ▶ Pamundësia ekonomike për të siguruar individualisht nevojat për strehim. Rreth 25% e familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, përfituese të ndihmes ekonomike, janë nga komuniteti rom dhe egjiptian.
- ▶ Informacioni i pamjaftueshem për shkak të perjashtimit social të këtij grupi të popullatës.
- ▶ Informaliteti i këtij grupi, në aspekte të ndryshme siç janë rregjistrimi në zyrat e gjendjes civile, zyrat e punës, vërtetimi për të ardhurat etj.

## ANEKSI

### Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Vlorë







REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË GJIROKASTËR**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Mars 2017



## Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Gjirokastrë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Klodioda Sh.p.k. dhe Organizata “Misionarët për të Drejtat Sociale” në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Mars 2017



## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME  | 4  |
| 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian           |    |
| 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI   | 5  |
| 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit                              |    |
| 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË GJIROKASTËR         | 6  |
| 3.1 Arsimimi   |    |
| 3.2 Punësimi dhe të ardhurat   |    |
| 3.3 Formimi profesional  |    |
| 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM  | 9  |
| 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT | 10 |
| 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN              | 11 |
| 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE  | 18 |
| ANEKSI   | 20 |
| Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Gjirokastrë                      |    |

# 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Bashkia e Gjirokastrës kufizohet në veri me bashkinë Tepelenë, në lindje me Bashkinë Libohovë, në jug me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkitë Himarë dhe Delvinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Gjirokastrës.

Kjo bashki përbëhet nga 7 njësi administrative, të cilat janë: Gjirokastra, Cepo, Lazarat, Picar, Lunxhëri, Odrie dhe Antigone. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Gjirokastrë dhe e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 38 fshatra. Për të parë listën e plotë të qyteteve dhe fshatrave të kësaj bashkie.



Bashkia e re e Gjirokastrës përbëhet nga qyteti i Gjirokastrës, i cili prej vitit 2005 ndodhet në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si dhe zonat rurale kodrinore përreth, të përqendruara më së shumti te prodhimet blegtorale.

Gjirokastra është një qytet tregtar i stilit otoman, ndër të paktët të tillë të mbijetuar në Ballkan. Qyteti ka mbi 800 ndërtesa historike, shumë prej të cilave rrezikohen nga degradimi.

## 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian

Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Romëve në Bashkinë Gjirokastrë 2013-2015 është një dokument i kësaj njësie vendore i cili synon integrimin e minoritetit Rom në jetën social-ekonomike. Ky plan thekson katër prioritete të Dekadës së Përfshirjes së Romëve: Arsimin, Punësimin, Shëndetësinë dhe Strehimin, si dhe dy fusha prioritare kombëtare: Përfshirjen sociale dhe Mundësitë e barabarta dhe Trashëgiminë kulturore

Plani Vendor i Veprimit për Bashkinë Gjirokastrë gjithashtu, ka për qëllim promovimin dhe respektimin e të drejtave të komunitetit Rom si dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Dokumenti siguron se legjislacioni është në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Po ashtu përmes këtij dokumenti synohet që të arrihet përkrahja dhe inkurajimi i punës së organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë interesat e komunitetit Rom dhe thellimi i bashkëpunimit me to, duke përfshirë të gjitha palët e interesit.

Me financime të Bashkisë apo me mbështetjen e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, në Gjirokastrë po realizohen disa ndërhyrje të rëndësishme në përmirësimin e infrastruktures. Por këto ndërhyrje nuk kanë prekur strehimin e familjeve romë dhe egjiptiane. Duhet theksuar se ndryshe nga romet, egjiptianet në Gjirokastrë nuk përbëjnë një komunitet të vecuar. Ata janë pjesë e integruar e qytetit dhe përjetojnë të njëjtat probleme si dhe pjesa tjetër e popullsisë në qytet.

Qeveria vendore dhe ajo qendrore nuk kanë mundur të adaptojnë qëndrime të brendshme të vazhdueshme e të qëndrueshme ndaj komunitetit të romëve dhe egjiptianëve përsa i përket strehimit. E konsideruar një popullsi e papërfillshme përse i përket madhësisë dhe raportit që kjo popullsi ka me pjesë mazhoritare, problemet e strehimit të komunitetit rom janë parë si problem idorës së dytë. Pavarësisht kësaj, prirjet janë të njëjta si në të gjitha bashkitë e vendit dhe kanë si veçori përjashtimin dhe diskriminimin e romëve. Në përgjithësi çështjet e romëve, megjithëse të pakonsiderueshme në numër, deri më tash janë neglizhuar apo injoruar.

## 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI

### 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit

Gjirokastra shënon një nga rastet më të spikatura të zvogëlimit të popullsisë në krahasim me 2001 (-40%). Rënie kanë pësuar si zonat urbane (-20%) ashtu edhe ato rurale - përgjysmuar më 51%. Dendësia gjithashtu ka rënë në mënyrë drastike (-40%). Kjo gjë ka sjellë edhe plakjen e shpejtë të popullsisë. Sipas regjistrimit të popullsisë 2011, qarku i Gjirokastrës ka moshën mesatare më të lartë në Shqipëri me gati 40 vjeç.

**Popullsia:** Sipas Regjistrimit Civil Bashkia e Gjirokastrës numëron 52.054 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 469.25 km<sup>2</sup>, me një densitet prej 53.91 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011 dhe 110.93 banorë sipas Regjistrimit Civil. Popullsia rinore (15 – 29 vjeç) është rreth 22.8 përqind e popullsisë. Popullsia në moshë pune 15 – 64 është rreth 71 përqind, ndërsa mosha e tretë (mbi 65 vjeç) është rreth 16.8 përqind – qarku me përqindjen më të madh të moshës së tretë. 6.4% e popullsisë janë persona me aftësi të kufizuara.

Komuniteti Rom në bashkinë e Gjirokastrës është i përqëndruar në anën jugore të qytetit në të ashtuquajturën Lagjja "Zinxhiraj".

**Tabela 1: Numri i familjeve rome dhe egjiptiane sipas vendbanimeve në Bashkinë e Gjirokastrës**

| Nr. | Bashkia (Ish komuna) | Popullsia     | Popullsia Rome dhe Egjiptiane | Nr. i familjeve Rome dhe Egjiptiane |
|-----|----------------------|---------------|-------------------------------|-------------------------------------|
| 1.  | Gjirokaster /Qytet   | 37,610        | 810                           | 166                                 |
| 2.  | Cepo                 |               | 0                             | 0                                   |
| 3.  | Lazarat              |               | 90                            | 23                                  |
| 4.  | Picar                |               | 0                             | 0                                   |
| 5.  | Lunxheri             |               | 0                             | 0                                   |
| 6.  | Odrie                |               | 0                             | 0                                   |
| 7.  | Antigone             |               | 0                             | 0                                   |
|     | <b>Total</b>         | <b>52,054</b> | <b>900</b>                    | <b>189</b>                          |

**Burimi i të dhënave:** Census 2014 "Banesat dhe popullata rome ne Shqipëri" Bashkia e Gjirokastrës 2016

Në Bashkinë Gjirokastrë jetojnë aktualisht 189 familje rome dhe egjiptiane në total, ose 900 persona kundrejt 37,610 banorëve që ka në total qyteti i Gjirokastrës ose e thënë ndryshe 2% e popullsisë së qytetit të Gjirokastrës e përbën komuniteti Rom. Në këto shifra nuk janë përfshirë familjet rome që aktualisht ndodhen jashtë vendi për arsye emigrimi, si dhe familjet që kanë migruar brenda vendit për arsye pune ose janë shpërngulur nga Gjirokastra për të jetuar në një vend tjetër të Shqipërisë. Gjithashtu nga të dhënat rezultojnë se janë 80 familje të tjera që aktualisht nuk ndodhen në Gjirokastrë ose ndodhen jashtë vendit në emigrim për arsye të ndryshme ekonomike – sociale dhe kryesisht janë të lokalizuara në zonën e Janinës.

Përveç romëve që janë të përqëndruar pranë lagjes Zinxhiraj, rreth 50-60 familje të tjera migratore të ardhura kryesisht nga Pogradeci, Korça, Elbasani janë të vendosura pranë Urës së lumit. Ata jetojnë në çadra të ngritura buzë lumit, në një zonë ku mungon gjithçka. Ky grup merret kryesisht me shitje rrobash të përdorura dhe mbledhje hekurishtesh.

## 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË GJIROKASTËR

Varfëria e pjesëtarëve të komunitetit rom është shumëdimensionale dhe e vazhdueshme. Romët në qytetin e Gjirokastrës vuajnë nga të ardhura të pakta dhe kushte të këqija jetese, nuk kanë akses në shërbimet publike si kujdes mjekësor dhe arsimim, në tregun e punës, në regjistrimin civil dhe siguri. Mungesa e strehimit dhe uji të pijshëm konsiderohet problemi më i madh pas ushqimit. Romët strehohen në shtëpi të mbipopulluara ku mungojnë kushtet elementare si kanalizimet dhe uji i pijshëm. Në zonat ku janë përqëndruar romët, familjet jetojnë në kasolle ose në ndërtesa të braktitura që më parë kanë qenë pronë e shtetit.

Midis dy minoriteteve, atij rom dhe egjiptian, romët përbëjnë shumicën e këtyre grupeve. Edhe problemet e tyre të varfërisë, strehimit, dhe përjashtimit janë më të mprehta se ato të komunitetit egjiptian. Shumë familje perpiqen të krijojnë kushte jetese për veten e tyre, nëpërmjet aktiviteteve ekonomike informale. Disa nga anëtarët e komunitetit rom në Gjirokastrë na konfirmuan se një pjesë e mirë e të rinjve dhe fëmijëve rome, deri në vitin 2013 kanë qenë të përfshirë në përpunimin e hashashit.

Megjithëse është një fenomen i përhapur për Gjirokastrën, emigracioni nuk ka qenë asnjëherë një opsion punësimi i këtij komuniteti. Gjatë DGF, me romet ata pranuan se edhe ata individë që kanë emigruar në Greqi, kryesisht të rinj dhe fëmijë, kanë qenë të aftë vetëm të lypin në rrugë për kohë të shkurtër, dhe më pas janë kthyer në familjet që kanë lënë pas.

### 3.1 Arsimimi

Niveli arsimor i romëve të qytetit Gjirokastrë është përkeqësuar gjatë tranzicionit pas socialist. Pavarësisht faktit se ka një përmirësim në vitet '2000, në krahasim me vitet '1990, niveli i tyre i ulët arsimor dhe rritja e hendekut me popullsinë në shumicë është një nga shkaqet kryesore të papunësisë dhe varfërisë. Aktualisht 40.3% e popullsisë, 8 vjeç e sipër, janë analfabetë. 61% e familjeve rome shprehen se ndeshin vështirësi në arsimimin e fëmijëve. Prindërit romë rendisin disa shkaqe që lidhen kryesisht me varfërinë. Vështirësia për të blerë artikujt shkollorë, mungesa e rrobave të përshtatshme, kushtet e vështira të jetesës dhe mungesa e infrastrukturës, kontributi që duhet të japin në rritjen e të ardhurave të familjes, përkujdesja ndaj motrave dhe vëllezërve më të vegjël etj., janë disa nga pengesat kryesore për arsimimin e fëmijëve. Krahas tyre, ekzistojnë edhe pengesa institucionale, ashtu si dhe pengesa që lidhen me traditat dhe kulturën e romëve. Diskriminimi është gjithashtu një barrierë për arsimimin e fëmijëve.

### 3.2 Punësimi dhe të ardhurat

Sipas LSMS në 2012, qyteti i Gjirokastrës shënon më të ulët se niveli kombëtar i varfërisë prej 14.3%. Kështu varfëria në Bashki luhetet prej 8.4% në 10.7%, varësisht nga niveli i varfërisë në ish komunat. Thellësia e varfërisë është 2.2% dhe ashpërsia 0.9%.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se papunësia, të ardhurat e ulëta dhe varfëria janë shtytësit kryesorë të procesit të migrimit të brendshëm. Thuajse gjysma e romëve të kontaktuar janë të papunë dhe kjo papunësi është afatgjatë. Në mungesë të punës në sektorin formal, ata punojnë në sektorin informal, ku tregtia e rrobave të përdorura, punët e rastit, muzika, mbledhja e kanoçeve dhe lypja kanë qenë burimet kryesore të të ardhurave të tyre. Që nga viti 1991, tregtia e rrobave të përdorura, sidomos për fiset e tjera rome, që nga tradita janë tregtarë të vegjël, ka qenë burimi kryesor i të ardhurave familjare. Ndërkaq, që në vitin 2005, disa studiues paralajmëronin se "këto të ardhura janë në rënie" dhe nëse "nuk zhvillohen alternativa të qëndrueshme mirëqenia e tyre ekonomike do të jetë e rrezikuar".

Shumë familje rome, për shkak të varfërisë, mbështeten edhe në burime të tjera alternative të ardhurash si ndihma ekonomike, pensionet për të moshuarit, pagesa e papunësisë, pagesa për aftësinë e kufizuar dhe pensionet për jetimët. Nga njëra anë, këto transfera financiare nga qeveria janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat familjare. Ndërsa nga ana tjetër, shumë familje rome janë të përjashtuara nga përfitimi i asistencës shtetërore ose nga marrja e kësaj asistence për aq kohë sa është e nevojshme. Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në bashkinë e Gjirokastrës perbejne rreth 1.4 përqind të familjeve perfituese në rang vendi (viti 2016). Konsumi total për familje në këtë Bashki është 457,166 Lekë.<sup>1</sup>

**Tabela 2: Familjet rome dhe egjiptiane përfituese të ndihmës ekonomike në Gjirokaster**

| Nr. | Bashkia (Ish komuna) | Familje | Familje në NE | PAK       |
|-----|----------------------|---------|---------------|-----------|
| 1.  | Gjirokaster /Qytet   |         | 274           | 21        |
| 2.  | Cepo                 |         |               |           |
| 3.  | Lazarat              |         |               |           |
| 4.  | Picar                |         |               |           |
| 5.  | Lunxheri             |         |               |           |
| 6.  | Odrie                |         |               |           |
| 7.  | Antigone             |         |               |           |
|     | <b>Total</b>         |         | <b>274</b>    | <b>21</b> |

**Burimi:** Të dhëna administrative Bashkia Gjirokastrë -2016

### 3.3 Formimi profesional

Ekzistojnë në Gjirokastrë kurset e formimit profesional të zhvilluara nga zyrat e formimit profesional, por numri i pjesëmarrësve nga komuniteti Rom në këto kurse është pothuajse zero. Gjithashtu nuk ka program për nxitje punësimi, por ekziston specifikisht për komunitetin rom të Gjirokastrës aftësia e tyre për përdorimin shumë të mirë të thuprës në prodhimin e artikujve të ndryshëm.

<sup>1</sup> INSTAT- ABF 2016

## 4.

## POLITIKAT LOKALE PER STREHIM

Për sa i takon hapësirës së banimit, 75% e romëve në Gjirokastrë, jetojnë në shtëpi me një apo dy dhoma, me një mesatare 6.04 persona për familje<sup>2</sup>. Rreth 40% e këtyre shtëpive janë pa ujë të pijshëm brenda. Kësaj i shtohet fakti që shkalla e lartë e varfërisë lidhet negativisht me shëndetin e fëmijëve, psh sa më të mëdha të jenë familjet aq më e madhe është mundësia për kequshqyerje.

**Tabela 3: Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që janë klasifikuar për të qenë përfituese të programeve të strehimit**

| Programi   | Përshkrimi  | Numri i familjeve përfituese | Nga keto Rom/Egjiptian | Zona |
|--|---|------------------------------|------------------------|------|
| Banesat me kosto të ulët   | Ndërtim i ri  | 0                            | 0                      | na   |
| Subvencionimi i interesit të kredisë së lehtësuar                      | Kredia është dhënë nga banka private për blerjen e shtëpive në treg; interesi subvencionohet pjesërisht nga buxheti i shtetit.        | 0                            | 0                      | na   |
| Strehimi social  | Ndërtim i ri  | 0                            | 0                      | na   |
| Bonusi i strehimit (vlëra)   | Grant nga qeveria lokale për pagesën e qirasë së tregut. Grande nga qeveria qendrore për disa kategori të përcaktuara në ligjin 9232. |                              |                        |      |
| Subvencion i qirasë për banesat sociale me qira në pronësi të bashkive | Grant nga qeveria qendrore për pagesën e qirasë për personat me të ardhura të ulëta.  | 0                            | 0                      | na   |
| Zhvillimi i tokës për qëllime strehimi                                 | Zona e ndërtimit dhe shërbimet  | 0                            | 0                      | na   |
| Grante të vogla  | Përmirësimi i kushteve të banimit   | 0                            | 0                      | na   |

<sup>2</sup> Census 2011

## 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT

Në Bashkinë Gjirokastrë rezultojnë 73 familje rome që janë të pastrehë, por në Bashki asnjë familje prej tyre nuk është regjistruar si e pastrehë. Rezultojnë 40 banesa që kanë nevojë të menjëhershme për rikonstruksion. Rreth 100 familje furnizohen vetëm me dyçezma publike dhe në periudhën e verës ka probleme me furnizim e ujit të pijshëm, ndërsa kanalizime të ujërave te zeza nuk ka. Nuk ekzistojnë probleme me furnizimin e energjisë elektrike në lagjet ku jeton komuniteti rom. Në të gjitha lagjet ka instalime për furnizim me energji elektrike. Problemi kryesor qëndron në pagimin e faturës së energjisë elektrike, për arsye të shifrave të larta të faturimit dhe pamundësisë financiare për t'u paguar. Kjo, sepse pjesa më e madhe e familjeve trajtohen me ndihmë ekonomike dhe në shumicën e rasteve vlera e faturës së energjisë elektrike është më e lartë se sa vlera e ndihmës ekonomike. Një familje me 5 persona merr 5,400 lekë në muaj ndihme ekonomike ose 1,080 lekë për person në muaj (36 lekë në ditë). Ekzistojnë probleme me infrastrukturën: dy rrugë që lidhin lagjen e komunitetit Rom me rrugën kryesore rreth 800 m secila, që duhet rregulluar dhe asfaltuar, plus rrugët e brendshme (dytësore). Këtu duhen ndërtuar edhe dy ura të vogla pasi ka probleme në periudhën e dimrit. Rreth 80 familje rome kanë probleme me pronësinë e tokës ose me ndërtimet e paligjshme. Ekzistojnë 13 shtëpi të reja, si dhe 3 baraka të ndërtuar me material të fortë të cilat duhen legalizuar. Asnjë familje e këtyre komuniteteve nuk ka përfituar deri tani nga shërbimet e strehimit social.

**Tabela 4: Të dhëna të censurit për cilësinë e banesave të komunitetit rom në Gjirokastrë**


| Bashkia      | Shtëpi private (me tulla, blloqe apo beton) | Apartament në pallat | Kasolle e rrethuar me dërrasa llamarinë apo plasmas | Banese e përshtatur në një objekt të përshtatur | E shembur |
|--------------|---|----------------------|---|---|-----------|
| Gjirokastrë  | 34  | 3                    | 4   | 11  | 3         |
| <b>Total</b> | <b>34</b>                                   | <b>3</b>             | <b>4</b>  | <b>11</b>                                       | <b>3</b>  |

## 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN

**Tabela 5: Situata e familjeve te pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Gjirokastrë**

| Emërtimi zonës   | Total | Rome | %    | Egjiptiane | %  |
|--|-------|------|------|------------|----|
| Familje gjithsej   | 154   | 150  | 97%  | 4          | 3% |
| Familje në nevojë për strehim:                           | 120   | 116  | 97%  | 4          | 3% |
| Nuk zotërojnë një hapësirë për të jetuar                 | 69    | 65   | 94%  | 4          | 6% |
| Zotërojnë një hapësirë jetese nën standartet e strehimit | 51    | 51   | 100% |            | 0% |


**Figura 1: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Gjirokastrë**



**Tabela 6: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E**

| Lloji i kushteve te strehimit          | Numri      |
|--|------------|
| Jetojne ne tenda, baraka, depo         | 69         |
| Jetojne ne garsionere                  | 0          |
| Jetojne ne apartmente 1+1              | 37         |
| Jetojne ne apartmente 2+1              | 8          |
| Jetojne ne apartmente 3+1 ose me shume | 6          |
| <b>Total</b>                           | <b>120</b> |

**Figura 2: Situata aktuale e akomodimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Gjirokaster**



Për të përmiresuar kushtet e banesave të komuniteteve rome dhe egjiptiane është analizuar kosto për riparim e banesave ekzistuese, e shtesave të nevojshme të këtyre banesave. Në shumicën e rasteve banesat kanë nevojë për të dyja këto ndërhyrje. Për të përcaktuar çmimin e riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë në konsideratë lloji i ndërtimit të gjendja ekzistuese. Nderhyrja do të konsistojë në riparimin e muratave, sivatimeve, dyshemeve, terraces ose çatisë, tavanit, ndërhyrje në dyert dhe dritaret, riparim dhe zëvendësim i tyre, riparimi i nyjeve hidrosanitare. Nga përlllogaritja, çmimi i riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi ka rezultuar nga 7000-11000 lekë/m<sup>2</sup> (mesatarisht 9000 lekë/m<sup>2</sup>). Llogaritjet tregojnë se duhen 300.000 lekë/familje riparime për garsonieret, 500.000 lekë/familje për apartamentet 1+1, 600.000 lekë/familje riparime për apartamentet 2+1 dhe 800.000 lekë/familje riparime për apartamentet 3+1. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përlllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht: garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kjo analizë ka konkluduar me koston 1.200.000 lekë/familje për sipërfaqen shtesë për apartamentet 1+1, 2+1, dhe 3+1 llogaritur si prodhim i sipërfaqes të shtesës në m<sup>2</sup> me çmimin e ndërtimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, duke konsideruar sipërfaqen e nevojshme për shtesë 30-40 m<sup>2</sup>, (sipërfaqe që do të përfshijë një ambient ditë dhe një ambient ndihmes/ një ambient gjumi dhe dy ambiente ndihmese ose dy ambiente gjumi sipas secilit rast). Për garsonieret është menduar të bëhet rikonstruksioni i tyre për të zgjidhur problemet e fëmijëve të familjeve dhe jo shtesë, pasi shtesa në to nuk justifikon koston e lartë të ndërtimit si për nga sipërfaqja e madhe, ashtu edhe për gjendjen e amortizuar të garsonierëve. Banesat 3+1 kanë sipërfaqe të mjaftueshme banimi ndaj nuk është e nevojshme të ndërtohet shtesë. Më poshtë jepet tabela me llogaritjen e koston të riparimeve dhe shtesave të banesave.

## Analiza e Kostove për Rikonstruksionin

Struktura e mëposhtme është një zberthim i mënyrës së shpërndarjes së vlerës në mënyrë të shumtën e rasteve, por kjo mënyrë është variabël sipas situatës që paraqitet.

### • Ndërtim Garsoniere

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (në Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 120,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 70,000          |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 50,000          |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 30,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 30,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>300,000</b>  |

### • Ndërtim 1+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (në Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 150,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 120,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 110,000         |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 60,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 60,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>500,000</b>  |

### • Ndërtim 2+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (në Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 160,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 140,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 130,000         |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 90,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 80,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>600,000</b>  |

### • Ndërtim 3+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (në Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 170,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 200,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 200,000         |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 120,000         |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 110,000         |
| <b>Total</b> |   | <b>800,000</b>  |

Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstrukcion dhe shtesa eshte si me poshte:

Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstrukcion dhe shtesa eshte si me poshte:

- Kosto e rikonstrukcionit per garsionere = numri familjeve \* 300.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 1+1 = numri familjeve \* 1.700.000 lekë/familje (500.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 2+1 = numri familjeve \* 1.800.000 lekë/familje (600.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit per apartamente 3+1 = numri familjeve \* 800.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- **Kosto totale per rikonstrukcion + shtesë** = Kosto e rikonstrukcionit per garsionere + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (1+1) + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (2+1) + Kosto e rikonstrukcionit per apartamente (3+1)

**Tabela 7: Vlerësimi i koston per rikonstrukcion + shtesa në Bashkinë Gjirokastër**

| Tipi         | Kosto per rikonstrukcion lekë | Kosto per Shtesa lekë | Nr familjeve | Kosto lekë        |
|--------------|-------------------------------|-----------------------|--------------|-------------------|
| garsoniere   | 300,000                       | -                     | 0            | -                 |
| ap 1+1       | 500,000                       | 1,200,000             | 37           | 62,900,000        |
| ap 2+1       | 600,000                       | 1,200,000             | 8            | 14,400,000        |
| ap 3+1       | 800,000                       | -                     | 6            | 4,800,000         |
| <b>Total</b> |                               |                       | <b>51</b>    | <b>82,100,000</b> |

**Tabela 8: Aksesi per uje, kanalizime dhe furnizim me energji elektrike I komunitetit R/E ne Bashkine Gjirokastër**

| Punë ne infrastrukturën inxhinierike (Për secilën zonë) | Gjatesia në metra |
|---|-------------------|
| Rrjeti i furnizimit me ujë                              | 400               |
| Rrjeti i kanalizimeve                                   | 0                 |
| Rrjeti i furnizimit me energji elektrike                | 1000              |
| Rruge   | 1300              |

Ne estimimin qe eshte bere per infrastrukturën ne keto zona eshte parashikuar permiresimi i rrjetit infrastrukturor per te gjithë komunitetin (zonen), pra ky rrjet do ti sherbeje dhe atyre familjeve qe nuk kane nevojë per permiresim te kushteve. Vlerësimi i koston për investimin në infrastrukturë është llogaritur si prodhim i gjatësisë në metra te infrastukturës primare të nevojitur, me çmimin për metër linear për secilin zë. Çmimi eshte percaktuar si mesatare e të njejtit zë në projekte të mëparshme. Zërat e përfshirë në infrastrukturën primare, për te cilët janë marrë të dhëna nga bashkitë përkatëse janë : gjatësia e rrugëve, çmimi për metër linear i llogaritur përafërsisht 30000 lekë/ml (gjerësia e rruges merret 5m si rrjedhoje 1 meter linear gjatesi=5 m<sup>2</sup> sipërfaqe), gjatësia e rrjetit të furnizimit me ujë\_çmimi 6000 lekë/ml, gjatësia e rrjetit të kanalizimeve, çmimi 8000 lekë/ml dhe gjatësia e rrjetit të furnizimit me energji elektrike, çmimi 4000 lekë/ml. Në rastet kur vlera e zërave te infrastrukturës është 0, si rrjedhojë dhe kosto përkatëse është 0 lekë, tregon se për zërin në fjalë nuk ka nevojë për investim.

Formula e perdorur per vleresimin e koston per infrastrukturën eshte si me poshte:

- Kosto per rrjetin e furnizimit me uje = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per rrjetin e kanalizimeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per furnizimin me energji elektrike = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per ndertimin e rrugeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- **Kosto per infrastrukturën** = Kosto per rrjetin e furnizimit me uje + Kosto per rrjetin e kanalizimeve + Kosto per furnizimin me energji elektrike + Kosto per ndertimin e rrugeve

**Tabela 9: Vlerësimi i koston per infrastrukturën në Bashkinë Gjirokastër**

| Tipi         | lekë/ ml | Gjatesia në metra | Kosto lekë        |
|--------------|----------|-------------------|-------------------|
| Rrugë        | 30,000   | 1,300             | 39,000,000        |
| Ujë          | 6,000    | 400               | 2,400,000         |
| Elektrike    | 4,000    | 1,000             | 4,000,000         |
| Kanalizime   | 8,000    | -                 | -                 |
| <b>Total</b> |          |                   | <b>45,400,000</b> |

Nevojat për ndërtime të reja perfshin ata që banojnë në kasolle si edhe në banesa që nuk kanë siguri për jetën si: tenda, baraka, depo. Sipas kriterëve dhe normativave të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr 824 datë 3.12.2004 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" është berë dhe vlerësimi i koston për keto ndërtime. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht : garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kosto e ndërtimit për 1 m2 sipërfaqe banimi, është marrë për çdo qytet nga manuali i qeverisë në qershor 2015: "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit te banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015". Më poshtë jepen formulat e llogaritjes të koston të ndërtimeve të reja dhe tabela përkatëse me rezultatet.

**Tabela 10: Kerkesa e komunitetit R/E per strehim, ne Bashkine Gjirokastër**

| Lloji i Strehimit  | Nevoja per studim komuniteti Rom | Nevoja per studim komuniteti Egjiptian |
|--|----------------------------------|--|
| Numri i familjeve qe u nevojiten garsoniere                                      | 0                                | 0                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 1+1                                 | 20                               |  |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 2+1                                 | 44                               | 4                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 deri ne 75,5 m <sup>2</sup>     | 5                                |  |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 me shume se 75,5 m <sup>2</sup> |                                  |  |
| <b>Numri total i familjeve</b>   | <b>69</b>                        | <b>4</b>                               |



Formulat e perdorura per vleresimin e koston per ndertime te reja jane si me poshte:

- Kosto e ndertimeve te reja, garsoniere = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per garsoniere e caktuar 35 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndertimeve te reja, apartamente 1+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 1+1 e caktuar 55 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndertimeve te reja, apartamente 2+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 2+1 e caktuar 67 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndertimeve te reja, apartamente 3+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 3+1 e caktuar 75.5 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- **Kosto totale per ndertime te reja** = Kosto e ndertimeve te reja, garsoniere + Kosto e ndertimeve te reja, apartamente (1+1) + Kosto e ndertimeve te reja, apartamente (2+1) + Kosto e ndertimeve te reja, apartamente (3+1) = Shuma gjithsej

**Tabela 11: Vlerësimi i koston per ndertime të reja në Bashkinë Gjirokastrë**

| Tipi         | lekë/ m <sup>2</sup> | Siperfaqe m <sup>2</sup> | Nr familjeve | Kosto lekë         |
|--------------|----------------------|--------------------------|--------------|--------------------|
| garsoniere   | 32,616               | 35                       | 0            | -                  |
| ap 1+1       | 32,616               | 55                       | 20           | 35,877,600         |
| ap 2+1       | 32,616               | 67                       | 44           | 96,151,968         |
| ap 3+1       | 32,616               | 75.5                     | 5            | 12,312,540         |
| <b>Total</b> |                      |                          | <b>69</b>    | <b>144,342,108</b> |

**Kosto Total në Bashkinë Gjirokastrë - 271,842,108**

Duke u nisur nga situata konkrete dhe nga informacioni qe morem nga Bashkia, menyra qe i pershtatet me shume realitetit, sipas analizes tone, eshte ndertimi i banesave me kosto te ulet, kjo e kombinuar dhe me rikonstruksin dhe me ndertimin e shtesave per banesat ekzistuese. Ndertimi i banesave me kosto te ulet, parashikohet te behet ne hapesirat e lira te zonave ne te cilat keto komunitete jetojne aktualisht. Per shkak te mungeses te informacionit ne lidhje me komunitetin Egjiptian per kerkesa per banesa sociale, eshte menduar qe ne qofte se nga bashkite do te investohet ne kete drejtim, fondi qe do parashikohet per ata familje qe do perfitojne nga banesat sociale, do te zbritet nga fondi qe eshte parashikuar ne kete studim.

Kjo analizë konkludon disa skenarë të rradhitur më poshtë:

► **Skenari 1**

**Rikonstrukcioni dhe shtesa për banesat ekzistuese.**

Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk i plotësojnë kushtet e jetesës. Ato mund të kenë nevojë për:

- Rikonstrukcion të banesave ekzistuese
- Rikonstrukcion + Shtesa në ndërtesat ekzistuese

Familjet që bëjnë pjesë në këtë grup, kanë nevojë për shtesë ambjentesh.

► **Skenari 2**

**Ndërtime të reja.**

Eshte menduar qe permiresimi i kushteve te ketyre familjeve, nisur nga menyra e jeteses qe ato kane, te behet ne hapesirat e zonave ku ata jetojne aktualisht. Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk plotësojnë kushtet minimale të jetesës. Në këtë rast propozohet të bëhen ndërtime të reja për të cilat janë evidentuar sipërfaqet përkatëse për secilin tip apartamenti (garsoniere, apartamente 1+1, 2+1 ose 3+1).

**Punime plotësuese me investime në infrastrukturën primare.**

Përveç punimeve në banesat vetjake të secilës familje është parashikuar nevoja edhe për punime në infrastrukturën primare në ndihmë të familjeve Rome apo Egjiptiane.

Këto punime konsistojnë në katër grupe të mëdha:

1. Punime mirëmbajtjeje dhe ndertimit të rrugëve
2. Ndërtim kanalizimesh për ujërat e zeza dhe përmirësimi i pusetave ekzistuese,
3. Ndërtim si dhe riparim i degëzimeve të ujësjellësit. Për të gjitha këto punime janë parashikuar kostot më lart.
4. Shtim i gjatësisë të rrjetit elektrik.

## 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

21,287 familje, 19,688 në pronësi ose në proces pronësimi, 1,022 me qira, 577 jetojnë falas. Një banesë në qarkun e Gjirokastrës ka mesatarisht 2.9 dhoma.

404 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 945 janë me furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 21,287 banesa të banuara) ose rreth 6.38 përqind nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm. Rreth 1,421 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër nga 21,287 banesa të banuara) ose 6.7 përqind.

**Pajisja e vendeve të zgjedhura me shërbime të përshtatshme komunale.** Kjo ka të bëjë kryesisht me sigurimin e ujit të pastër dhe mjediseve higjienike dhe sanitare, duke pasur parasysh numrin e madh të anëtarëve të komunitetit rom që jetojnë në baraka, si dhe lëvizshmërinë e tyre të shpeshtë dhe mungesën e infrastrukturës në zonat ku jetojnë.

- ▶ Në bashkinë e Gjirokastrës kushtëzohet lëshimi i dokumenteve zyrtare (certifikatat e banimit familjar, certifikatat familjare, etj.) me pagimin e taksave vendore. Megjithatë kjo praktikë nuk është e mbështetur në ligj, ajo vazhdon të aplikohet. Si rrjedhojë, shumë familje të varfra, shumica rome dhe egjiptiane (që nuk përjashtohen nga taksat vendore, sepse nuk bëjnë pjesë në listat e përfituesve të ndihmës sociale), penalizohen duke mos mundur të tërheqin dokumentacionin e kërkuar.
- ▶ Nuk ka procedura specifike përmbështetjen e familjeve rome dhe egjiptiane të pastreha që të regjistrohen pranë Bashkisë Gjirokastrë. Kërkohej përshtatje e kriterëve për strehim social, transferim vendbanimi dhe dhënia e ndihmës ligjore nga shteti, duke pasur parasysh gjendjen e shumicës së familjeve rome dhe egjiptiane që punojnë në sektorët informalë dhe nuk mund të verifikojnë të ardhurat e tyre, jetojnë në baraka dhe nuk kanë kontratë qiraje ose certifikatë pronësie për banesën e tyre, ose kanë nevojë për ndihmë administrative dhe ligjore për të pasur qasje në të drejtat e tyre bazë.
- ▶ Mungesa e një strategjie të strehimit social për bashkinë dhe territorin e ri të saj.
- ▶ Në buxhetin vjetor të bashkisë (përjashtuar viti 2016) nuk ka fonde të parashikuara për strehim, si një zë i veçantë.
- ▶ Nuk ka studime (qoftë edhe pjesore) mbi infrastrukturën e vendbanimeve rome dhe egjiptiane
- ▶ Në data bazën e krijuar për familjet aplikuese për strehim social, nuk ka informacion dhe analiza të thelluara për situatën e strehimit të familjeve rome dhe egjiptiane.
- ▶ Në kushtet kur, një pjesë e mirë e familjeve rome dhe egjiptiane nuk kanë njohuri mbi të drejtat e tyre për strehim dhe informacionin e nevojshëm për menyrën e aplikimit për strehim social, mbetet detyrë e bashkisë të informojë këtë komunitet mbi skemat sociale të strehimit.
- ▶ Romët dhe egjiptianët nuk kanë qasje në informacion dhe ndihmë të specializuar, persa i përket legalizimit të shtëpive të tyre. Në këtë mënyrë ata rrezikojnë të humbin mundësinë të bëhen pronarë, si dhe rrezikojnë të nxirren në rrugë nga ndërtues dhe zhvillues të pronave të patundura, të cilët janë më të informuar dhe më të shkathët.

- ▶ Informacioni i pamjaftueshëm për shkak të përjashtimit social të këtij grupi të popullatës.
- ▶ Shpesh familjet rome që jetojnë në banesa me qera, nuk e disponojnë aktin e qiramarrjes/dokumentit të pronësisë, gjë që e bën të pamundur të vërtetohet rezidenca/adresa e familjes rome ose egjiptiane. Një dokument alternativ do të ishte një certifikatë e lëshuar nga bashkia e Gjirokastrës, që mund të sigurojë dhënie të një adrese në mënyrë që të mundësohet identifikimi i familjes.

# ANEKSI

## *Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Gjirokastrër*





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË DELVINË**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Mars 2017



*Missioners of Social Rights*



## Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Delvinë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Klodioda Sh.p.k. dhe Organizata “Misionarët për të Drejtat Sociale” në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Mars 2017



## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME  | 4  |
| 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian           |    |
| 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI   | 5  |
| 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit                              |    |
| 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË DELVINË             | 6  |
| 3.1 Arsimimi   |    |
| 3.2 Punësimi dhe të ardhurat   |    |
| 3.3 Formimi profesional  |    |
| 4. POLITIKAT LOKALE PER STREHIM  | 9  |
| 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT | 10 |
| 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN              | 11 |
| 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE  | 18 |
| ANEKSI   | 19 |
| Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Delvinë                          |    |

# 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Bashkia e Delvinës përbëhet nga 2 njësi administrative, qyteti i Delvies dhe ish komuna Vergo, kufizohet në veri me bashkitë Himarë e Gjirokastër, në jug me bashkitë Sarandë dhe Finiq, ndërsa në lindje me bashkinë Dropull. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Delvinës.

Kjo bashki përbëhet nga 2 njësi administrative, të cilat janë: Delvinë dhe Vergo. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Delvinës dhe qarkut Vlorë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 17 fshatra.

Bashkia ka shumë përparësi në shtrirjen e saj gjeografike jo vetëm për faktin se ndodhet në brezin kufitar me Greqinë, por edhe sepse nepermjet afersise me qytetin e Sarandes akseson rruget detare.



Delvina është shembulli më i mirë ku pasurite natyrore, që rrallë herë mund të takosh në rajone të tjera në një masë dhe me një diversitet të tillë, nuk janë të perkthyer në burime të zhvillimit ekonomik të zones. Vecanerisht realiteti i burimeve dhe potencialeve ekonomike nuk përputhet me situatën ekonomike të disa grupeve të vecanta sic janë romet dhe egjiptianet që jetojnë në territorin e bashkisë.

## 1.1 Planet vendore të përfshirjes sociale të komunitetit rom dhe egjiptian

Në mars të vitit 2016, në kuadrin e projektit STAR, Bashkia e Delvines ka hartuar Planin Operacional i Zhvillimit Lokal, i cili është një Plan 3 vjeçar afatmesën që rishikohet çdo vit në varësi të burimeve financiare që bashkia Delvinë ka në dispozicion dhe ka si qëllim identifikimin dhe prioritarizimin e investimeve që bashkia angazhohet të realizojë. Cdo investim të parashikuar, dhe i përfshirë në plan, është identifikuar si një prioritet i qytetarëve gjatë një procesi pjesëmarrës që ka zhvilluar bashkia për të përcaktuar këto nevoja dhe prioritetet.

Megjithatë POZHL, është parë si një instrument i rëndësishëm i menaxhimit financiar i cili siguron dhe jep një tablo të qartë të nevojave prioritare të qytetarëve dhe mundësive të Bashkisë për të financuar ato, në plan nuk është parashikuar asnjë nderhyrje për përmirësimin e kushteve të banimit të romëve dhe egjiptianëve që jetojnë në këto qytete. Por edhe pse nuk është e përfshirë Planin 3 vjeçar, bashkia e Delvines ka identifikuar disa objekte (ish shkollën e mesme bujqësore dhe konviktet e kësaj shkolle, ndërtesat e ushtrisë në Rusan dhe Bajkaj), për të rehabilituar dhe për të përdorur me destinacion "banesa sociale"<sup>1</sup>. Aktualisht kjo ndërtesë është nën administrimin e Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferrimit të Pronave Publike pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

<sup>1</sup> Shkresë e Bashkisë Delvine, nr.Prot. 2489 date 02/11/2016 drejtuar MZHETTS

## 2. DEMOGRAFIA DHE URBANIZIMI

### 2.1 Romët dhe egjiptianet pjesë e përjashtuar e qytetit

Sipas INSTAT 2011 (rregjistrimit të Censurit), në Bashkinë e Delvines, është regjistruar një popullsi prej 7,598 banorësh. Në njesinë administrative të Delvinës 5,754 banorë, dhe në njesinë administrative Vergo 1,844 banorë. Këto shifra paraqiten konsiderueshëm më të ulta (rreth 60% më pak) referuar të dhënave të Regjistrimit të Gjendjes Civile, sipas të cilit në Janar 2015 popullsia e Delvines rezultoi 14,400 dhe e njesisë administrative Vergo rezultoi 4,100 banorë. Kjo diferencë që vjen kryesisht për shkak të metodologjisë së matjes aplikuar nga regjistri i gjendjes civile dhe Censuri është pasojë edhe e faktit që në Delvine ka patur lëvizjet masive të popullsisë drejt vendeve të tjera të rajonit sidomos Greqisë. Në këtë mënyrë një pjesë e konsiderueshme e popullsisë nuk është gjendur në banesë në ditën e regjistrimit. Densiteti i popullsisë sipas censurit është 45.5 banorë/km<sup>2</sup>, ndërsa sipas regjistrimit civil është 99 banorë/km<sup>2</sup>.

Përsa i përket popullsisë romë dhe egjiptiane, në Delvine nuk mund të identifikojmë shifra të sakta për vlerime të grupit të eksperteve tregojnë se kjo pjesë e popullsisë është në masën 3.6% të numrit total të popullsisë.

**Tabela 1: Numri i familjeve romë dhe egjiptiane sipas vendbanimeve në Bashkinë e Delvinës**

| Nr. | Bashkia (Ish komuna) | Popullsia     | Popullsia Romë dhe Egjiptiane | Nr i familjeve romë dhe egjiptiane |
|-----|----------------------|---------------|-------------------------------|------------------------------------|
| 1.  | Delvine/Qytet        | 14,400        | 720                           | 141                                |
| 2.  | Vergo                | 4,100         | 0                             | 0                                  |
|     | <b>Total</b>         | <b>18,500</b> | <b>720</b>                    | <b>141</b>                         |

Burimi i të dhënave: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritjet e autorëve

Në Bashkinë e Delvines jetojnë aktualisht 78 familje romë dhe 63 familje egjiptiane në total, 141 familje ose 720 persona kundrejt 18,500 banorëve që ka në total qyteti. Gjithashtu nga të dhënat rezultojnë se janë rreth 20 familje të tjera që aktualisht nuk ndodhen në Delvine ose ndodhen jashtë vendit në emigrim për arsye të ndryshme ekonomike – sociale.

Komuniteti etno-kulturor i egjiptianëve jeton i integruar me pjesën tjetër të popullsisë dhe është e vendosur në qytet. Në Delvinë përgjithësisht kjo pakicë etnike e popullsisë është e vendosur pothuajse në masën më të madhe në lagjen "Papuçi", pak në Rusan dhe në bllokun Çorro. Në zonat rurale këto pakica pothuajse janë inekzistente. Përsa i përket romëve ky grup është i vendosur në periferi të qytetit në fshatin Bmatat dhe karakterizohet nga mobiliteti. Një numër shumë i kufizuar familjesh janë të vendosura në konvikte dhe shkollë bujqësore, ku kanë zënë hapsira për banim.

## 3. TË DHËNA SOCIAL EKONOMIKE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN NË DELVINË

Bashkia e Delvinës ka indeksin e varfërisë 8.58% sipas të dhënave të Bankës Botërore. Duhet theksuar se në bashkinë e Delvines, nuk gjetem asnjë dokument që analizon situatën sociale dhe ekonomike të romëve dhe egjiptianëve, por nga diskutimet me stafin teknik të bashkisë u informuam se megjithëse numri i popullsisë romë dhe egjiptianëve është shumë i ulët krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë, problemet sociale dhe ekonomike të tyre janë shumë të mëdha.

Varfëria e pjesëtarëve të komunitetit romë dhe egjiptian është shumëdimensionale dhe e vazhdueshme. Romët dhe egjiptianët në qytetin e Delvinës vuajnë nga të ardhura të pakta dhe kushte të këqija jetese, nuk kanë akses në shërbimet publike si kujdes mjekësor dhe arsimim, në tregun e punës, në regjistrimin civil dhe siguri. Mungesa e strehimit dhe uji të pijshëm konsiderohet problemi më i madh pas ushqimit. Romët strehohen në shtëpi të mbipopulluara ku mungojnë kushtet elementare si kanalizimet dhe uji i pijshëm. Në zonat ku janë përqendruar romët, familjet jetojnë në kasolle ose në ndërtesa të braktitura që më parë kanë qenë pronë e shtetit.

### 3.1 Arsimimi

Struktura moshore e popullsisë karakterizohet nga tregues të ulët të forcës aktive të punës dhe të moshës së re. Ndërsa, treguesi i moshës së tretë është i lartë. Këto tregues flasin për plakje të popullsisë, dhe shpjegohet me fenomenin e emigrimit të popullsisë në drejtim të Greqisë dhe Italisë. Ky fenomen ka prekur shumë rininë dhe forcën më aktive të punësimit. Këto tregues të ulët të forcës aktive ndikojnë negativisht në zhvillimin ekonomik, sidomos të sektorit të bujqësisë.

### 3.2 Punësimi dhe të ardhurat

Niveli i papunësisë në Bashkinë e Delvines është rreth 18%, një tregues më i lartë se mesatarja e vendit. Numri i të papunëve të regjistruar si punëkerkues të papunë është rreth 500 persona, shifer që nuk e justifikon nivelin e papunësisë në Bashki. Numri i bizneseve të regjistruara në territorin e bashkisë së Delvines është 270 biznese (jo-bujqësore). Të ardhurat sipas INSTAT janë nga më të ultat në vend, rreth 4,600 leke për familje. Këto tregues flasin për nivel shumë të ulët ekonomik. Nga ana tjetër treguesit demografik tregojnë për një moshe mesatare mbi mesataren e vendit, gjë që tregon për plakje të popullatës në këtë zonë. Ky fenomen ka prekur shumë rininë dhe forcën më aktive të punësimit. Këto tregues të ulët të forcës aktive ndikojnë negativisht në zhvillimin ekonomik, sidomos në sektorin e bujqësisë.

Romët dhe egjiptianët japin disa shkaqe lidhur me nivelin e lartë të papunësisë së tyre. Sipas tyre këto shkaqe lidhen kryesisht me 'mungesën e mundësive të punësimit për të gjithë' në qytetin e Delvines, 'nivelin e ulët arsimor' dhe etnicitetin. Megjithatë shkallen e lartë të papunësisë, romët dhe egjiptianët nuk preferojnë të gjejnë punë nepermjet zyrave të punës. Ata pranojnë

se paragjykohen dhe mund të gjejnë punë vetëm nëpërmjet të njohurve ose në rrethin e tyre familjar.

Para viteve 90-të në Delvinë kanë ekzistuar disa nga ndërmarrjet më të mëdha të artizanatit ku punonin qindra artizanë, si rrobaqepës, këpucarë, kovaçë, teneqepunues, samarxhi etj. Minoriteti rom dhe egjiptian kanë livruar pikerisht artizanatin si aktivitet kryesor ekonomik. Aktualisht minoriteti rom është i anagazhuar në aktivitetin e shitjes së rrobave të përdorura si dhe në punë sezonale që lidhen me përpunimin e kashtës dhe xunkthit. Egjiptianet kanë një profil tjetër të aktivitetit të tyre ekonomik, në një masë të madhe familjet egjiptiane janë të angazhuara në prodhimin e qymyrit dhe shitjen e tij në Greqi. Megjithatë gjatë DGF përfaqësuesit e komunitetit egjiptian pranuan se ky burim të ardhurash ka ardhur duke u ngushtuar për shkak të klasifikimit të këtij aktiviteti si një aktivitet i paligjshëm.

Megjithatë Delvina ka një profil të theksuar blegtoral e bujqësor, familjet rom dhe egjiptiane nuk janë të përfshira në këto aktivitet ekonomik.

Numri i familjeve që trajtohet me ndihmë ekonomike është shumë i lartë krahasuar me pjesën tjetër të popullatës që jeton në qytet. Kjo për faktin se niveli i papunësisë së komunitetit rom dhe egjiptian është i lartë. Të ardhurat e siguruar nga ndihma ekonomike janë shumë të ulta dhe nuk sigurojnë nevojat bazike të familjes. Por krahas atyre që përfitojnë, ka familje që nuk mund të përfitojnë për shkak se janë vendosur në Delvinë pas vitit 1990, megjithatë ata jetojnë në kushte ekstremisht të keqja.

Nga ana tjetër, komuniteti rom në Delvinë ka shqetësimet e veta. Ata ankohen për faktin se nuk u ofrohet qëllimisht ndihmë ekonomike dhe për këtë fakt ndihen të diskriminuar. Madje gjatë DG, përfaqësuesit e komunitetit rom dhe egjiptian thonë se përveçse ky komunitet është i diskriminuar dhe nuk përfiton nga shërbimet publike, edhe veprimtaria e organizatave jo-qeveritare apo donatore është pothuaj inekzistente.

**Tabela 2: Familjet rom dhe egjiptiane përfituese të ndihmës ekonomike në Delvinë**

| Nr. | Bashkia (Ish komuna) | Familje    | Familje në NE | PAK       |
|-----|----------------------|------------|---------------|-----------|
| 1.  | Delvine/Qytet        | 141        | 38            | 96        |
| 2.  | Vergo                | 0          | 0             | 0         |
|     | <b>Total</b>         | <b>141</b> | <b>38</b>     | <b>96</b> |

Burimi: Te dhëna administrative Bashkia Delvines 2016

### 3.3 Formimi profesional

Në Delvine, me gjithë programet për nxitje punësimit zbatuar nga zyra e punës, vetëm 10 të rinj rom kanë përfituar nga këto programe. Për 10 përket formimit profesional, përveçse disa kurseve të ofruara nga operatore private dhe organizata të shoqërisë civile, qendrat e formimit profesional publike kanë mbështetur një numër shumë të kufizuar romesh për të marrë kurse dhe fituar një profesion.

## 4.

## POLITIKAT LOKALE PËR STREHIM

Për sa i takon hapësirës së banimit, 95% e romëve dhe egjiptianeve jetojnë në kushte të veshitura dhe banesa të papërshtatshme. Në Delvine, romet jetojnë në shtëpi me një apo dy dhoma, me një mesatare 6.6 persona për familje<sup>2</sup>. Rreth 80% e këtyre shtëpive janë pa ujë të pijshëm brenda<sup>3</sup>. Kësaj i shtohet fakti që shkalla e lartë e varfërisë lidhet negativisht me shëndetin e fëmijëve, psh sa më të mëdha të jenë familjet aq më e madhe është mundësia për kequshqyerje.

Megjithatë gjatë viteve 2014-2016, 4 familje rom dhe egjiptiane, janë klasifikuar si familje të pastreha, ato nuk kanë përfituar nga asnjë prej skemave të strehimit social, megjithatë punonjësit e bashkisë pranojnë që sistemi i pikezimit funksionon në Bashki.

**Tabela 3: Numri i familjeve rom dhe egjiptiane që janë klasifikuar për të qenë përfituese të programeve të strehimit**

| Programi   | Përshkrimi   | Nr. i familjeve përfituese | Nga keto Rom/Egjiptian | Zona |
|--|--|----------------------------|------------------------|------|
| Banesat me kosto të ulët   | Ndërtim i ri   | 0                          | 0                      | na   |
| Subvencionimi i interesit të kredisë së lehtësuar                      | Kredia është dhënë nga banka private për blerjen e shtëpive në treg; interesi subvencionohet pjesërisht nga buxheti i shtetit.       | 0                          | 0                      | na   |
| Strehimi social  | Ndërtim i ri   | 0                          | 0                      | na   |
| Bonusi i strehimit (vlëra)   | Grant nga qeveria lokale për pagesën e qirasë së tregut. Grant nga qeveria qendrore për disa kategori të përcaktuara në ligjin 9232. |                            |                        |      |
| Subvencion i qirasë për banesat sociale me qira në pronësi të bashkisë | Grant nga qeveria qendrore për pagesën e qirasë për personat me të ardhura të ulëta.   | 0                          | 0                      | na   |
| Zhvillimi i tokës për qëllime strehimi                                 | Zona e ndërtimit dhe shërbimet   | 0                          | 0                      | na   |
| Grante të vogla  | Përmirësimi i kushteve të banimit  | 0                          | 0                      | na   |

<sup>2</sup> Census 2011

<sup>3</sup> Furnizimi me ujë të pijshëm është një problem akut për të gjithë qytetin, në këto kuader edhe romet dhe egjiptianet vuajnë mungesën e ujit të pijshëm në banesat e tyre



## 5. KUSHTET E STREHIMIT TE KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN DHE INFRASTRUKTURA E BANIMIT

Komuniteti egjiptian ne bashkine e Delvines jeton ne qytet dhe eshte i integruar ne disa lagje te qytetit.

Problemi kryesor i bashkisë së re Delvinë, me 18,500 banorë, mbetet uji i pijshëm. Zbatimi i një projekti që është gati tashmë do të zgjidhë problemin e ujit nga burimi i Vrizit për banorët e Delvinës që kanë 3 vjet me mungesë të ujit. Ndërtimi një rrjeti furnizimi me vetërrjedhje nga lumi i Kalasë, që buron nga Tatzati, fshat malor i bashkisë së re, zgjidhet problemi për të gjithë familjet, nder te cilat edhe ato rome dhe egjiptiane. Ndertimi i linjes se ujesjelles-kanalizimeve te rruges “Maliq Metushi”, prane bllokut Çorro, ku jetojne ne mazhorance komuniteti egjiptian dhe ai I fshatit Bamatat ku jeton komuniteti rom, jane vendosur si priorite te Bashkise se Delvines, projektet e te cilave jane derguar per financim ne Ministrine e Transportit dhe Infrastruktures.

**Tabela 4: Të dhëna të censurit për cilësinë e banesave e komunitetit rom në Delvinë**

| Bashkia      | Shtëpi private (me tulla, blloqe apo beton) | Apartament në pallat | Kasolle e rrethuar me dërrasa llamarinë apo plasmas | Banese e përshtatur në një objekt të përshtatur | E shembur |
|--------------|---|----------------------|---|---|-----------|
| Delvine      | 35  | 17                   | 5   | 3   | 0         |
| <b>Total</b> | <b>35</b>                                   | <b>17</b>            | <b>5</b>  | <b>3</b>  | <b>0</b>  |


## 6. PROPOZIMET PËR ADRESIMIN E NEVOJAVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN

Vëmendja e bashkise ndaj minoritetit rom dhe egjiptian eshte perqendruar vetem ne trajtimin e tyre me ndihmë ekonomike, me investimet në afërsi të banesave të tyre, dhe mbështetjen e projekteve për arsimim në bashkëpunim me fondacionin Lidia.

**Tabela 5: Situata e familjeve te pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkine Delvinë**

| Emërtimi zonës   | Total | Rome | %   | Egjiptiane | %   |
|--|-------|------|-----|------------|-----|
| Familje gjithsej   | 141   | 78   | 55% | 63         | 45% |
| Familje në nevojë për strehim:                           | 97    | 62   | 64% | 35         | 36% |
| Nuk zotërojnë një hapësirë për të jetuar                 | 5     | 3    | 60% | 2          | 40% |
| Zoterojnë një hapësirë jetese nën standartet e strehimit | 92    | 59   | 64% | 33         | 36% |


**Figura 1: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E në Bashkinë Delvinë**



**Tabela 6: Situata aktuale e strehimit të familjeve të Komuniteteve R/E**

| Lloji i kushteve te strehimit          | Numri      |
|--|------------|
| Jetojne ne tenda, baraka, depo         | 5          |
| Jetojne ne garsionere                  | 56         |
| Jetojne ne apartmente 1+1              | 31         |
| Jetojne ne apartmente 2+1              | 30         |
| Jetojne ne apartmente 3+1 ose me shume | 19         |
| <b>Total</b>                           | <b>141</b> |

**Figura 2: Situata aktuale e akomodimit te familjeve te komuniteteve R/E ne Bashkine Delvine**



Përmirësimi i cilësisë së strehimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian është një nevojë urgjente dhe duhet parë në kuadrin e politikave të strehimit në përgjithësi, që në të njëjtën kohë përpunohen me objektivat e politikave ekonomike dhe kontribuojnë në forcimin e politikave sociale. Këto politika të strehimit duhet të zhvillohen brenda një kuadri të përgjithshëm legjislativ, që propozojnë masa konkrete për të mbështetur financimin nëpërmjet planeve dhe politikave të qeverisë mbi strehimin.

Për të përmirësuar kushtet e banesave të komuniteteve romë dhe egjiptiane është analizuar kosto për riparim e banesave ekzistuese, e shtesave të nevojshme të këtyre banesave. Në shumicën e rasteve banesat kanë nevojë për të dyja këto ndërhyrje. Për të përcaktuar çmimin e riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë në konsideratë lloji i ndërtimeve të gjendja ekzistuese. Nderhyrja do të konsistojë në riparimin e muratave, sivatimeve, dyshemve, terraces ose çatisë, tavanit, ndërhyrje në dyert dhe dritaret, riparim dhe zëvendësim i tyre, riparimi i nyjeve hidrosanitare. Nga përllogaritja, çmimi i riparimeve për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi ka rezultuar nga 7000-11000 lekë/m<sup>2</sup> (mesatarisht 9000 lekë/m<sup>2</sup>). Llogaritjet tregojnë që duhen 300.000 lekë/familje riparime për garsonieret, 500.000 lekë/familje për apartamentet 1+1, 600.000 lekë/familje riparime për apartamentet 2+1 dhe 800.000 lekë/familje riparime për apartamentet 3+1. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht: garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kjo analizë ka konkluduar me koston 1.200.000 lekë/familje për sipërfaqen shtesë për apartamentet 1+1, 2+1, dhe 3+1 llogaritur si prodhim i sipërfaqes të shtesës në m<sup>2</sup> me çmimin e ndërtimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, duke konsideruar sipërfaqen e nevojshme për shtesë 30-40 m<sup>2</sup>, (sipërfaqe që do të përfshijë një ambient dite dhe një ambient ndihmesë/ një ambient gjumi dhe dy ambiente ndihmesë ose dy ambiente gjumi sipas secilit rast). Për garsonieret është menduar të bëhet rikonstruksioni i tyre për të zgjidhur problemet e fëmijëve të familjeve dhe jo shtesë, pasi shtesa në to nuk justifikon koston e lartë të ndërtimit si për nga sipërfaqja e madhe, ashtu edhe për gjendjen e amortizuar të garsonierëve. Banesat 3+1 kanë sipërfaqe të mjaftueshme banimi ndaj nuk është e nevojshme të ndërtohet shtesë. Më poshtë jepet tabela me llogaritjen e koston të riparimeve dhe shtesave të banesave.

## Analiza e Kostove per Rikonstruksionin

Struktura e mëposhtme është një zberthim i mënyrës së shpërndarjes së vlerës në mënyrë të shumtën e rasteve, por kjo mënyrë është variabël sipas situatës që paraqitet.

### • Ndërtim Garsoniere

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 120,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 70,000          |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 50,000          |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 30,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 30,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>300,000</b>  |

### • Ndërtim 1+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 150,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 120,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 110,000         |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 60,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 60,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>500,000</b>  |

### • Ndërtim 2+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 160,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 140,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 130,000         |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 90,000          |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 80,000          |
| <b>Total</b> |   | <b>600,000</b>  |

### • Ndërtim 3+1

| Nr.          | Emertimi punimit  | Vlera (ne Lekë) |
|--------------|---|-----------------|
| 1            | Rikonstruksion WC   | 170,000         |
| 2            | Rikonstruksion Suva dhe Mure                                      | 200,000         |
| 3            | Rikonstruksion DysHEME dhe Cati                                   | 200,000         |
| 4            | Rparim /zëvendësim Dyer /Dritare                                  | 120,000         |
| 5            | Rikonstruksion Rrjeti inxhinierik dhe lidhja me rrjetin e jashtëm | 110,000         |
| <b>Total</b> |   | <b>800,000</b>  |

Formula e perdorur per vleresimin e koston per rikonstrukcion dhe shtesa eshte si me poshte:

- Kosto e rikonstrukcionit per garsoniere = numri familjeve \* 300.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 1+1 = numri familjeve \* 1.700.000 lekë/familje (500.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente 2+1 = numri familjeve \* 1.800.000 lekë/familje (600.000 lekë/familje rikonstrukcion + 1.200.000 lekë/familje shtesë) = Shuma gjithsej
- Kosto e rikonstrukcionit per apartamente 3+1 = numri familjeve \* 800.000 lekë/familje rikonstrukcion = Shuma gjithsej
- **Kosto totale per rikonstrukcion + shtesë** = Kosto e rikonstrukcionit per garsoniere + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (1+1) + Kosto e rikonstrukcionit + shtesë per apartamente (2+1) + Kosto e rikonstrukcionit per apartamente (3+1)

**Tabela 7: Vlerësimi i koston per rikonstrukcion + shtesa në Bashkinë Delvinë**

| Tipi         | Kosto per rikonstrukcion lekë | Kosto per Shtesa lekë | Nr familjeve | Kosto lekë         |
|--------------|-------------------------------|-----------------------|--------------|--------------------|
| garsoniere   | 300,000                       | -                     | 15           | 4,500,000          |
| ap 1+1       | 500,000                       | 1,200,000             | 26           | 44,200,000         |
| ap 2+1       | 600,000                       | 1,200,000             | 27           | 48,600,000         |
| ap 3+1       | 800,000                       | -                     | 24           | 19,200,000         |
| <b>Total</b> |                               |                       | <b>92</b>    | <b>116,500,000</b> |

**Tabela 8: Aksesi per uje, kanalizime dhe furnizim me energji elektrike I komunitetit R/E ne Bashkine Delvinë**

| Punë ne infrastrukturën inxhinierike (Për secilën zonë) | Gjatesia në metra |
|---|-------------------|
| Rrjeti i furnizimit me ujë                              | 1800              |
| Rrjeti i kanalizimeve                                   | 300               |
| Rrjeti i furnizimit me energji elektrike                | 1000              |
| Rruge   | 1500              |

Ne estimimin qe eshte bere per infrastrukturën ne keto zona eshte parashikuar permiresimi i rrjetit infrastrukturor per te gjithë komunitetin (zonen), pra ky rrjet do ti sherbeje dhe atyre familjeve qe nuk kane nevojë per permiresim te kushteve. Vlerësimi i koston për investimin në infrastrukturë është llogaritur si prodhim i gjatësisë në metra te infrastukturës primare të nevojitur, me çmimin për metër linear për secilin zë. Çmimi eshte percaktuar si mesatare e të njejtit zë në projekte të mëparshme. Zërat e përfshirë në infrastrukturën primare, për te cilët janë marrë të dhëna nga bashkitë përkatëse janë : gjatësia e rrugëve, çmimi për metër linear i llogaritur përafërsisht 30000 lekë/ml (gjerësia e rruges merret 5m si rrjedhoje 1 meter linear gjatesi=5 m<sup>2</sup> siperfaqe), gjatësia e rrjetit të furnizimit me ujë\_çmimi 6000 lekë/ml, gjatësia e rrjetit të kanalizimeve, çmimi 8000 lekë/ml dhe gjatësia e rrjetit të furnizimit me energji elektrike, çmimi 4000 lekë/ml. Në rastet kur vlera e zërave te infrastrukturës është 0, si rrjedhojë dhe kosto përkatëse është 0 lekë, tregon se për zërin në fjalë nuk ka nevojë për investim.

Formula e perdorur per vleresimin e koston per infrastrukturën eshte si me poshte:

- Kosto per rrjetin e furnizimit me uje = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per rrjetin e kanalizimeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per furnizimin me energji elektrike = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- Kosto per ndertimin e rrugeve = çmimi lekë/ ml \* gjatesia ne metra
- **Kosto per infrastrukturën** = Kosto per rrjetin e furnizimit me uje + Kosto per rrjetin e kanalizimeve + Kosto per furnizimin me energji elektrike + Kosto per ndertimin e rrugeve

**Tabela 9: Vlerësimi i koston per infrastrukturën në Bashkinë Delvinë**

| Tipi         | lekë/ ml | Gjatesia në metra | Kosto lekë        |
|--------------|----------|-------------------|-------------------|
| Rrugë        | 30,000   | 1,500             | 45,000,000        |
| Ujë          | 6,000    | 1,800             | 10,800,000        |
| Elektrike    | 4,000    | 1,000             | 4,000,000         |
| Kanalizime   | 8,000    | 300               | 2,400,000         |
| <b>Total</b> |          |                   | <b>62,200,000</b> |

Nevojat për ndërtime të reja perfshin ata që banojnë në kasolle si edhe në banesa që nuk kanë siguri për jetën si: tenda, baraka, depo. Sipas kriterëve dhe normativave të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr 824 datë 3.12.2004 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" është berë dhe vlerësimi i koston për keto ndërtime. Për çdo familje, pavarësisht numrit të personave që e përbëjnë atë, është përllogaritur sipërfaqja minimale që u takon, përkatësisht : garsoniere 35 m<sup>2</sup>, apartamente (1+1) 55 m<sup>2</sup>, apartamente (2+1) 67 m<sup>2</sup> dhe apartamente (3+1) 75.5 m<sup>2</sup>. Kosto e ndërtimit për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, është marrë për çdo qytet nga manuali i qeverisë në qershor 2015: "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit te banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015". Më poshtë jepen formulat e llogaritjes të koston të ndërtimeve të reja dhe tabela përkatëse me rezultatet.

**Tabela 10: Kerkesa e komunitetit R/E per strehim, ne Bashkine Delvinë**

| Lloji i Strehimit  | Nevoja per studim komuniteti Rom | Nevoja per studim komuniteti Egjiptian |
|--|----------------------------------|--|
| Numri i familjeve qe u nevojiten garsoniere                                      | 0                                | 0                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 1+1                                 | 2                                | 1                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 2+1                                 | 1                                | 1                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 deri ne 75,5 m <sup>2</sup>     | 0                                | 0                                      |
| Numri i familjeve qe u nevojiten apartamente 3+1 me shume se 75,5 m <sup>2</sup> | 0                                | 0                                      |
| <b>Numri total i familjeve</b>   | <b>3</b>                         | <b>2</b>                               |

Formulat e perdorura per vleresimin e koston per ndertime te reja jane si me poshte:

- Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per garsoniere e caktuar 35 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>

- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 1+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 1+1 e caktuar 55 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 2+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 2+1 e caktuar 67 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente 3+1 = numri familjeve \* siperfaqe ne m<sup>2</sup> per apartamente 3+1 e caktuar 75.5 m<sup>2</sup> \* çmimi lekë/ m<sup>2</sup>
- **Kosto totale per ndërtim te reja** = Kosto e ndërtimeve te reja, garsoniere + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (1+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (2+1) + Kosto e ndërtimeve te reja, apartamente (3+1) = Shuma gjithsej

**Tabela 11: Vlerësimi i koston per ndertime të reja në Bashkinë Delvinë**

| Tipi         | lekë/ m <sup>2</sup> | Siperfaqe m <sup>2</sup> | Nr familjeve | Kosto lekë       |
|--------------|----------------------|--------------------------|--------------|------------------|
| garsoniere   | 32,616               | 35                       | 0            | -                |
| ap 1+1       | 32,616               | 55                       | 3            | 5,381,640        |
| ap 2+1       | 32,616               | 67                       | 2            | 4,370,544        |
| ap 3+1       | 32,616               | 76                       | 0            | -                |
| <b>Total</b> |                      |                          | <b>5</b>     | <b>9,752,184</b> |

Bashkia e Delvines propozon kthimin e tre ndertesave te ish shkolles Bujqesore ne godina banimi per komunitetin Rom dhe Egjiptian. Nga analiza e bere konkluduar qe vetem ndertesat e ish shkolles mund te rikonstruohet pasi struktura mbajtese e saj eshte e qendrueshme, ndersa dy ndertesat e e konviktit jane ne gjendje tejet te amortizuar, dhe vlere per rikonstrukcionin e tyre eshte e barabarte me ate te nje ndertimi te ri.



**Konvikti**

**Shkolla**

**Investimi per permiresimin e kushteve te banimit te komuniteteve Rom dhe Egjiptian ne Bashkine Delvine ka vleren 250,852,184 (dale nga tabela 7, 9, 10, dhe 11)**

Duke u nisur nga situata konkrete dhe nga informacioni qe morem nga Bashkia, menyra qe i pershtatet me shume realitetit, sipas analizes tone, eshte ndertimi i banesave me kosto te ulet, kjo e kombinuar dhe me rikonstrukcionin dhe me ndertimin e shtesave per banesat ekzistuese. Ndertimi i banesave me kosto te ulet, parashikohet te behet ne hapesirat e lira te zonave ne te cilat keto komunitete jetojne aktualisht, si dhe ne ambientet e ish shkolles Bujqesore.

Kjo analizë konkludon disa skenarë të rradhitur më poshtë:

► **Skenari 1**

**Rikonstrukcioni dhe shtesa për banesat ekzistuese.**

Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk i plotësojnë kushtet e jetesës. Ato mund të kenë nevojë për:

- Rikonstrukcion të banesave ekzistuese
- Rikonstrukcion + Shtesa në ndërtesat ekzistuese

Familjet që bëjnë pjesë në këtë grup, kanë nevojë për shtesë ambjentesh.

► **Skenari 2**

**Ndërtim të reja.**

Eshte menduar qe permiresimi i kushteve te ketyre familjeve, nisur nga menyra e jeteses qe ato kane, te behet ne hapesirat e zonave ku ata jetojne aktualisht. Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë ato banesa që nuk plotësojnë kushtet minimale të jetesës. Në këtë rast propozohet të bëhen ndërtim të reja për të cilat janë evidentuar siperfaqet përkatëse për secilin tip apartamenti (garsoniere, apartamente 1+1, 2+1 ose 3+1).

**Punime plotësuese me investime në infrastrukturën primare.**

Përveç punimeve në banesat vetjake të secilës familje është parashikuar nevoja edhe për punime në infrastrukturën primare në ndihmë të familjeve Rome apo Egjiptiane.

Këto punime konsistojnë në katër grupe të mëdha:

1. Punime mirëmbajtjeje dhe ndertimit të rrugëve
2. Ndërtim kanalizimesh për ujërat e zeza dhe përmirësimi i pusetave ekzistuese,
3. Ndërtim si dhe riparim i degëzimeve të ujësjellësit. Për të gjitha këto punime janë parashikuar kostot më lart.
4. Shtim i gjatësisë te rrjetit elektrik.

## 7. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

- ▶ Në bashkinë e Delvines ka problem të regjistrimit të romeve dhe egjiptianëve në zyrën e gjendjes civile si dhe në institucione të tjera publike të mandatuar për të dhënë shërbime. Si rrjedhojë, shumë familje të varfra, shumica rome dhe egjiptiane penalizohen duke mos mundur të tërheqin dokumentacionin e kërkuar për të përfituar shërbime duke filluar nga ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar, strehimi etj.
- ▶ Nuk ka procedurë specifike përmbështetjen e familjeve rome dhe egjiptiane të pastreha që të regjistrohen pranë Bashkisë Delvine. Kërkohej përshtatje e kriterëve për strehim social, transferim vendbanimi dhe dhënia e ndihmës ligjore nga shteti, duke pasur parasysh gjendjen e shumicës së familjeve rome dhe egjiptiane që punojnë në sektorët informalë dhe nuk mund të verifikojnë të ardhurat e tyre, jetojnë në baraka dhe nuk kanë kontratë qiraje ose certifikatë pronësie për banesën e tyre, ose kanë nevojë për ndihmë administrative dhe ligjore për të pasur qasje në të drejtat e tyre bazë.
- ▶ Ka mundësi të kapaciteteve lokale për të performuar në përputhje me legjislacionin e strehimit social. (ngadale si në përgatitjen e dosjes për kthimin e pronësive së objekteve të ndryshme në favor të Bashkisë për të përdorur për strehim social)
- ▶ Në prioritetet për investime të bashkisë prevalojnë projektet infrastrukturore si, furnizimi me ujë, rrugë, sheshe etj. Në planet lokale në asnjë rast problemet e komunitetit rom në përgjithësi dhe strehimi i familjeve rome dhe egjiptiane në vecanti nuk ka qenë prioritet i pushtetit vendor. Madje në asnjë rast kandidatët për kryetar bashkie nuk kanë artikuluar strehimin si një problem social të komunitetit edhe gjatë fushatave elektorale. Për rrjedhojë nuk ka patur një strategji të strehimit social për bashkinë dhe territorin e ri të saj.
- ▶ Në buxhetin vjetor të bashkisë nuk ka fonde të parashikuara për strehim, si një zë i veçantë.
- ▶ Nuk ka studime (qoftë edhe pjesore) mbi infrastrukturën e vendbanimeve rome dhe egjiptiane (përveçse projektet e rikonstruksionit të rrugës në lagjen Papuciu, ku jetojnë familje të komunitetit egjiptian)
- ▶ Në data bazën e krijuar për familjet aplikuese për strehim social, nuk ka informacion dhe analizë të thelluara për situatën e strehimit të familjeve rome dhe egjiptiane.
- ▶ Në kushtet kur, një pjesë e mirë e familjeve rome dhe egjiptiane nuk kanë njohuri mbi të drejtat e tyre për strehim dhe informacionin e nevojshëm për mënyrën e aplikimit për strehim social, mbetet detyrë e bashkisë të informojë këtë komunitet mbi skemat sociale të strehimit.
- ▶ Romët dhe egjiptianët nuk kanë qasje në informacion dhe ndihmë të specializuar, përse i perket legalizimit të shtëpive të tyre. Në këtë mënyrë ata rrezikojnë të humbin mundësinë të bëhen pronarë, si dhe rrezikojnë të nxirren në rrugë nga ndërtesat dhe zhvillues të pronave të patundura, të cilët janë më të informuar dhe më të shkathët.
- ▶ Informacioni i pamjaftueshëm për shkak të përjashtimit social të këtij grupi të popullatës.
- ▶ Shpesh familjet rome që jetojnë në banesa me qera, nuk e disponojnë aktin e qiramarrjes/dokumentit të pronësisë, gjë që e bën të pamundur të vërtetohet rezidenca/adresa e familjes rome ose egjiptiane.

## ANEKSI

### Harta e vendbanimeve të komunitetit rom në Bashkinë Delvinë

